



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 27/2021 regjistër (JR)  
Datë 21.05.2021

Nr. 31 i vendimit  
Datë 18.07.2023

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 18.07.2023, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 27/2021, datë 21.05.2021, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Klodiana Gjyzari, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 340, datë 01.02.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42 e 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Kodi i Procedurave Administrative; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 340, datë 01.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Klodiana Gjyzari ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Vlorë. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Klodiana Gjyzari (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup>, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari*.

2.3 KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI-së është përcjellë në Komision, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.05.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2020, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.12.2020, të KDZh-së, përcjellë në Komision, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.12.2020.

nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 340, datë 01.02.2020.

## II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 340, datë 01.02.2021, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Klodiana Gjyzari, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

- Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

*Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

- Për kriterin e kontrollit të figurës:

*Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

- Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

*Subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të shkronjës “c”, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

*Nga vlerësimi në tërësi i kriterit të pasurisë dhe vlerësimi profesional lidhur me çështjet e gjykuara dhe problematikat e konstatuara nga Komisioni mbi bazën e të dhënave të mbledhura, denoncimet dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Klodiana Gjyzari ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, si dhe ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e pikave 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

## III. Shkaqet e ankimit

5. Nga analizimi i përmbajtjes së ankimit, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit më datë 28.04.2021<sup>4</sup>, konstatohet se ai përmban pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor dhe pretendime që kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe konkluzionet për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.

6. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:

°Konstatimin e pavlefshmërisë së procedurës së hetimit administrativ, seancës dëgjimore, vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare të trupës gjyquese të Komisionit.

°Përsëritjen e hetimit gjyqësor brenda shkaqeve të ankimit dhe marrjen e provave të kërkuara nga subjekti i rivlerësimit, duke e gjykuar çështjen në seancë gjyqësore publike.

<sup>3</sup> Raporti i KLGj-së për analizimin e aftësisë profesionale nr. {\*\*\*} prot., datë 11.05.2020.

<sup>4</sup> Brenda afatit ligjor 15-ditor, i parashikuar nga neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

°Prishjen e vendimit nr. 340, datë 01.02.2021, të Komisionit dhe pavlefshmërinë e tij dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Klodiana Gjyzari, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë.

## 7. Shkaqe të ankimit lidhur me procesin e rregullt ligjor

7.1 Vendimi i Komisionit është i pavlefshëm për shkak se është marrë nga një trupë gjyquese që nuk përmbush kriterin e të qenit një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, bazuar në nenin 6/1 të KEDNj-së dhe jurisprudencës së GjEDNj-së, pasi anëtarët e Komisionit nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj për t’u zgjedhur si të tillë.

7.2 Procedura e hetimit dhe gjykimit të saj dhe të gjitha aktet e prodhuara nga Komisioni në këtë çështje janë të pavlefshme, në zbatim të nenit 6 të KEDNj-së, nenit 42 dhe 179/b të Kushtetutës, si dhe nenit 119 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, pasi trupi gjyqes është caktuar në shkelje të rregullave normative që parashikohen nga ligji për formimin e rregullt të përbërjes nominative të gjykatës, çka përbën cenim të procesit të rregullt ligjor dhe të gjykatës së caktuar me ligj.

7.3 Vendimi i Komisionit është i pavlefshëm, pasi është marrë nga një trupë gjyquese, i cila nuk ka qenë e pavarur, në kundërshtim me kriteret e analizuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së, për të përcaktuar nëse një organ që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve është një organ i pavarur dhe i paanshëm.

7.4 Trupi gjyqes i Komisionit ka qenë i njëanshëm e diskriminues në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative e jurisprudencës së GjEDNj-së.

7.5 Secili nga komisionerët kanë qenë të njëanshëm për shkak se në raste të njëjta të subjekteve të tjera të rivlerësimit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme, si dhe kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm nga vendimet e Kolegjit, të cilat janë detyruese, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

## 8. Shkaqe të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

8.1 Komisioni, në vlerësimin e pasurisë apartament banimi në Vlorë, nuk ka marrë parasysh asnjë kundërshtim të subjektit të rivlerësimit, asnjë provë dhe asnjë argument ligjor të paraqitur prej tij, si dhe nuk ka ezauruar detyrimin për të arsyetuar pse provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë të pamjaftueshme e argumentet e saj të pabazuara.

8.2 Arsyetimi dhe konkluzioni i Komisionit për pasurinë *automjet tip “Volkswagen Golf”* është i pabazuar.

8.3 Komisioni, në konkluzionin e tij, lidhur me pasuritë *depozita bankare në “Union Bank”*, të krijuara në datën 05.01.2015, nuk ka mbajtur në konsideratë parimin e barazisë së shtetasve para ligjit dhe atë të proporcionalitetit, duke pasur parasysh vlerën e vogël të të dyja depozitave së bashku, vlerë e cila duhet të kishte çuar në konkluzionin se ndaj subjektit nuk mund të vendosej masa disiplinore e shkarkimit.

8.4 Konkluzioni i Komisionit, lidhur me pasurinë *depozitë bankare në “Union Bank”* të çelur në vitin 2010, është i gabuar, pasi provat dhe argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ kanë qenë të mjaftueshme për të provuar se burimi i krijimit të kësaj pasurie ka qenë i ligjshëm.

8.5 Për pasuritë në pronësinë e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit konkluzionet e Komisionit, përveçse janë në tejkalim të objektit të procesit të rivlerësimit, janë të pabazuara në prova.

8.6 Nëse analiza financiare për periudhën 2003-2016 do të ishte një analizë e saktë, bazuar në pretendimet e saj, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte në kushtet e mjaftueshmërisë financiare të saj për të përballuar/mbuluar shpenzimet dhe për të krijuar pasuritë.

8.7 Komisioni, duke mos e njohur me emrin e personit që ka kryer analizën financiare, i ka shkelur subjektit të rivlerësimit të drejtën e kundërshtimit të tij, pasi nuk ka pasur mundësinë e verifikimit të njohurive të tij, si dhe të mospasjes së konfliktit të interesit.

8.8 Komisioni nuk i ka vënë në dispozicion “analizë financiare” por “tabelë financiare”, e cila përmban vetëm konkluzione, duke iu mohuar kështu subjektit të rivlerësimit e drejta ta kundërshtojë këtë provë, në të cilën Komisioni ka mbështetur vendimmarrjen.

8.9 Konkluzioni i Komisionit, sa i takon vlerësimit se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehë pasuritë në pronësi apo përdorim të saj, është i pabazuar, pasi Komisioni nuk ka arsytuar se cilat kanë qenë pasuritë e fshehura, duke qenë se nuk ka gjetur asnjë pasuri të poseduar nga persona të tretë, që realisht t’i përkiste subjektit të rivlerësimit apo fëmijëve të saj.

#### 9. *Shkaqe të ankimit lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*

9.1 Konkluzioni i Komisionit është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit dhe provave, pasi deklaratimet e saj lidhur me krijimin e pasurive nuk kanë qenë kontradiktore, si dhe për shkak se nuk është vërtetuar ndonjë shkelje konkrete në ndonjë prej rasteve të verifikuara nga denoncimet e publikut, e tillë që të përbëjë *gabime thelbësore dhe serioze apo të ekzistojë një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara*, sipas përcaktimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit është rrjedhojë e një vlerësimi sipërfaqësor e të paargumentuar të rrethanave të konsideruara si bazë për mbajtjen e këtij qëndrimi, të cilat nuk vërtetohen të jenë të mjaftueshme për të konkluduar për aplikimin e nenit 61, pika 5 si kriter për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

#### 10. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka depozituar edhe disa akte në cilësinë e provave të reja, si më poshtë.

- o shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 22.04.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me çështjet e shqyrtuara dhe të mbyllura nga gjyqtare Klodiana Gjyzari për periudhën 2001-2014;

- o shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 21.04.2021, e Gjykatës së Apelit Vlorë, në lidhje me ngarkesën e individuale të punës, si dhe ngarkesës me trup gjykues për gjyqtaren Klodiana Gjyzari për periudhën 2014-2021;

- o shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 21.04.2021, nga DPSHTRr-ja, sipas së cilës autoshkolla “{\*\*\*}” ka filluar aktivitetin në nëntor 1992 deri në maj 1997;

- o akt verifikimi i vjetërsisë në punë para vitit 1994 e DRSSH-së Berat, datë 19.05.2020, sipas së cilës z. E. Gj. ka qenë i vetëpunësuar në periudhën 01.01.2003-30.06.2003 dhe 09.07.2003-31.12.2003, si dhe të dhënat mbi pagën *bruto* të marrë nga ai në këtë periudhë;

- o shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 04.06.2020, e DRT-së Berat, sipas së cilës informohet znj. Gjyzari se DRT-ja Berat ka hyrë në sistemin informatik në dhjetor 2006; në rast se nuk figurojnë të dhëna

në këtë sistem DRT-ja Berat i referohet arkivës për vënien në dispozicion të dosjes së tatim paguesve. Në rastin konkret, DRT-ja Berat, duke mos pasur të dhëna në sistem dhe as dosje fizike në arkivë për periudhën para vitit 2006, nuk mund të konfirmojë të dhëna për të cilat nuk vërtetohet saktësia e tyre.

11. Në datën 07.11.2022, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Kolegj një material të titulluar “Shpjegime shtesë të ankimit” dhe bashkëlidhur tij ka dorëzuar edhe disa akte shkresore<sup>5</sup>. Në datën 05.07.2023, para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Kolegj materialin shkresor “Parashtrime shtesë”.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupit gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave

---

<sup>5</sup> Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet:

shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 01.06.2022, e Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor, me lëndë: “Kthim përgjigje shtetasit S. Gj.”, vërtetuar njësia me origjinalin me vërtetim nr. {\*\*\*} rep., datë 26.10.2022;

shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 16.09.2022, e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat, me lëndë: “Kthim përgjigje znj. Klodiana Gjyzari”, vërtetuar njësia me origjinalin me vërtetim nr. {\*\*\*} rep., datë 26.10.2022;

kërkesë, datë 19.05.2022 e kërkuarit S. Gj., me objekt: “Vënie në dispozicion dokumentacioni”, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat;

shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 12.05.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, për dijeni z. S. Gj., me lëndë: “Për kompetencë”;

shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 09.06.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, drejtuar z. S. Gj. dhe z. E. Gj., me lëndë: “Kthim përgjigje për informacionin e kërkuar”, vërtetuar njësia me origjinalin, me vërtetim nr. {\*\*\*} rep., datë 26.10.2022;

shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 09.06.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, drejtuar z. S. Gj. dhe z. E. Gj., me lëndë: “Kthim përgjigje për informacionin e kërkuar”, vërtetuar njësia me origjinalin me vërtetim nr. {\*\*\*} rep., datë 26.10.2022;

shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 04.06.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, drejtuar znj. Klodiana Gjyzari, me lëndë: “Kthim përgjigje”;

vendim nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga kompania “{\*\*\*}” ShA”, njoftuar znj. Klodiana Gjyzari, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;

vendim nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. K. M.”, njoftuar znj. Klodiana Gjyzari, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; si dhe

vendim nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasit z. Ll. Xh.”, njoftuar znj. Klodiana Gjyzari, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.07.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 340, datë 16.02.2021, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në dhomë këshillimi.

Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesat e subjektit të rivlerësimit për përsëritjen e hetimit gjyqësor, marrjen e provave të reja dhe gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit të tij, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues çmoi se aktet e dorëzuara së bashku me ankimin, si dhe ato të depozituara në Kolegji, bashkëlidhur parashtrimeve me shkrim të subjektit të rivlerësimit para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar dispozitave të sipërcituara ligjore dhe, për rrjedhojë, nuk u administruan në cilësinë e provës nga trupi gjykues. Për sa i përket tabelës financiare të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, në kushtet kur ky dokument përmban paraqitjen tabelare të pretendimeve të parashtruara në ankim lidhur me analizën financiare për periudhën 2003-2016, të dhënat e pasqyruara në të janë verifikuar e analizuar nga trupi gjykues në funksion të vlerësimit të shkaqeve të ankimit.

13. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi, gjithashtu, se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion edhe për faktin se si më sipër evidentuar, aktet e dorëzuara në cilësinë e provave të reja nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

*B. Vlerësimi i shkaqeve të tjera të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit*

14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vendimi i Komisionit është i pavlefshëm për shkak se është marrë nga një trupë gjyquese që nuk përmbush kriterin e të qenit një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, bazuar në nenin 6/1 i KEDNj-së dhe jurisprudencës së GjEDNj-së. Subjekti i rivlerësimit e mbështeti këtë shkak të ankimit në argumentin se anëtarët e Komisionit nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj për t’u zgjedhur si të tillë.

Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjyqes konstatoi se pavlefshmëria e vendimit të Komisionit adresohet nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të pretendimit të cenimit të parimit të procesit të rregullt ligjor të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, pasi:

*i.* Komisionerja B. nuk plotëson kriterin e përvojës profesionale prej 15 vjetësh në momentin e kandidimit në organet e rivlerësimit, pasi punësimi si juriste pranë shoqërisë {\*\*\*} ShA nuk përbën eksperiencë profesionale në fushën e drejtësisë dhe ndonëse në vitin 2003 ka marrë licencën e profesionit të avokatit nuk e ka ushtruar këtë profesion. Gjithashtu, ajo nuk mban asnjë gradë shkencore në fushën e drejtësisë.

*ii.* Komisioneri I. nuk plotëson kriterin e pastërtisë së figurës, pasi ndaj tij ka qenë regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, për kryerjen e një krimi për veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës, i cili është pushuar në datën 17.02.2017, pasi nuk u provua që të ketë kryer vepër penale, jo për mungesë fakti penal.

*iii.* Komisionerja S., për shkak të punësimit të saj të fundit në Kryeministri, është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me Kryeministrin aktual, për pasojë dukshëm e lidhur dhe e varur nga politika.

*iv.* Zgjedhja e Komisionerëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore ka ndodhur për shkak se në ligj nuk përcaktohet se si do të verifikohen kushtet e zgjedhshmërisë së kandidatëve.

Trupi gjyqes, në përputhje dhe me jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me kërkesa të ngjashme në çështje të mëparshme, çmoi se, për sa kohë pretendimi i ngritur lidhur me mospërmbushjen e kriterëve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të komisionerëve nuk bën pjesë në kompetencën juridiksionale të Kolegjit dhe në kushtet kur nuk u pretenduan nga subjekti i rivlerësimit dhe as u konstatuan kryesisht nga trupi gjyqes, fakte apo rrethana të tjera në drejtim të mosformimit të rregullt të trupit gjyqes, që do ta bënin vendimmarrjen e Komisionit të cenueshme në drejtim të pavarësisë apo paanësisë së saj, vlerësuar kjo në kuadër të rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe jurisprudenca e GjEDNj-së, ky shkak ankimi gjendet i pabazuar.

15. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se vendimi i Komisionit është i pavlefshëm, pasi është marrë nga një trupë gjyquese, e cila nuk ka qenë e pavarur, në kundërshtim me kriteret e analizuara nga jurisprudenca e GjEDNj-së<sup>6</sup>, për të përcaktuar nëse një organ që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve është një organ i pavarur dhe i paanshëm.

Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se:

*i.* Komisioni përbëhet nga 12 anëtarë dhe asnjë prej tyre nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e emërimit.

*ii.* Anëtarët e Komisionit janë zgjedhur nga parlamenti pa përfshirjen e trupës gjyqësore dhe rezultatet e punës së tyre vlerësohen nga qeveria.

---

<sup>6</sup> Subjekti i rivlerësimit ka referuar kriteret e analizuara në vendimin e GjEDNj-së në çështjen Volkov kundër Ukrainës.



iii. Duke qenë se Komisioni e mbështet relacionin përfundimtar jo mbi akte dhe ekspertime të pavarura nga institucione të pavarura, por nga të punësuarit e tij, provohet që është edhe organ hetimi dhe gjykimi.

iv. Kohëzgjatja e limituar e mandatit të anëtarëve të Komisionit i bën ata veçanërisht vulnerabël nga influencat politike apo qeveritare.

Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues vlerësoi të mbajë në konsideratë qëndrimin e mbajtur në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit, sipas së cilit pretendime të tilla janë gjetur të pabazuara në ligj, me arsyetimin se veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Në të njëjtin konkluzion për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe GjEDNj-ja në çështjen gjyqësore Xhoxhaj kundër Shqipërisë<sup>7</sup>, në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkuases lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme.

16. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *procedura e hetimit dhe gjykimit të saj dhe të gjitha aktet e prodhuara nga Komisioni në këtë çështje janë të pavlefshme, në zbatim të nenit 6 të KEDNj-së, nenit 42 dhe 179/b të Kushtetutës, si dhe nenit 119 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, pasi trupi gjykues është caktuar në shkelle të rregullave normative që parashikohen nga ligji për formimin e rregullt të përbërjes nominative të gjykatës, çka përbën cenim të procesit të rregullt ligjor dhe të gjykatës së caktuar me ligj*. Subjekti i rivlerësimit e ka mbështetur këtë shkak të ankimit në argumentet se Rregullorja e Komisionit “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, e cila përcakton se trupi gjykues përcaktohet për çdo short dhe nuk ka krijuar katër trupa të gjykues të përhershëm është në kundërshtim me nenin C, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 14 e 15 të ligjit nr. 84/2016. Moskrijimi i trupave gjykues të përhershëm ka prekur pavarësinë strukturore të Komisionit.

Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vëren se referuar nenit C, pika 1 e Kushtetutës dhe nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni organizohet dhe shqyrton çështjet e rivlerësimit në 4 trupa gjykues të përhershëm me nga tre anëtarë secili. Referuar parashikimeve të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, e ndryshuar, fillimisht përcaktohen trupat gjykues, më pas hidhet shorti për ndarjen e çështjeve sipas këtyre trupave gjykues dhe në fund, përcaktohet nëpërmjet shortit se cili anëtar i trupit gjykues, të cilit i është shortuar më parë çështja, do të caktohet si relator i saj.

Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes objekt gjykimi, rezultoi se trupi gjykues i Komisionit, i ngarkuar me kryerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Klodiana Gjyzari, është caktuar nëpërmjet procedurës së shortit në datën 15.03.2019 dhe cilësohej si trupi gjykues nr. 03. Referuar vendimit nr. 1 të trupit gjykues nr. 03, të datës 25.03.2019, sipas të cilit, ndër të tjera, rezulton të jetë zgjedhur kryesuesi i trupit gjykues dhe është vendosur fillimi i procedurës së hetimit administrativ, trupa gjykues nr. 03, është shortuar në mbledhjen e Komisionit për hedhjen e shortit për përbërjen e trupave gjykuese dhe shpërndarjen e çështjeve në trupat gjykues, të zhvilluar më datë 15.03.2019. Kjo procedurë, në vlerësim të trupit gjykues, rezultoi në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

<sup>7</sup> Paragrafët 282, 288, 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.

17. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se *trupi gjykues i Komisionit ka qenë i njëanshëm e diskriminues në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 17 të Kodit të Procedurave Administrative e jurisprudencës së GjEDNj-së*. Subjekti i rivlerësimit, shkakun e ankimit e ka mbështetur në pretendimet, të cilat analizohen në vijim.

17.1 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se gjatë seancës dëgjimore në Komision krijoi dyshime në lidhje me paanësinë e komisioneres V. S., nisur nga sjellja e saj në seancën dëgjimore, si dhe pyetjet e drejtuara prej saj, të cilat ishin retorike dhe me konkluzione paragjyquese. Gjatë seancës dëgjimore, komisionerja i ka drejtuar pyetje subjektit për likuiditetet e deklaruara para fillimit të detyrës, si dhe ka shprehur qartë opinionin e saj se, në lidhje me shumën që prindërit i kanë dhënë ish-bashkëshortit *ka probleme me deklarinimin*. Në lidhje me këtë sjellje të komisioneres, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në datën 28.01.2021, i ka kërkuar Komisionit kopjen e procesverbalit të seancës dëgjimore publike, i cili i është vënë në dispozicion pas shpalljes së vendimit, duke mos i mundësuar kërkesën për përjashtimin e anëtares nga trupi gjykues. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga praktika e Komisionit nuk ka asnjë rast që të jetë pranuar kërkesa e ndonjë subjekti konkret për përjashtimin e ndonjë anëtare të trupit gjykues gjatë seancës dëgjimore, për këtë arsye kërkesa edhe po të ishte paraqitur ka qenë e destinuar për t'u rrëzuar. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se GjEDNj-ja ka mbajtur qëndrim konsekuent në lidhje me mosshkrimin e mjeteve e ankimit të brendshëm të cilat nuk janë përdorur nga subjekti, pasi është provuar në raste të ngjashme, si jo efektive. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji këqyrjen e regjistrimit video të seancës dëgjimore, i cili nuk i është vënë në dispozicion me gjithë kërkesën e saj me shkrim, pasi nga ky regjistrim rezultoi qartë se komisionerja S. nuk po jepte drejtësi gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të përcjella nga Komisioni në Kolegj për efekt të shqyrtimit të ankimit, trupi gjykues vëren se në të nuk gjendet e administruar ndonjë kërkesë e subjektit drejtuar Komisionit për vënien në dispozicion të procesverbalit të seancës dëgjimore publike dhe regjistrimit video të saj.

Nga verifikimi i përmbajtjes së procesverbalit të seancës dëgjimore publike të datës 25.01.2021, rezultoi se komunikimi i komisioneres V. S., në cilësinë e kryesues së trupës gjyquese të Komisionit ka pasur lidhje, kryesisht, me mbarëvajtjen e zhvillimit të seancës dëgjimore. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se komisionerja ka shprehur qartë opinionin e saj se në lidhje me shumën që prindërit i kanë dhënë ish-bashkëshortit *ka probleme me deklarinimin*, nga përmbajtja e procesverbalit rezultoi që komisionerja në vijim të një dialogu me subjektin është shprehur *me disa para të ish-bashkëshortit tuaj të marra nga familja e prindërve, për të cilat ka probleme me deklarinimin*. Ky pohim i komisioneres nuk ka qenë një opinion i atypëratyshëm, por ka qenë një pohim i rrjedhur nga problematikat e evidentuara në rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë apartament banimi në Vlorë, të cilat ishin prezantuar në fillim të seancës dëgjimore nga relatorja e çështjes. Rezultoi se kryesuesja e trupit gjykues i ka drejtuar pyetje subjektit të rivlerësimit vetëm në dy raste dhe nga regjistrimi audio i seancës dëgjimore nuk konstatohet që komunikimi i saj të ketë qenë armiqësor e antagonist, për ta vënë subjektin e rivlerësimit në situatë paragjyquese. Subjekti i rivlerësimit nuk duket bindës në pretendimin se gjatë seancës dëgjimore krijoi dyshime në lidhje me paanësinë e komisioneres V. S., por duket se ky pretendim është një qëndrim i rrjedhur nga vlerësimi negativ i Komisionit, pasi në përfundim të seancës, në përgjigje të ftesës së komisioneres në fjalë për të paraqitur qëndrimin në lidhje me procesin e rivlerësimit, subjekti është shprehur se [...] *komunikimi i vazhdueshëm që kam pasur me Komisionin ka qenë optimal [...] vlerësimi im është tërësisht pozitiv*. Nga ana tjetër, trupi

gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në pretendimet e tij nuk shpjegon se çfarë e motivon sjelljen e pretenduar nga komisionerja.

Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbetet i paprovuar.

17.2 Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nga praktika e Komisionit nuk ka asnjë rast që të jetë pranuar kërkesa e ndonjë subjekti për përjashtimin e ndonjë anëtari të trupit gjykues gjatë seancës dëgjimore, për këtë arsye kërkesa e subjektit edhe po të ishte paraqitur ka qenë e destinuar për t'u rrëzuar, trupi gjykues vëren se në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit i është referuar jurisprudencës së GjEDNJ-së, konkretisht në çështjen Laskaj dhe Lika kundër Shqipërisë. Trupi gjykues vëren se në çështjen e referuar nga jurisprudenca e GjEDNJ-së, përpos faktit që arsyetimi i gjykatës i referohet mosarritjes së aplikantit për të paraqitur një apelim kushtetues, gjykata ka arsyetuar se *një aplikant nuk mund të shihet sikur ka dështuar në shterimin e korrigjimeve të brendshme nëse ai apo ajo mund të tregojë, duke ofruar raste të çështjeve të brendshme përkatëse apo çfarëdo të dhënash të tjera të përshtatshme, që një mjet ankimi të cilin ai nuk e ka përdorur, ishte i destinuar të dështonte*. Në referencë të kësaj jurisprudence në rastin konkret, trupi gjykues vlerësoi se vetëm pretendimi i paprovuar i subjektit të rivlerësimit se nga praktika e Komisionit nuk ka asnjë rast që të jetë pranuar kërkesa e ndonjë subjekti konkret gjatë seancës dëgjimore për përjashtimin e ndonjë anëtari të trupit gjykues, nuk mjafton për të arritur në përfundimin se për këtë shkak kërkesa e subjektit, edhe po të ishte paraqitur, ka qenë e destinuar për t'u rrëzuar.

17.3 Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen nga Kolegji të regjistrimit video të seancës dëgjimore publike të zhvilluar në Komision, në të cilën, sipas subjektit, rezulton qartë se komisionerja S. nuk po jepte drejtësi, trupi gjykues vlerësoi se sipas parashikimit të nenit 49, pika 6, shkronja "a", marrja e kësaj prove nuk është e nevojshme, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka parashtruar se cili ka qenë qëndrimi konkret i komisioneres S., i cili duhet të verifikohet me anë të pamjeve të regjistruara.

17.4 Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se vendimi i Komisionit është absolutisht i pavlefshëm, pasi komisionerja B. B. ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, duke argumentuar se nga përmbajtja e vendimit ka konstatuar se nga ana e Komisionit, në pjesën e vlerësimit profesional është vlerësuar si e bazuar një ankesë e shoqërisë {\*\*\*} ShA, në të cilën komisionerja në fjalë ka pasur punësimin e saj më të gjatë. Për pasojë, bazuar në nenin 30, shkronja "g" e Kodit të Procedurave Administrative, ajo ka qenë e detyruar të deklaronte konfliktin e interesit. Në analizë të këtij pretendimit, trupi gjykues vëren se neni 27 i ligjit nr. 84/2016 parashikon nenin 30 të Kodit të Procedurës Administrative si bazë ligjore referuese për të rregulluar situatën e konfliktit të interesit për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, veçanërisht për anëtarët e Komisionit. Nisur nga sa parashtron në ankim vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe duke pranuar si të vërteta faktet e paraqitura prej saj, rezultoi se *në vitin 2013, komisionerja B. ka punuar pranë {\*\*\*} si përgjegjëse e sektorit të çështjeve ligjore në drejtorinë ligjore*. Ankimi/denoncimi i paraqitur nga shoqëria {\*\*\*} ShA pranë Komisionit dhe për të cilin komisionerja ka mbajtur qëndrim lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, lidhej me një vendim të dhënë prej këtij të fundit në datën 27.12.2018, datë në të cilën komisionerja B. nuk ishte më në marrëdhënie punësimi pranë shoqërisë {\*\*\*} ShA, pasi që prej qershorit 2017 ushtronte detyrën e komisioneres pranë Komisionit. Vetëm fakti se komisionerja ka punuar më parë në këtë shoqëri nuk mund të shërbejë si premisë/rrethanë për të konkluduar se ajo gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimit të nenit 30, shkronja "g" e Kodit të Procedurave

Administrative<sup>8</sup>. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë fakt apo rrethanë që të provojë se komisionerja B. ka pasur një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në çështjen konkrete. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka shfaqur asnjë pretendim dhe nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e komisioneres B. nga përbërja e trupit gjykues të Komisionit, edhe pse në rezultatet e hetimit administrativ ajo është njohur me qëndrimin e trupës gjykuese të Komisionit, lidhur me denoncimin e shoqërisë {\*\*\*} ShA, qëndrim i cili është shprehur i njëjtë nga Komisioni, edhe në vendim. Përfundimisht, në analizë të situatës faktike dhe ligjore të përshkruar më lart, trupi gjykues çmoi se pretendimi se komisionerja B. B. është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit është i pabazuar në fakte dhe në ligj.

18. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim, se *secili nga komisionerët kanë qenë të njëanshëm për shkak se në raste të njëjta të subjekteve të tjera të rivlerësimit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme, si dhe kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm nga vendimet e Kolegjit, të cilat janë detyruese, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

Në shqyrtim të shkakut të mësipërm të ankimit, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në raste të tjera anëtarët e Komisionit kanë mbajtur një qëndrim ndryshe nga ç'kanë vlerësuar në çështjen objekt gjykimi, lidhur me kursimet në *cash* të padeklaruara gjendje në fund të vitit, përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit, barrën e provës lidhur me denoncimet etj., nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë apo të pavlefshëm vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike të provuar nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar në praktikën e tij gjyqësore.

C. *Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*

19. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi”, me sipërfaqe 102,22 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë (në vijim “apartament banimi”), për të cilën subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni në vlerësimin e kësaj pasurie nuk ka marrë parasysh asnjë kundërshtim të subjektit të rivlerësimit, asnjë provë dhe asnjë argument ligjor të paraqitur prej tij, si dhe nuk ka ezauruar detyrimin për të arsyetuar pse provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë të pamjaftueshme e argumentet e saj të pabazuara, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*

19.1 Në përfundim të kontrollit dhe vlerësimit të pasurisë objekt kontrolli, në vendim<sup>9</sup>, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaratime kontradiktore lidhur me burimin e shumës së pretenduar prej 3.500.000 lekësh, bazuar në deklaratën e rivlerësimit, deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2003 dhe në përgjigje të pyetësorit. [...] 1.12.1 Bazuar në analizën financiare, Komisioni konstatoi se prindërit e ish-bashkëshortit të subjektit nuk kishin

<sup>8</sup> Neni 30 i sipërpërmendur, shkronja “g” e tij përcakton: “Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse, në rastet kur: g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim”.

<sup>9</sup> Paragrafët 1.15 dhe 1.16 në vendimin e Komisionit.

*mundësi financiare në shumën (-) 1.578.169 lekë, për dhënien e shumës së pretenduar prej 3.500.000 lekësh. Në këtë analizë nuk janë përfshirë as pasuritë e blera nga prindërit e ish-bashkëshortit në shumën totale prej 1.500.000 lekësh në vitet 2000 - 2001. 1.12.2 Llogaritja e të ardhura të prindërve është bërë nga Komisioni bazuar në dokumentacionin e sjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e rivlerësimit, duke mos u gjendur brenda parashikimeve të shkronjës "a", të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2006, duke u gjendur brenda parashikimeve të shkronjës "b", të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti nuk ka deklaruar saktë në pyetësor lidhur me pasuritë e blera nga prindërit e ish-bashkëshortit, duke mos përmendur faktin e blerjeve të pasurive të paluajtshme në vlerën 1.000.000 lekë në vitin 2001 dhe në vlerën 500.000 lekë në vitin 2000. Subjekti rezultoi në konflikt interesi me shoqërinë "{\*\*\*}" ShPK, duke u gjendur në kushtet e shkronjës "d", të nenit 33, pika 5.*

**19.2** Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit, lidhur me burimet e deklaruara prej saj për financimin e blerjes së kësaj pasurie, ka parashtuar pretendime, të cilat analizohen në vijim.

**19.3** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, në deklaratën e rivlerësimit, në deklaratën para fillimit të detyrës, si dhe në përgjigjet e dhëna pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, duke shpjeguar se shuma prej 3.000.000 lekësh e përdorur për blerjen e pasurisë rrjedh nga shuma prej 3.500.000 lekësh në *cash* dhënë bashkëshortit nga prindërit e tij, deri në vitin 2003. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni, në vendim, nuk ka përcaktuar ku qëndron kontradikta në deklaratimet e dhëna prej saj. Subjekti i rivlerësimit ka pranuar se shumën prej 3.500.000 lekësh nuk e ka deklaruar si gjendje *cash* në vitet 2004 e 2005, por duke qenë se kjo shumë është deklaruar në vitin 2003, nuk e ka kuptuar që duhet të rideklarohej çdo vit, pasi në kushtet kur kjo gjendje *cash* nuk kishte ndryshuar, nuk ka vlerësuar se kishte detyrim ta deklaronte. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se është i gabuar edhe konstatimi i Komisionit se nuk ka deklaruar burimin e shumës së blerjes së këtij apartamenti në deklaratën e pasurisë së vitit 2006, pasi në rubrikën e formularit që i përkiste çmimit, ka shkruar *deklaruar më parë*, duke dashur të thotë që kjo shumë është deklaruar më parë.

**19.4** Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në ankim, duke parashtuar të njëjtat argumente, në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni. Në deklaratën e rivlerësimit, subjekti referon se pasuria është *blerë gjatë martesës në vlerën 3.000.000 lekë*, me burim krijimi *paratë e ish-bashkëshortit*, duke mos pasqyruar të dhëna të mëtejshme se si i kishte krijuar bashkëshorti këto para. Subjekti i rivlerësimit është detyruar të japë shpjegime lidhur me burimin kryesor e të vetëm të deklaruar, të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, vetëm si pasojë e pyetjeve të drejtuara nga Komisioni. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo shumë ka rrjedhur prej shumës 3.500.000 lekë, që prindërit i kanë dhënë në *cash* ish-bashkëshortit si kontribut në ekonominë e përbashkët familjare, shumë e deklaruar prej saj në deklaratën e pasurisë së vitit 2003. Në këtë deklaratë, në të cilën nuk gjendet e reflektuar asnjë gjurmë e pretendimit të mësipërm të subjektit të rivlerësimit, janë detajuar elementët përbërës të likuiditetit në *cash* në shumën 3.500.000 lekë, si vijon: (a) *shumën 2.100.000 lekë - Banka e Kursimeve - puna*; (b) *shumën 400.000 lekë - Berat - kthim nga vjehri*; (c) *shumën 1.000.000 lekë - emigracioni i bashkëshortit*.

I pyetur në mënyrë të vazhdueshme nga Komisioni, lidhur me mundësinë e krijimit nga prindërit e bashkëshortit të shumës prej 3.500.000 lekësh, në përgjigjet e saj, subjekti i rivlerësimit ka pasur një qasje kontradiktore lidhur me rrethanat në të cilat është krijuar kjo shumë. Fillimisht, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2<sup>10</sup> të drejtuar nga Komisioni, ka pretenduar se ajo përbëhej nga *çmimi i shitjes së shtëpisë në qytetin e Beratit në vitin 2001 dhe diferenca, shuma të cilat kishin qenë pjesë e kontributit të ish-bashkëshortit në ekonominë e tyre familjare, nëpërmjet emigracionit apo punës së përbashkët* e, më pas, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3<sup>11</sup>, në të cilin Komisioni e ka ballafaquar me deklarinimin e saj në deklaratën e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo shumë përbëhej nga shuma prej 2.100.000 lekësh, të cilën prindërit e bashkëshortit para se tua jepnin e kanë pasur në Bankën e Kursimeve dhe e kanë tërhequr në vitin 1999, por nuk ka dokumentacion, pasi ka kaluar kohë shumë e gjatë dhe nuk kishte arsye logjike për ta ruajtur, sa kohë që llogaria ishte mbyllur, si dhe nga 1.000.000 lekë të ardhura të bashkëshortit nga emigracioni. Në lidhje me shumën 400.000 lekë, ka qenë pjesë e shumës 3.500.000 lekë, të cilën prindërit e ish-bashkëshortit ua kishin kërkuar për disa muaj, dhe ia kishin kthyer atë periudhë.

Shuma prej 3.500.000 lekësh nuk është deklaruar si likuiditet në *cash* as nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në deklarinimin për vitin 2004, që përkon me deklarinimin për herë të parë të tij si zyrtar deklarues pranë ILDKPKI-së. Në deklaratën periodike përkatëse të interesave të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar burimin e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, në kundërshtim me detyrimet e tyre si subjekte deklarues, parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”). Shënimi *deklaruar më parë*, i bërë nga subjekti i rivlerësimit në rubrikën e dedikuar për deklarinimin e vlerës së pasurisë, nuk jep të dhëna të qarta e të plota lidhur me burimin e krijimit, aq më tepër që në deklarimet e mëparshme nuk gjendet e referuar një shumë e tillë.

**19.5** Mbështetur në parashikimet kushtetuese, ligjore dhe nënligjore, sikurse përmbajtja e nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, e nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe e pikës 7 të udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte me vërtetësi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, burimin e krijimit të

---

<sup>10</sup> Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Pas emërimit tim në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë, në tetor 2001, kemi menduar të jetojmë në qytetin e Vlorës dhe prindërit e ish-bashkëshortit kanë marrë përsipër që për shkak të kontributit të tij në aktivitetin e përbashkët t’i blinin banesën në këtë qytet, që sipas informacioneve të tyre kushtonin rreth 3.500.000 lekë. Kjo shumë na është dhënë kur kemi gjetur shtëpi në qytetin e Vlorës rreth vitit 2003, në kohë të ndryshme dhe përbëhej nga çmimi i shitjes së shtëpisë në qytetin e Beratit dhe diferenca, shuma të cilat kishin qenë pjesë e kontributit të ish-bashkëshortit në ekonominë e tyre familjare, nëpërmjet emigracionit apo punës së përbashkët”.

<sup>11</sup> Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka shtuar se: “Në tërësi shuma e deklaruar në vitin 2004, prej 3.500.000 lekësh, ka qenë shuma që prindërit i kanë dhënë ish-bashkëshortit. Ish-bashkëshorti im ka pretenduar se kontributi i tij në punën e përbashkët ka qenë 2.100.000 lekë dhe 1.000.000 lekë të ardhura të tij nga emigracioni nuk duhet të quheshin të dhëna nga prindërit, pasi sipas tij kanë qenë të tijat. Në lidhje me shumën 400.000 lekë, ka qenë pjesë e shumës 3.500.000 lekë, të cilën prindërit e ish-bashkëshortit na e kishin kërkuar për disa muaj dhe na e kishin kthyer atë periudhë. Për të sqaruar mosmarrëveshjet e tyre, ish-bashkëshorti dhe prindërit e tij kanë bërë deklaratën noteriale datë 26.10.2016. Nga deklarimet e nënës së ish-bashkëshortit, në periudhën që kam plotësuar deklaratën, datë 29.03.2004, shumën prej 2.100.000 lekësh, para se të na e jepnin e kanë pasur në Bankën e Kursimeve dhe e kanë tërhequr në vitin 1999, por nuk ka dokumentacion, pasi ka kaluar kohë shumë e gjatë dhe nuk kishte arsye logjike për ta ruajtur, sa kohë që llogaria ishte mbyllur. Është e qartë në përmbajtjen e deklaratës fillestare, datë 29.03.2004, se, kam deklaruar se kam “lekë cash” në shumën 3.500.000 lekë dhe Banka e Kursimeve ka qenë vendi ku kanë qenë më parë këto para”.

pasurisë apartament banimi. Në këto kushte, referuar gjendjes së fakteve dhe rrethanave si më sipër, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar plotësisht dhe qartësisht burimin e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues e gjen të drejtë përfundimin e arritur nga Komisioni se burimi i krijimit të pasurisë apartament banimi në Vlorë nuk është deklaruar në mënyrë të plotë e të saktë në deklaratën e rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

**19.6** Trupi gjykues vëren se Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë apartament banimi, ka verifikuar mundësinë e prindërve të personit të lidhur për t’i dhënë atij në *cash* shumën prej 3.500.000 lekësh, në vitin 2003, duke konstatuar se ata nuk kishin mundësi të krijonin me burime të ligjshme shumën e pretenduar. Rezultatin negativ të kësaj analize financiare, Komisioni e ka evidentuar si mungesë burimesh të subjektit të rivlerësimit për krijimin, në vitin 2006, të pasurisë objekt kontrolli, duke pranuar kështu burimin e krijimit të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Konkretisht, Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se *prindërit e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nuk kishin mundësi financiare në shumën (-) 1.578.169 lekë, për dhënien e shumës së pretenduar prej 3.500.000 lekësh*<sup>12</sup>.

**19.7** Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se nëse në analizën financiare do të ishin vlerësuar drejt provat e paraqitura prej saj do të rezultonte që prindërit e ish-bashkëshortit kishin një diferencë pozitive në fund të vitit 2002, çka mundësonte dhënien e shumës prej 3.500.000 lekësh *cash*, djalit të tyre.

Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të këtij pretendimi, ka argumentuar se:

**a.** Prindërit e ish-bashkëshortit kanë kryer aktivitet tregtar që prej qershorit të vitit 1993 deri në vitin 2008. Babai i ish-bashkëshortit, që prej datës 01.06.1993, ka ushtruar aktivitet tregtar “autoshkollë”, i cili regjistrohej si “biznes i vogël”. Pas vitit 1997 ka ushtruar aktivitet tregtar “tregti me pakicë”, përsëri si biznes i vogël, deri më 31.12.2000 dhe nga data 01.01.2001 deri në datën 31.12.2004 ka ushtruar aktivitet tregtar “rrobaqepësi”. Në datën 01.01.2005 deri më 30.09.2008 ka ushtruar aktivitet tregtar në Tiranë, i regjistruar me NIPT {\*\*\*}. Nëna e ish-bashkëshortit ka ushtruar aktivitet tregtar nga data 01.01.2000 deri në dhjetor të vitit 2002.

**b.** Për sa i përket dokumentacionit tatimor, subjekti gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi sipas institucioneve shtetërore, dokumentacioni i zyrës së tatim taksave Berat është djegur në vitin 1997, për pasojë nuk ka mundësi të paraqesë dokumentacion për periudhën 1993-1997. Dokumentacioni tatimor për periudhën 1997-2003 nuk gjendet as në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat dhe as në Bashkinë Berat. Nga ana e Komisionit duhet të pranohej se fakti rezulton i provuar nga prova të tjera indirekte, nga të cilat rezulton se babai i ish-bashkëshortit ka qenë i vetëpunësuar si tregtar me pakicë për të gjithë periudhën deri në fund të vitit 2002. Prindërit e ish-bashkëshortit nuk kanë pasur detyrimin e ruajtjes së dokumentacionit, pasi ligji nr. 9049/2003 që parashikonte detyrimin e subjektit për të deklaruar të ardhurat, ka hyrë në fuqi në datën 30.05.2003, për pasojë subjekti nuk ka pasur arsye objektive të ruajtjes së dokumentacionit të prindërve të ish-bashkëshortit, përpara kësaj date. Si prova të tjera të drejtpërdrejta nga të cilat rezulton që prindërit e ish-bashkëshortit kanë krijuar të ardhura për periudhën 01.06.1993-dhjetor 2002, janë dokumentet e pasurive që ata kanë blerë gjatë kësaj periudhe, apartament banimi në Tiranë, një njësi tregtare në Durrës, si dhe dy automjete. Fakti që

---

<sup>12</sup> Paragrafi 1.12 i vendimit të Komisionit.

kanë blerë pasuri të paluajshme dhe të luajshme, provon që kanë pasur mundësi ekonomike të ndryshme nga analiza financiare e kryer nga Komisioni.

c. Prindërit e ish-bashkëshortit kanë krijuar të ardhura ekonomike në vazhdimësi nga aktiviteti i tyre tregtar. Këto të ardhura duhet të llogariten të paktën në masën 1.000.000 lekë në vit, sa ka qenë fitimi minimal për biznesin e vogël, për 9 vjet, për periudhën 1994-2002, dhe për periudhën 01.06.1993-31.12.1993, në masën 500.000 lekë, që ka qenë gjysma e fitimit minimal të aktivitetit tregtar biznes i vogël, duke pasur parasysh llojin e biznesit që kanë ushtruar, autoshkollë, tregtim dhe dhënie me qira të veshjeve të dasmave, tregtim me pakicë të gazit dhe pajisjeve të tij. Nëse në analizën financiare do të përfshiheshin të ardhurat minimale nga aktiviteti tregtar, do të rezultonte që prindërit e ish-bashkëshortit kishin një diferencë pozitive me 6.221.831 lekë në fund të vitit 2002.

**19.8** Në analizë të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni, në lidhje me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga prindërit e ish-bashkëshortit për periudhën 1994-2002, ka arsyetuar në vendim<sup>13</sup> *se për sa i përket të ardhurave të prindërve të ish-bashkëshortit, të cilat janë marrë parasysh në analizën e mundësisë së tyre për t'i dhënë z. E. Gj. shumën e pretenduar prej 3.500.000 lekësh, Komisioni është bazuar në vërtetimet e sjella nga subjekti në përgjigjet e pyetësorëve (dokumentacioni i plotë nga ISSh-ja për shtetasit S. Gj. dhe A. Gj.).*

**19.9** Gjatë hetimit administrativ në Komision, për të provuar faktin se prindërit e ish-bashkëshortit kanë pasur aktivitet tregtar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.12.2020, të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Berat, sipas së cilës, bazuar në të dhënat e sistemit informatik S. dhe E. Gj. nuk figurojnë me aktivitet tregtar dhe ky institucion nuk disponon të dhëna për periudhën para vitit 2007, si dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2020, të Drejtorisë Rajonale Tatimore (në vijim “DRT”) Berat, sipas së cilës S. Gj. nuk figuron si tatimpagues në sistemin informatik të kësaj drejtorie. DRT-ja Berat referon, gjithashtu, se edhe sipas arkivës së këtij institucioni nuk disponohen të dhëna për dosjen e z. Gj.. Bashkëlidhur shkresës, DRT-ja Berat ka përcjellë shkresën nr. {\*\*\*} prot./S.A., datë 13.11.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, e cila informon se si pasojë e ngjarjeve të datave 25 dhe 26 janar 1997 janë djegur në qytetin e Beratit: Bashkia, Këshilli i Rrethit, Prefektura, Gjykata, Prokuroria, Komisariati i Policisë dhe Dega e Tatim Taksave. Me të njëjtin qëllim provues, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe shkresën e Arkivit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, nr. {\*\*\*} prot., datë 26.05.2020, e cila i ka përcjellë dosjen e pensionit të pleqërisë për z. S. Gj. dhe znj. A. Gj., sipas së cilës ata kanë përfituar pension pleqërie. Gjithashtu, rezultojnë të dhëna edhe për punësimin e znj. A. G. pranë Postës Shqiptare, në vitet 1994-2004. Këto të ardhura, në kushtet kur për to janë paguar detyrimet tatimore, janë konsideruar nga Komisioni se janë krijuar me burime të ligjshme, një vlerësim i gjetur i drejtë nga trupi gjykues, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**19.10** Pasi u shqyrtuan pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në lidhje me vlerësimin si të ligjshme të të ardhurave të babait të ish-bashkëshortit nga aktiviteti tregtar në periudhën 1993-2002, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbështeten vetëm nga fakti që sipas dokumentacionit të përcjellë nga ISSh-ja rezulton se z. S. Gj., për periudhën 01.06.1993-31.12.2004, ka kryer pagesat për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi pagën *bruto*, si i vetëpunësuar në aktivitetet tregtare të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në ankim,

---

<sup>13</sup> Paragrafi 9.3.2 i vendimit të Komisionit.



siç janë të përshkruar në paragrafin “c” më sipër, në këtë vendim. Nga këto të dhëna vërtetohet se z. S. Gj. ka ushtruar aktivitetin privat të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, për të cilin janë paguar edhe detyrimet tatimore, për rrjedhojë të ardhurat e përfituara prej tij, sipas të dhënave të rezultuara nga informacioni i Arkivit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, konsiderohen të ardhura të ligjshme dhe trupi gjykues konstatoi se të tilla janë konsideruar edhe nga Komisioni.

**19.11** Sa i takon pretendimit të subjektit se të ardhurat nga aktiviteti tregtar i babait të ish-bashkëshortit për periudhën 1994-2002 duhet të llogariten në shumën totale 9.000.000 lekë, të paktën në masën 1.000.000 lekë në vit, sa ka qenë fitimi minimal për biznesin e vogël dhe për periudhën 01.06.1993-31.12.1993, në masën 500.000 lekë, sa ka qenë gjysma e fitimit minimal të aktivitetit tregtar biznes i vogël, trupi gjykues e gjeti të bazuar konkluzionin e Komisionit për mospërlllogaritje të të ardhurave të krijuara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të babait të ish-bashkëshortit për periudhat e sipërcituara, për sa kohë nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit nuk u arrit të provohej niveli i të ardhurave të pretenduara.

**19.12** Lidhur me pretendimin e subjektit se është në pamundësi objektive, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, e vërtetuar kjo pamundësi me shkresën Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Berat dhe shkresën e DRT-së Berat, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk është relevant për zgjidhjen e çështjes, pasi edhe sikur të kishte arkiv dhe regjistër në Bashkinë Berat për regjistrimin e taksave për periudhën 1993-2002, përsëri nuk do të mund të përlllogaritej sa ka qenë fitimi i realizuar nga z. S. Gj. në këtë periudhë dhe, për rrjedhojë, nuk do të mund të provohej shuma e pretenduar si fitim vjetor nga subjekti i rivlerësimit. Nga të dhënat e shkresës së DRT-së Berat rezultoi se ndërsa të dhënat për periudhën 1993-1996, nëse kanë ekzistuar, mund të jenë djegur për shkak të trazirave të ndodhura në janar të vitit 1997, në arkivë nuk disponohen të dhëna për dosje të z. S. Gj. edhe për periudhën 1997-2002. Nga sa më sipër, rezultoi se për periudhën e fundit nuk plotësohen kriteret e përcaktuara nga pika 2, e nenit 32 e ligjit nr. 84/2016, që dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër, për ta vendosur subjektin e rivlerësimit në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave të babait të ish-bashkëshortit. Gjithashtu, trupi gjykues çmoi të pamundur përlllogaritjen nëpërmjet metodave alternative të këtyre ardhurave, sa kohë nuk u gjet asnjë e dhënë e dokumentuar, e cila të mund të orientonte drejt një niveli të caktuar xhiroje vjetore. Në këto kushte, trupi gjykues arriti në konkluzionin e njëjtë si Komisioni se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion se të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga babai i ish-bashkëshortit për periudhën 1993-2002 kanë qenë në masën 9.500.000 lekë.

**19.13** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se si prova të tjera të drejtpërdrejta, nga të cilat rezulton që prindërit e ish-bashkëshortit kanë krijuar të ardhura për periudhën 01.06.1993-dhjetor 2002, janë dokumentet e pasurive që ata kanë blerë gjatë kësaj periudhe, apartament banimi në Tiranë, një njësi tregtare në Durrës, si dhe dy automjete, trupi gjykues vlerësoi se fakti i blerjes së pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme nga prindërit e ish-bashkëshortit nuk provon se të ardhurat e krijuara nga ata janë të ligjshme, në kuptim të kriterëve të përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

**19.14** Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se prindërit e ish-bashkëshortit nuk janë përcaktuar në rezultatet e hetimit administrativ si persona të tjerë të lidhur, trupi gjykues vëren se këtë pretendim subjekti i rivlerësimit e ka lidhur me rubrikën e gjendur në fillim të rezultateve

të hetimit administrativ, në të cilën Komisioni ka paraqitur të dhënat për subjektin, si ditëlindja, gjendja civile, funksioni dhe të dhënat për personat e lidhur, sipas certifikatës së gjendjes civile. Në këtë rubrikë, Komisioni ka paraqitur si person tjetër të lidhur ish-bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit dhe jo persona të tjerë. Trupi gjykues vëren se kjo rubrikë e vendosur në pjesën hyrëse të rezultateve të hetimit prezanton të dhënat për subjektin e rivlerësimit dhe nuk përfshin të gjitha elementet e rezultuara nga hetimi administrativ. Në kushtet kur shuma prej 3.500.000 lekësh është dhënë nga prindërit e tij kundrejt ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës në të cilin subjekti dhe z. Gj. kanë qenë të lidhur në martesë ligjore, trupi gjykues vlerësoi se në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>14</sup>, ata konsiderohen persona të tjerë të lidhur, për pasojë konstatimi i Komisionit është i drejtë.

**19.15** Trupi gjykues e gjeti të pambështetur në rrethanat e çështjes edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka arsyetuar pse nuk ka pranuar si provë deklaratën noteriale të përbashkët të ish-bashkëshortit dhe prindërve të tij, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 26.10.2016, në të cilën është sqaruar burimi i krijimit të shumës prej 3.500.000 lekësh. Pa përsëritur sa është analizuar më sipër, trupi gjykues konstatoi se Komisioni e ka pranuar si provë deklaratën noteriale në fjalë, e ka përshkruar në vendim përmbajtjen e saj<sup>15</sup>, si dhe ka marrë në konsideratë e ka analizuar e verifikuar burimet e krijimit të deklaruara nga prindërit e ish-bashkëshortit në këtë deklaratë, madje nga analiza financiare<sup>16</sup> e kryer nga Komisioni për të verifikuar mundësinë e prindërve të ish-bashkëshortit për të krijuar shumën 3.500.000 lekë, rezultoi se në të është konsideruar e ardhura e përfituar nga shitja e shtëpisë në Berat në vitin 2001, në shumën 1.650.000 lekë, siç kanë deklaruar prindërit e z. Gj. në deklaratën noteriale.

**19.16** Në vijim të këtij arsyetimit, trupi gjykues e gjeti të pambështetur edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka konsideruar dhe as ka marrë në shqyrtim provat e dorëzuara prej saj, si dhe nuk ka arsyetuar shkaqet pse ato nuk janë vlerësuar. Nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në analizën që u ka bërë gjetjeve që lidhen me pasurinë apartament banimi, i është referuar qëndrimit apo shpjegimeve të dhëna për mbi to prej subjektit të rivlerësimit, si edhe akteve të dorëzuara prej tij gjatë zhvillimit të hetimit administrativ. Fakti që Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim të njëjtë me atë të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me vlerën provuese të akteve të administruara, nuk mund të kuptohet si mungesë arsyetimi apo si mohim i së drejtës për t'u dëgjuar e për të sjellë prova, sipas nenit 6 të KEDNj-së, por si ushtrim prej Komisionit i kompetencës analizuese e vlerësuese duke çmuar, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.

**19.17** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit në vendim, se nuk i është përgjigjur saktë pyetjes nëse prindërit e ish-bashkëshortit kishin blerë pasuri të tjera pasi kishin shitur shtëpinë në Berat, është i gabuar e tendencioz, pasi Komisioni duke u përpjekur të kapë në gabim subjektin, barrën e provës e kalon për tjetër fakt dhe konkluzionet i nxjerr për

---

<sup>14</sup> Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurive”.

<sup>15</sup> Paragrafi 1.5 i vendimit të Komisionit.

<sup>16</sup> E pasqyruar në paragrafin 1.12 të vendimit të Komisionit.

një fakt tjetër, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim<sup>17</sup>, ka arritur në konkluzionin se *subjekti nuk ka deklaruar saktë në pyetësor lidhur me pasuritë e blera nga prindërit e ish-bashkëshortit duke mos përmendur faktin e blerjeve të pasurive të paluajtshme në vlerën 1.000.000 lekë në vitin 2001 dhe në vlerën 500.000 lekë në vitin 2000*. Për të arritur në këtë konkluzion, Komisioni, në vendim, ka referuar kërkesat e bëra ndaj subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe përgjigjet e dhëna prej saj, të cilat sipas vlerësimit të Komisionit nuk kanë qenë përgjigje plotësisht të sakta. Nga verifikimi i pyetësorëve drejtuar subjektit të rivlerësimit, por edhe nga vetë referimi i bërë nga Komisioni në vendim, trupi gjykues vëren se subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të deklarojë nëse familja e ish-bashkëshortit ka blerë pasuri të paluajtshme pas shitjes, në vitin 2001, të apartamentit të tyre të ndodhur në qytetin e Beratit dhe sa ka qenë vlera e blerjeve të tyre. Në këtë kontekst, pretendimi i subjektit të rivlerësimit u gjet i drejtë, por trupi gjykues konstatoi se nuk qëndron pretendimi se ky konkluzion e ka ngarkuar atë me përgjegjësi disiplinore, pasi rezultoi se vlerat e pasurive apartament banimi në Tiranë blerë në vitin 2001 dhe njësi tregtare në Durrës blerë në vitin 2000, nuk janë përlllogaritur si shpenzime të kryera nga prindërit e ish-bashkëshortit në analizën financiare të kryer nga Komisioni mbi verifikimin e mundësisë për t'i dhënë djalit të tyre shumën 3.500.000 lekë, në *cash*. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit i kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur relevancë në arritjen e konkluzionit se prindërit e ish-bashkëshortit nuk kishin mundësi të krijonin shumën objekt verifikimi. I njëjti arsyetim shërbeu edhe për të rrëzuar pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni duhet të kishte mbajtur parasysh edhe jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës detyrimi i provueshmërisë lidhet vetëm me pasurinë objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë e personave të tjerë të lidhur, pasi trupi gjykues konstatoi se në analizën financiare nuk janë përlllogaritur shpenzimet e kryera nga prindërit e ish-bashkëshortit për krijimin e pasurive të tjera në pronësi të tyre, përpara vitit 2003, kur është pretenduar se i është dhënë shuma prej 3.500.000 lekësh ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**19.18** Pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë faktin se ka kërkuar informacione të më shumë se 20 viteve më parë, që kanë lidhje me veprimtari tregtare dhe financiare të prindërve të ish-bashkëshortit, me të cilin ka më shumë se 7 vjet e divorcuar, trupi gjykues e vlerësoi të pambështetur në prova e në ligj, pasi pasuria objekt kontrolli ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në atë kohë, me anë të kontratës së shitblerjes së pasurisë, e lidhur në vitin 2006. Në momentin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka qenë zyrtar deklarues dhe, për këtë shkak, ka bërë deklarinë e pasurisë për vitin 2006, sipas formularit përkatës, i cili në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003 kërkonte deklarinë e plotë dhe të saktë të burimit të krijimit të pasurisë dhe, për pasojë edhe dokumentacionin mbështetës të vërtetësisë së këtij deklarimi. Sa më sipër, detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e krijimit të kësaj pasurie nuk ka lindur për herë të parë në momentin e plotësimit të deklaratës së rivlerësimit, për pasojë barra e provës së kaluar nga Komisioni është e arsyeshme e proporcionale me rrethanat e krijimit të kësaj pasurie.

**19.19** Duke përdorur arsyetimin e konkluzionet e arritura më sipër, nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni, në lidhje me burimet financiare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e shumës prej 3.500.000 lekësh nga prindërit e ish-bashkëshortit, rezultoi se këta të fundit kishin pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e kësaj shume, në vlerën 1.578.169 lekë. Në kushtet kur kjo shumë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim

---

<sup>17</sup> Paragrafi 1, faqe 53 i vendimit të Komisionit.

krijimi për pasurinë apartament banimi në Vlorë, trupi gjykues arriti në përfundimin se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.578.169 lekë, për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, duke u gjendur në kushtet e parashikimit të nenit 32, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *konkluzioni i Komisionit se ka qenë në konflikt interesi me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “d”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është një konkluzion i pabazuar në fakt e në ligj.*

Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se: *“1.11.8 [...] subjekti i rivlerësimit është para një konflikti të interesit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Subjekti ka pasur proces gjyqësor me këtë shoqëri në fund të vitit 2003, duke pranuar kërkesëpadinë e saj dhe disa muaj më vonë ka përfutuar dhe përdorur pasurinë në pronësi të kësaj shoqërie, nga viti 2004 - 2006, pa kundërshtpërblim. Gjithashtu, ajo nuk arriti të provojë pagesën e pretenduar të kryer ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” SHPK në vitin 2005 për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme në shumën prej 3.000.000 lekësh. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë për këtë pasuri, nuk justifikon me burime të ligjshme blerjen e saj, si dhe ka qenë në konflikt interesi me palën shitëse, duke blerë pasurinë apartament nën çmimin e tregut dhe përdorur pakundërshtpërblim për rreth 2 vjet, duke u ndodhur në kushtet e shkronjës “d”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016”.*

20.1 Në kundërshtim të sa më sipër, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se kontrata për blerjen e apartamentit të banimit në Vlorë është lidhur në vitin 2006, ndërsa kanë banuar në të që prej fillimit të vitit 2005, pasi apartamenti është bërë i banueshëm gjatë fundit të vitit 2004. Përdorimi i tij deri në datën e lidhjes së kontratës së shitjes nuk është deklaruar në deklaratën e vitit 2004 dhe 2005, pasi sipas parashikimeve ligjore të kohës përdorimi i pasurisë së paluajtshme nuk ka qenë e parashikuar të deklarohej. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se apartamenti nuk është blerë nën çmimin e tregut siç arsyeton Komisioni, pasi gjatë hetimit administrativ ajo ka paraqitur kontrata të blerësve të tjerë, të cilët kanë paguar të njëjtin çmim si ajo. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se nuk ka qenë në konflikt interesi me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, pasi apartamenti është blerë dhe i është dorëzuar nga kjo shoqëri e më pas dhe është përdorur prej saj, pas më shumë se një vit, pasi ka dhënë vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.09.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me palë paditëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Sipas subjektit të rivlerësimit, në kohën e gjykimit të çështjes, ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, nuk ishte miratuar dhe madje nuk ka qenë në fuqi as në kohën kur ajo ka marrë në dorëzim pasurinë apartament banimi.

20.2 Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të cituara, në paragrafin 20 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues konstatoi se në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, pyetjes së Komisionit se *mund të deklaroni nëse keni pasur ndonjë çështje (gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarës) ose lidhje direkte apo indirekte, ju ose bashkëshorti juaj me shoqërinë “{\*\*\*}” apo me ortakun e vetëm të shoqërisë shtetasin L. Gj.?, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se deklaroj se kam pasur një gjykim me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.09.2003, vendim i cili ka marrë formë të prerë, i pa ankimuar nga palët. Nuk kemi pasur lidhje direkte apo indirekte, as unë as ish-bashkëshorti im, në dijeninë time, me ortakun e vetëm të shoqërisë shtetasin L. Gj.. Bashkëlidhur përgjigjes së sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.09.2003, të marrë prej saj në cilësinë e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me palë paditëse shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK dhe palë të paditur anëtarët e familjes Sh.. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka disponuar për pranimin e padisë dhe detyrimin e të paditurve për të paguar*

në favor të paditësit shumë 33.792 dollarë. Sipas shënimit të vendosur nga kancelarja e gjykatës, vendimi ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar.

**20.3** Nga kontrolli i vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se ky i fundit, në arsyetim, ka konsideruar faktin se pasuria apartament banimi në Vlorë është krijuar në vitin 2006, me rastin e lidhjes së kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.02.2006, mes subjektit të rivlerësimit e ish-bashkëshortit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e kësaj pasurie pakundërshtëpërblim në vitet 2004 dhe 2005. Komisioni ka përcaktuar si kohë të fillimit të marrëdhënies së interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK vitin 2004, duke abstraguar nga konkluzioni për datën e kryerjes së pagesës, e cila, sipas subjektit të rivlerësimit, ka ndodhur në vitin 2004.

Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Apartamenti na është dorëzuar në vitin 2004, rreth muajit korrik të këtij viti. Deri në fillim të vitit 2005 kemi përshtatur atë për banim dhe mund ta kemi përdorur rreth fundit të vitit 2004, fillimit të vitit 2005”*. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se: *“Apartamenti më është dorëzuar në vitin 2004. Kjo pasi në vitin 2004 kam kryer pagesën e plotë të apartamentit. Nga dita që kam kryer pagesën e plotë të apartamentit, kam përdorur këtë pasuri. Fillimisht për ta bërë të përshtatshëm për banim, më pas për të banuar. Posedimi faktik ka filluar rreth fundit të vitit 2004”*.

**20.4** Në analizë të gjendjes së subjektit të rivlerësimit në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, konstatohet se në vitin 2004, kur Komisioni ka konsideruar se ka filluar ekzistenca e interesit privat të subjektit të rivlerësimit, ligji nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”) nuk ishte miratuar ende. Për rrjedhojë, dispozitat e zbatueshme në rastin konkret, duhet të ishin ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, konkretisht neni 72 i tij<sup>18</sup>, i cili parashikon rastet kur një gjyqtar është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje. Neni 72, pika 1 dhe 6 e Kodit të Procedurës Civile, parashikon: *“Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; [...] 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie”*.

**20.5** Në dritën e këtyre parashikimeve ligjore, në raport me situatën faktike të konstatuar nga Komisioni, trupi gjykues vëren se marrëdhënia e interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK ka filluar në vitin 2004, pra, një vit më vonë nga gjykimi dhe dhënia e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.09.2003, prej subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kundrejt palës paditëse shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Komisioni nuk ka arritur të provojë nëpërmjet hetimit administrativ se marrëdhënia e subjektit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK ka filluar dhe/ose ka vazhduar në kohën e gjykimit të çështjes gjyqësore të

---

<sup>18</sup> Në nenin 72, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile, parashikohet: *“Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetres palë; 5. është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim; 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”*.

sipërcituar. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se nuk mund të provohet ekzistenca e interesit privat të subjektit të rivlerësimit dhe shfaqja e këtij interesi gjatë gjykimit dhe dhënies së vendimit gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 19.09.2003, në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Për pasojë, nuk mund të provohet lidhja mes marrëdhënies së krijuar mes subjektit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit në çështjen gjyqësore në fjalë, në mënyrë të tillë që kjo vendimmarrje të ketë qenë e ndikuar nga interesi i tij privat, në kuptim të nenit 72, pikat 1 dhe 6 të Kodit të Procedurës Civile. Trupi gjykues nënvizon se do të mbante të njëjtin qëndrim edhe në rast se si kohë e lindjes së interesit privat do të konsiderohej data e lidhjes së kontratës së shitjes më 08.02.2006, datë në të cilën ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, kishte hyrë në fuqi. Nga verifikimi i kontratave me objekt të ngjashëm, të lidhura nga individë të tjerë me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK<sup>19</sup> të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Komision, rezultoi se çmimi i dakordësuar nga palët është i njëjtë ose i përafërt me atë që ka paguar subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit në të njëjtën godinë. Pavarësisht këtij fakti, trupi gjykues çmoi se ligji i kohës nr. 9367/2005, parashikonte ndalimin e marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve apo trajtimeve preferenciale, si një nga rastet e kufizimit të interesave privatë të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta, nëse kjo çonte në lindjen e një konflikti qoftë dhe në dukje të interesit, duke e lidhur trajtimin preferencial të zyrtarit pazgjidhshmërisht me lindjen e konfliktit të interesit<sup>20</sup>, i cili në këtë kohë nuk ekzistonte, pasi subjekti i rivlerësimit kishte rreth 3 vjet që e kishte përfunduar gjykimin e çështjes gjyqësore me palë shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.

**20.6** Për pasojë, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK gjendet i bazuar, në prova e në ligj.

21. Në konkluzion, për pasurinë apartament në Vlorë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë të burimit të krijimit të saj në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare për krijimin e saj, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
22. *Lidhur me pasurinë “automjet tip Volkswagen Golf”, për të cilën subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se arsyetimi dhe konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*

**22.1** Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të kësaj pasurie, në vendim, ka arsyetuar: “2.10 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti nuk paraqiti shpjegime dhe prova bindëse për të kundërshtuar dhe rrëzuar gjetjet e Komisionit, për blerjen e pasurisë automjet në vitin 2016. 2.10.1 Lidhur me pretendimet e subjektit për zbritje të shpenzimeve të jetesës për fëmijët, pasi sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2013, të gjykatës për zgjidhjen e martesës ata qëndrojnë me të atin në fundjavë dhe dy javë në vit, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka qenë e saktë. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka deklaruar se ish-

---

<sup>19</sup> Subjekti ka paraqitur: kontratë shitje apartamenti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.11.2005, lidhur mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe z. D. e znj. S. S., për shitjen e apartamentit me sip. 102,22 m<sup>2</sup>, për çmimin 3.000.000 lekë; kontratë shitje apartamenti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.05.2005, lidhur mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe znj. L. P., për shitjen e apartamentit me sip. 102,22 m<sup>2</sup>, për çmimin 3.0600.000 lekë; kontratë shitje apartamenti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.02.2005, lidhur mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe znj. M. Z., për shitjen e apartamentit me sip. 57,74 m<sup>2</sup>, për çmimin 1.500.000 lekë; etj.

<sup>20</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 21/2020 (JR), datë 10.09.2020.

*bashkëshorti ishte shkëputur gradualisht nga banesa ku kishin jetuar së bashku. Gjithashtu, ajo deklaroi në përgjigje pyetësorit nr. 3 se ish-bashkëshorti i takonte fëmijët në po këtë banesë (apartamenti në rr. “{\*\*\*}”), meqenëse kishte ambiente të bollshme. Për më tepër, subjekti deklaroi se edhe aktualisht takimet me fëmijët ish-bashkëshorti i kryente në banesën e saj. 2.10.2 Lidhur me pretendimet e subjektit për gjendjen cash nga viti i kaluar, e cila ka shërbyer për blerjen e automjetit, Komisioni, në analizën financiare, merr parasysh ndryshimet e kursimeve cash të deklaruara në deklaratat periodike vjetore. Subjekti nuk deklaroi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 pakësim të kursimeve cash për blerjen e këtij automjeti (detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9049/2003). 2.10.3 Lidhur me paqartësinë e subjektit për ndryshimet e likuiditetit, Komisioni sqaron se ky zë përfshin ndryshimin e likuiditeteve (bankë + kursime cash) për periudhën 31.12.2015-05.05.2016. Ndërkohë, gjendet e likuiditeteve në banka janë domosdoshmërisht pjesë e analizës financiare, ndryshe nga pretendimi i subjektit. Ndryshimi i likuiditeteve llogaritet pikërisht si diferenca mes gjendjeve të tyre nga një moment kohor në tjetrin. 2.11 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri dhe nuk justifikon me burime të ligjshme blerjen e saj, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016”.*

**22.2** Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të pabazuar në ligj konkluzionin e Komisionit lidhur me pamundësinë e saj për të justifikuar me burime të ligjshme financiare krijimin e automjetit të tipit “Volkswagen Golf”. Këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit e mbështeti në pretendimet se:

(i) Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, është ngarkuar dy herë për të njëjtat shpenzime edhe sipas standardit të INSTAT-it edhe sipas shpenzimeve që ka kryer faktikisht nga blerjet *online* me kartë debiti, shpenzime që përfshihen në paketën e buxhetit të familjes, për vetë natyrën e këtyre blerjeve, të cilat kanë qenë shpenzime jetike dhe jo blerje luks.

(ii) Shpenzimet e jetesës duhet të ishin përlllogaritur nga Komisioni, duke zbritur nga standardi i INSTAT-it shpenzimet për të dy fëmijët e mitur për çdo fundjavë, si dhe për datat 2 dhe 3 maj 2016, ditë në të cilat shpenzimet e tyre janë përballuar nga i ati. Takimet e ish-bashkëshortit me fëmijët janë kryer në banesën e saj, por në asnjë rast subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se gjatë këtyre ditëve shpenzimet e jetesës së fëmijëve janë përballuar prej saj. I njëjti pretendim është parashtruar prej subjektit të rivlerësimit dhe për mënyrën e përlllogaritjes nga Komisioni të shpenzimeve për udhëtime jashtë vendit, duke pretenduar se është ngarkuar në mënyrë të dyfishtë me shpenzime jetese edhe për dy ditët gjatë vitit 2016, në të cilat ka udhëtuar jashtë vendit.

(iii) Në analizën financiare për verifikimin e pasurisë objekt kontrolli të kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka kuptuar se çfarë përfaqëson zëri *shtim likuiditeti* dhe pse ky zë llogaritet si shpenzim dhe jo si e ardhur, megjithëse vetë fjala *shtim likuiditeti* do të thotë mundësi financiare më shumë e jo shpenzim.

(iv) Si burim për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf” kanë shërbyer kursimet e subjektit të rivlerësimit. Ajo nuk ka bërë në asnjë moment deklarim të pakësimit të gjendjes *cash* të mbetur pas përdorimit të shumës prej 3.000.000 lekësh të deklaruar në vitin 2003, duke e konsideruar se ajo mbartet çdo vit. Duke qenë se ka deklaruar një herë të ardhurat nga pagat dhe nuk ka pasur të ardhura nga burime të tjera, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të deklarojë atë që ka mbetur nga të ardhurat e deklaruara më parë. Në tabelën financiare të Komisionit nuk është përfshirë as gjendja e kursimeve në *cash* në shumën 300.000 lekë, që ka qenë gjendje në banesë e mbartur që nga viti 2007.

22.3 Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të kundërshtimit të rezultatit të analizës financiare si pasojë e përllogaritjes së gabuar dhe të padrejtë të shpenzimeve të jetesës, trupi gjykues i vlerësoi ato të pabazuara. Arsyetimi i detajuar i këtij konkluzioni pasqyrohet në vijim, i grupuar tematikisht për të evituar përsëritjen në këtë vendim, në analizën e pretendimeve në ankim për këtë zë shpenzimesh, parashtruar nga subjekti i rivlerësimit për disa vite të rezultuar me balancë negative në vendimin e Komisionit.

22.4 Për sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me paqartësinë mbi mënyrën e përllogaritjes së zërit “Shtim likuiditeti” në analizën financiare për verifikimin e pasurisë objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi se ky pretendim është një përsëritje e qëndrimit të subjektit të rivlerësimit pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, pretendim të cilit Komisioni i ka dhënë përgjigje në vendim, duke referuar se *ky zë i analizës financiare përfshin ndryshimin e likuiditeteve për periudhën e marrë në analizë, i cili llogaritet pikërisht si diferenca mes gjendjeve të tyre nga një moment kohor në tjetrin*. Duke e gjetur të drejtë këtë shpjegim të Komisionit, trupi gjykues verifikoi vlerën e pasqyruar në këtë zë të analizës, nga rezultoi se ishte vlera ishte e saktë. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, u konstatua i pabazuar.

22.5 Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, mbi përdorimin e kursimeve në *cash* për blerjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, trupi gjykues konstatoi se të njëjtin qëndrim mbi deklarin e këtij burim krijimi të pasurisë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit e ka mbajtur në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si edhe në deklaratën periodike të interesave të vitit 2016. Trupi gjykues e gjeti të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në vitin 2007 ka pasur një gjendje kursimesh në *cash* prej 300.000 lekësh, pasi nga verifikimi i deklaratave periodike të interesave gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit 2003-2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar në asnjë prej tyre, shtesa apo pakësime të kursimeve në *cash*, për pasojë shuma e pretenduar nuk gjendej e evidentuar në asnjë nga deklarinimet e pasurisë deri në vitin 2007.

22.6 Trupi gjykues vlerësoi të pabazuar edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se duke qenë se ka deklaruar një herë të ardhurat nga pagat, si dhe nuk ka pasur të ardhura nga burime të tjera, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të deklarojë atë që ka mbetur nga të ardhurat e deklaruara më parë. Në vlerësim të trupit gjykues një pretendim i tillë vjen në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, i cili në nenin 4 vendos për zyrtarët deklarues, detyrimin për deklarinimin jo vetëm të të ardhurave, por, ndër të tjera, edhe të ndryshimeve, shtesave apo pakësimeve të kursimeve në *cash*, të realizuara gjatë vitit, si rezultat i diferencës mes të ardhurave dhe shpenzimeve. Në mbështetje të qëndrimit të konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit, ekzistenca e këtyre kursimeve nuk mund të prezumohet nga organet e rivlerësimit, por duhet të jetë evidentuar në deklaratat periodike të interesave, të cilat shërbejnë si provë në këtë proces, në bazë të parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në vijim të analizës së këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të potencojë konkluzionin e arritur më sipër në këtë vendim se nga shuma prej 3.500.000 lekësh kursime në *cash* e deklaruar nga subjekti në vitin 2003, vetëm 1.921.831 lekë mund të ishin krijuar me burime të ligjshme, të cilat pretendohet nga subjekti i rivlerësimit se janë përdorur për blerjen e pasurisë *apartment në Vlorë*. Për rrjedhojë, edhe në një qasje garantiste, shuma e pretenduar prej 300.000 lekësh *cash* gjendje në vitin 2007 nuk do të rezultonte e krijuar nga burime të ligjshme, në kushtet kur nga subjekti i rivlerësimit ajo është pretenduar si mbetje nga diferenca prej 500.000 lekësh mes shumës prej 3.500.000 lekësh



deklaruar në gjendje *cash* në vitin 2003 dhënë ish-bashkëshortit nga prindërit e tij dhe vlerës prej 3.000.000 lekësh të blerjes së apartamentit të banimit në vitin 2006.

22.7 Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, Komisioni duhet të kishte mbajtur parasysh vlerën konkrete prej 100.000 lekësh të automjetit tip “Volkswagen Golf” në raport me të ardhurat vjetore të saj, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk është i bazuar në fakte, pasi pasuria objekt kontrolli është blerë në datën 05.05.2016, për pasojë Komisioni nuk mund t’i referohej të ardhurave vjetore për të verifikuar mundësinë e krijimit të kësaj pasurie me burime financiare të ligjshme, por me të drejtë ka kryer analizën financiare nga fillimi i vitit deri në këtë datë, duke përfshirë në të edhe shpenzime të tjera të kryera nga subjekti i rivlerësimit, për këtë periudhë.

23. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, konstatoi se konfirmohet konkluzioni i arritur nga ky i fundit se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, në shumën 239.065 lekë, për krijimin e pasurisë automjet tip “Volkswagen Golf”, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

24. *Lidhur me pasuritë “depozita bankare në Union Bank, të krijuara në datën 05.01.2015”, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni, në konkluzionin e tij, nuk ka mbajtur në konsideratë parimin e barazisë së shtetasve para ligjit dhe atë të proporcionalitetit, duke pasur parasysh vlerën e vogël të të dyja depozitave së bashku, vlerë e cila duhet të kishte çuar në konkluzionin se ndaj subjektit nuk mund të vendosej masa disiplinore e shkarkimit, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*

24.1 Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të këtyre depozitave bankare, lidhur me secilën prej tyre, ka arritur në përfundimin<sup>21</sup> e njëjtë se: “*Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të nenit 33, pika 5 të ligjit nr. 84/2016*”, duke arsyetuar në vendim<sup>22</sup> se “[...] në deklaramin periodik vjetor të vitit 2014, subjekti nuk deklaroi shtim të kursimeve *cash* që të mund të shtohen si rritje likuiditetesh në analizën financiare. Gjithashtu, në deklaramin periodik vjetor të vitit 2015 nuk deklarohet pakësim i kursimeve *cash* si burim për krijimin e kësaj depozite (detyrim ky që rrjedh nga ligji nr. 9049/2003)”.

24.2 Prapësimet e subjektit të rivlerësimit, në ankim, janë përsëritje e shpjegimeve të dhëna në Komision, në kundërshtim të rezultateve të hetimit administrativ, si vijon.

(i) Depozitat objekt kontrolli janë llogari kursimi në të cilat janë depozituar kursime nga detyrimi për ushqim i fëmijëve të mitur dhënë nga babai i tyre ose dhurata që fëmijëve të mitur u kanë bërë të afërmit, gjyshërit, halla, teza, etj. me rastin e festave, ditëlindjeve etj. për të cilat, në fund të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni shifrën konkrete.

(ii) Vetë fakti që depozitat janë çelur në datën 05.01.2015, provon që kanë qenë kursime nga viti paraardhës. Mungesa e deklaramit të tyre në deklaramin e vitit 2014, ka ardhur për shkakun se subjekti i rivlerësimit ka menduar se i ka deklaruar njëherë në rubrikën e formularit për të ardhurat dhe nuk ka qenë e nevojshme të deklarojë sa i kishin mbetur prej tyre.

<sup>21</sup> Faqe 53 e vendimit të Komisionit.

<sup>22</sup> Paragrafët 3.10.1 dhe 4.10.1 të vendimit të Komisionit.

(iii) Komisioni duhet të kishte zbatuar parimin e proporcionalitetit, duke pasur parasysh vlerën e vogël prej 100.000 lekësh të të dyja depozitave së bashku, vlerë për të cilën ndaj subjektit nuk mund të vendosej masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

24.3 Në kuadër të analizës mbi vlerësimin e pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues fillimisht konstatoi se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për depozitat bankare në “Union Bank”, dega Vlorë, gjendje në datën e plotësimit të deklaratës 23.01.2017, përkatësisht në shumat 150.629 lekë dhe 200.716 lekë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi - *kursimet*. Në deklaratën e interesave të vitit 2015, lidhur me këto pasuri ka deklaruar si burim krijimi *kursimet nga viti paraardhës*. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të drejtuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Depozitat [...] kanë filluar me vlerën 70.000 lekë dhe 30.000 lekë, me një pjesë të detyrimit për ushqim që ish-bashkëshorti ka pasur ndaj fëmijëve të mitur në vitin 2015, detyrim të cilin ua ka dorëzuar fëmijëve. [...] në muajin mars të po të njëjtit vit janë hedhur kursime të fëmijëve, nga dhurata që u kanë dhënë të afërmit për ditëlindje apo festa, kursime që i kanë pasur në “kasat” e tyre personale dhe janë rrumbullakosur prej meje në vlera të vogla, [...]”*. Nga situata faktike e mësipërme, trupi gjykues vëren se bazuar në deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, në të cilat ka shpjeguar burimet e krijimit të këtyre depozitave, përjashtohet mundësia e financimit të tyre me kursimet e vitit 2014, pasi jo vetëm se nuk janë përmendur si burim krijimi nga vetë subjekti i rivlerësimit, por edhe se në deklaratën periodike të interesave të vitit 2014, subjekti nuk ka deklaruar kursime në *cash* të disponueshme, të krijuara gjatë këtij viti. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se si burim për financimin e depozitave në datën 05.01.2015, kanë shërbyer kursimet e vitit 2014, mbeti në nivel deklarativ dhe i pabazuar në prova.

24.4 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni duhet të kishte zbatuar parimin e proporcionalitetit, duke pasur parasysh vlerën e vogël prej 100.000 lekësh të të dyja depozitave së bashku, vlerë për të cilën ndaj subjektit nuk mund të vendosej masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, trupi gjykues vëren se dispozitat kushtetuese dhe ato të parashikuara nga ligji nr. 84/2016, i referohen aplikimit të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit për zgjidhjen e çështjes në tërësi, duke synuar që në kuadër të rivlerësimit të subjekteve të këtij ligji, masa disiplinore e dhënë të jetë në përpjesëtim të drejtë me shkeljet e konstatuara. Për rrjedhojë, aplikimi i këtij parimi nuk gjen vend në vlerësimin e çdo pasurie, por në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë dhe kriterëve të tjera të kontrollit, sipas rastit.

25. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këto pasuri dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e tyre në shumën 100.000 lekë, në datën 05.01.2015, në kuptim të parashikimeve të shkronjës “b”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
26. Lidhur me pasurinë *“depozitë bankare në Union Bank” të çelur në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit është i gabuar, pasi provat dhe argumentet e dhëna prej saj gjatë hetimit administrativ kanë qenë të mjaftueshme për të provuar se burimi i krijimit të kësaj pasurie ka qenë i ligjshëm, trupi gjykues konstatoi si vijon.*

**26.1** Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të kësaj pasurie, ka arsyetuar<sup>23</sup> se në datën 18.10.2006 subjekti ka deklaruar se ka tërhequr nga kjo depozitë shumën 470.755 lekë dhe pretendon që këto i ka lënë në ruajtje tek e motra, znj. R. O. Në DPV-në e vitit 2006 nuk deklarohet as lënia në ruajtje e këtyre parave te ndonjë person tjetër dhe as si kursime cash. Në analizën financiare e gjithë shuma e tërhequr nga depozita u konsiderua nga Komisioni si shpenzim i atij viti. [...] Shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, pasi nga njëra anë ka deklaruar se ka qenë depozitë e saj pa dijeninë e ish-bashkëshortit dhe nga ana tjetër ka deklaruar se burimi për krijimin e kësaj depozite kanë qenë të ardhurat e ish-bashkëshortit dhe prindërve të tij (kjo sipas deklaratës periodike vjetore të vitit 2005). Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 subjekti nuk ka deklaruar kursime cash nga të ardhurat e saj. Të vetmet kursime cash subjekti i ka deklaruar në vitin 2003 me të ardhura të bashkëshortit, por dhe për ato burime është në pamundësi financiare. Subjekti nuk ka deklaruar ndryshimin e gjendjes cash (në deklaratat periodike vjetore të viteve 2006 - 2010) për shumën e tërhequr në bankë dhe as dhënien në ruajtje të kësaj shume motrës së saj. Subjekti nuk ka deklaruar kursime cash në deklaratën e viteve 2003 dhe 2004, si dhe as huan e dhënë dhe të kthyer nga mikja e saj në vitin 2006. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këto pasuri, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e kësaj depozite, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**26.2** Subjekti i rivlerësimit, në ankim, në kundërshtim të arsyetimit dhe konkluzionit të mësipërm të Komisionit, ka parashtruar pretendime të cilat rezultojnë të jenë të njëjta me ato të parashtruara në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, si vijon.

(i) Kjo pasuri nuk ka ekzistuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, për pasojë ajo nuk mund të jetë objekt hetimit për efekt të procesit të rivlerësimit.

(ii) Në vitin 2005 ka deklaruar çeljen e një depozite me afat, në shumën 451.265 lekë në Bankën Amerikane, dega Vlorë. Në ndryshim nga sa ka arsyetuar Komisioni, në deklaratën periodike të vitit 2005, kur ka deklaruar çeljen e kësaj depozite, duke shprehur *deklaruar më parë shuma* ka dashur të thotë që rrjedh nga të ardhurat e saj të deklaruara në vitin e mëparshëm.

(iii) Në deklaratën e vitit 2004 nuk ka deklaruar kursime dhe as huan e dhënë dhe kthyer nga mikja e saj, pasi në vlerësimin e saj të ardhurat apo pasuritë e deklaruara më parë nuk ishte e nevojshme të rideklaroheshin në deklaratat vijuese, pasi, sipas saj, duke qenë se nuk kishte deklaruar shpenzim tej kufirit të parashikuar, pra, nuk kishte deklaruar ndryshim, nuk ka qenë e nevojshme rideklarimi i së njëjtës pasuri. Nga Komisioni nuk është mbajtur parasysh fakti se vetë deklarata vjetore nuk kërkonte pasqyrimin e shumës totale gjendje në *cash*, por vetëm shtesat e krijuara gjatë atij viti. Nga të ardhurat personale të subjektit dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit 2004, konstatohet lehtësisht se ka pasur mundësi kursimi nga paga të kësaj shume.

(iv) Në datën 18.10.2006, kjo depozitë është maturuar dhe është tërhequr bashkë me interesin, në total 470.755 lekë dhe këtë shumë ia ka lënë motrës së saj në ruajtje. Në deklaratën e vitit 2006 ka deklaruar mjaftueshëm në lidhje me këtë shumë - në njëren fletë ka deklaruar tërheqjen e depozitës dhe në fletën tjetër ka deklaruar shtimin e likuiditetit. Po ashtu, në deklaratat periodike të interesave në vitet 2007, 2008 dhe 2009 nuk ka deklaruar shpenzim të saj dhe as shpenzime të cilat ta kenë pasur si burim këtë shumë. Komisioni ka gabuar në pasqyrimin e kësaj shume si shpenzim në vitin 2006, pasi duhet të pasqyrohej si likuiditet. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar

---

<sup>23</sup> Paragrafët 8.9 - 8.13 të vendimit të Komisionit.

se fakti i lënies së kësaj shume pas tërheqjes për ruajtje te motra e saj është një marrëdhënie që nuk duhet të deklarohej, pasi nuk përbën hua apo dhurim. Motra këtë shumë ia ka dërguar me transfertë bankare, në shumën 550.000 lekë, e cila ka shërbyer për çeljen e depozitës në “Union Bank”, në vitin 2010, së bashku me kursime të tjera të subjektit të asaj periudhe.

(v) Depozita e krijuar në vitin 2010 është tërhequr dhe mbyllur në vitin 2016 dhe ka shërbyer për të shlyer një hua marrë motrës së saj në të njëjtin vit, në shumën 500.000 lekë, hua e marrë me qëllim pagesën e shpenzimeve për arsim të vajzës së saj, në një shkollë verore jashtë vendit. Kjo depozitë është pasqyruar gabim në tabelën financiare të Komisionit, pasi shuma e tërhequr nga mbyllja e saj nuk gjen pasqyrim te likuiditetet e vitit 2016, por në këtë vit është përfshirë te zëri i shpenzimeve.

**26.3** Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se kjo pasuri nuk ka ekzistuar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 dhe në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, për pasojë ajo nuk mund të jetë objekt hetimit për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se depozita bankare në “Union Bank” është çelur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2010 dhe është mbyllur në vitin 2016, brenda periudhës së rivlerësimit dhe, për pasojë, është një pasuri e cila do të duhet t’i nënshtrohet kontrollit të burimit të krijimit të saj, në funksion të analizës financiare 2003-2016, në përputhje me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës e dispozitave të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për efekt të procesit të rivlerësimit.

**26.4** Në funksion të zgjidhjes së pretendimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mori në shqyrtim deklarin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2010 dhe shpjegimet e dhëna prej saj gjatë procesit të rivlerësimit, në këndvështrim të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për të provuar bindshëm ligjshmërinë e krijimit të pasurisë depozitë në “Union Bank”, të çelur më datë 14.07.2010, në shumën 550.000 lekë dhe e mbyllur në vitin 2016, duke konstatuar se si burim krijimi të pasurisë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kalimin e shumës prej 550.000 lekësh nga motra e saj nëpërmjet sistemit bankar, shumë e cila i ishte lënë në ruajtje nga subjekti në vitin 2006<sup>24</sup>, që rridhte nga tërheqja në të njëjtin vit e depozitës bankare të çelur në Bankën Amerikane, dega Vlorë, në vitin 2005.

Trupi gjykues çmoi të besueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit që kjo shumë e lënë për ruajtje nga subjekti i rivlerësimit te motra e saj të jetë kthyer më pas në kah të kundërt nëpërmjet transfertës bankare, në kushtet kur: (i) data e mbylljes së llogarisë dhe tërheqjes së shumës 470.755 lekë ka qenë data 18.10.2006<sup>25</sup>, një datë afër fundit të vitit 2006; (ii) ky fakt është deklaruar në deklaratën e vitit 2010; si dhe (iii) në kushtet kur Komisioni nuk ka ngritur as në nivelin e dyshimeve se kjo shumë nuk i përket subjektit të rivlerësimit.

Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se rrethanat që konsiderohen relevante e të rëndësishme në vlerësimin e shkakut të ankimit, lidhen me verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të krijuar depozitën bankare në Bankën Amerikane, dega Vlorë, në datën 08.06.2005, në shumën 451.265 lekë, e cila ka shërbyer si origjinë për çeljen e depozitës në “Union Bank”, në datën 14.07.2010, në shumën 550.000 lekë.

---

<sup>24</sup> Në deklaratën periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Depozitë bankare në Union Bank me kontratën e datës 14.07.2010, me kohëzgjatje deri në datën 09.02.2011, në vlerën 550.000 lekë. Burimi i të ardhurave: kursime nga paga, pjesërisht të ardhura të deklaruar më parë në deklaratat paraardhëse, dërguar nga Raiffeisen Bank nga shtetasja R. O. (motra), ku i kisha lënë në ruajtje”.

<sup>25</sup> Sipas informacionit të përcjellë subjektit të rivlerësimit nga Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën e datës 19.11.2020 dhe paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në Komision.

**26.5** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve nr. 3 dhe nr. 4 të drejtuar nga Komisioni, si dhe në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, në shpjegim edhe të burimit të krijimit të pasurisë objekt kontrolli të deklaruar në deklaratën e vitit 2005<sup>26</sup>, ka shpjeguar se *burimi i krijimit të kësaj llogarie kanë qenë të ardhurat e mia të një viti më parë, të cilat janë deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, siç edhe kam deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005*. Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit e ka mbajtur edhe në ankim, duke u përpjekur të justifikojë mungesën e deklarimit të kursimit në *cash* në vitin 2004, me kuptimin e saj mbi mënyrën e të deklaruarit se duke deklaruar të ardhurat ka deklaruar dhe kursimet, konceptim ky që vjen në kundërshtim jo vetëm me logjikën ekonomike të përkufizimit të kursimeve, të cilat krijohen si rezultat i zbritjes së shpenzimeve nga të ardhurat, por edhe me kontrollin aritmetik e logjik për të vërtetuar saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara prej zyrtarit deklarues<sup>27</sup>, sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003. Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së vitit 2004, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në *cash*, në fund të këtij viti. Edhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni dhe e verifikuar e kontrolluar në Kolegj, rezultoi se viti 2004 është mbyllur me balancë negative të raportit mes të ardhurave<sup>28</sup> dhe shpenzimeve të kryera, për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të krijonte kursimet e pretenduara në *cash*.

Trupi gjykues i gjeti të drejta edhe konstatimet e Komisionit se në deklaratën e pasurisë së vitit 2006, megjithëse nga subjekti i rivlerësimit është deklaruar tërheqja e depozitës së çelur në vitin 2005, nuk është deklaruar se paratë e tërhequra janë disponuar në gjendje *cash*<sup>29</sup>. Për pasojë, burimi financiar i deklaruar i krijimit të kësaj pasurie është i pabazuar në prova e në ligj.

27. Në të tilla kushte, trupi gjykues çmoi se për trajtimin sa më të plotë të këtij shkak ankimi, që ka lidhje me verifikimin e mundësisë për të krijuar me burime të ligjshme krijimin e depozitës në “Union Bank”, objekt i një analize më të detajuar do të jetë analiza financiare për vitin 2010, në të cilën kjo pasuri do të konsiderohet e krijuar me burim të ardhurat e subjektit të rivlerësimit në vitin përkatës.
28. *Për pasuritë automjete në pronësinë e ish-bashkëshortit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzionet e Komisionit, përveçse janë në tejkallim të objektit të procesit të rivlerësimit, janë të pabazuara në prova.*

**28.1** Në analizë të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka kontrolluar pasuritë në pronësi të z. E. Gj., për të cilat ka rezultuar si më poshtë.

---

<sup>26</sup> Në verifikimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, konstatohet se në deklaratën e pasurisë së vitit 2005, subjekti ka deklaruar: “Depozitë bankare, Banka Amerikane Vlorë, qershor 2005 (deklaruar edhe më parë shuma). Vlera: 451.256 lekë principali, 9.616 lekë interesi. Pjesa takuese: 100%”.

<sup>27</sup> Neni 21, pika 2 e ligjit nr. 9049/2003, parashikon: “1. Kontrolli i deklarimeve përfshin kontrollin, aritmetik e logjik, dhe verifikimin e miratimit të dhënave të deklaratës (kontroll i plotë). Kontrollin, aritmetik dhe logjik, kryhen për çdo deklaram për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara.”

<sup>28</sup> Në analizën financiare të vitit 2004, janë përlllogaritur të ardhura vetëm për subjektin e rivlerësimit, pasi nuk vërtetohen të ardhura të realizuara nga bashkëshorti i saj në këtë vit.

<sup>29</sup> Në deklaratën e pasurisë të vitit 2006, në rubrikën “Ndryshimet e pasurisë dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar: “Tërheqje depozite te Banka Amerikane, dega Vlorë, datë 18.10.2006. Vlera: 470.755 lekë (deklaruar më parë). Pjesa takuese: 100%.” Të njëjtin deklaram e ka bërë edhe në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhimet nga veprimtari publike dhe/ose private”.

- i. automjet tip “Nissan Patrol” blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.06.2010;
- ii. automjet tip “Renault” blerë me anë të kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.06.2003;
- iii. automjet tip “Honda” blerë në vitin 2003;
- iv. automjet tip “BMW” e blerë nga personi i lidhur në datën 25.02.2002 dhe e shitur me anë të kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.06.2003.

**28.2** Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të këtyre pasurive, ka arritur në këto konkluzione<sup>30</sup>: *Për pasurinë automjet tip “Nissan Patrol”, në vlerën 250.000 lekë, subjekti ka pasaktësi në deklarim, mosdeklarim të çmimit real të blerjes dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur brenda parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklarim të pamjaftueshëm dhe kontradiktor për pasuritë automjet tip “Renault” dhe “Honda” dhe likuiditetet, si dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurisë automjet tip “BMW”, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.*

**28.3** Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se konkluzionet e Komisionit janë në tejkalim të objektit të procesit të rivlerësimit, pasi ish-bashkëshorti nuk është person i lidhur me të, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, por edhe për faktin se këto pasuri nuk kanë shërbyer si burim krijimi për pasuri të subjektit të rivlerësimit, si dhe janë shitur e nuk kanë qenë në pronësi të ish-bashkëshortit në kohën e plotësimit të deklaratës së rivlerësimit, për pasojë hetimi lidhur me këto pasuri është jashtë objektit të hetimit për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe z. E. Gj. kanë lidhur martesë ligjore midis tyre më datë 07.11.1994, të cilën e kanë zgjidhur më datë 05.12.2013<sup>31</sup>.

**28.4** Në referim të dispozitave të zbatueshme lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues vëren se neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, parashikojnë se objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Ndërsa sipas pikës 13, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 “Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit. Në vijim të analizës mbi pretendimin e subjektit të rivlerësimit, në raport edhe me rrethanat e rezultuara nga aktet e administruara nga Komisioni, sipas të cilave automjeti tip “Nissan Patrol” është blerë nga z. E. Gj. në datën 22.06.2010<sup>32</sup>, automjeti tip “Renault” është blerë në datë 11.06.2003, automjet tip “Honda” është blerë në vitin 2003 dhe automjeti tip “BMW” është blerë

<sup>30</sup> Faqja 53 e vendimit të Komisionit.

<sup>31</sup> Sipas të dhënave të pasqyruara në vendimin nr. 2616, datë 05.12.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka vendosur zgjidhjen e martesës ligjore mes E. Gj. dhe Klodiana Gjyzari.

<sup>32</sup> Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, çmimi prej 250.000 lekësh për blerjen e automjetit, është likuiduar nga z. Gj. jashtë zyrës noteriale.

në datën 25.02.2002 dhe shitur në datën 27.06.2003, trupi gjykues vlerësoi se konkluzionet e Komisionit lidhur me këto pasuri nuk janë në tejkalim të objektit të procesit të rivlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi i automjeteve në pronësi të ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit bëhet me qëllim verifikimin e mundësive të subjektit të rivlerësimit për t'i krijuar me të ardhura të ligjshme pasuritë dhe për të kryer shpenzimet në kuadër të analizës financiare 2003-2016, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit dhe z. E. Gj. kanë qenë në të njëjtën certifikatë familjare deri në datën 05.12.2013, për pasojë kanë qenë persona të lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit janë të pabazuara në fakte dhe në ligj dhe nuk mund të përbëjnë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.

**28.5** Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk duhet të ngarkohet me përgjegjësi për deklaram të pasaktë të automjeteve të analizuara më sipër, trupi gjykues vëren se në paragrafët e vendimit kushtuar analizës së kontrollit të këtyre pasurive, Komisioni nuk ka arsyetuar dhe as konkluduar lidhur me pasaktësi në deklaramin e këtyre pasurive, pasi për këto pasuri subjekti i rivlerësimit nuk gjendej nën detyrimin e deklaramit në përputhje me kërkesat e formularit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit dhe të ligjit nr. 84/2016, pasi për këto pasuri nuk gëzonte të drejta reale në momentin e plotësimit të deklaratës në fjalë.

29. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, për pasurinë automjet tip “BMW”, ka mbajtur një qëndrim me dy standarde, pasi nga njëra anë ngarkon subjektin me barrën e provës për një automjet që nuk ka qenë pronë e saj, nga ana tjetër arrin në konkluzionin se pavarësisht se kanë pasur burime të ligjshme nga paga e saj, automjeti nuk është krijuar me burime të ligjshme, duke qenë se ajo ka deklaruar se ish-bashkëshorti e ka blerë me fitimet e punës së tij, trupi gjykues konstatoi se Komisioni në vendim ka arsyetuar se subjekti pretendoi që meqenëse analiza e periudhës 1998-2003 është me rezultat pozitiv, atëherë nga kjo rezulton se subjekti dhe ish-bashkëshorti kishin mundësi të ligjshme të blerjes së automjetit tip “BMW” në vitin 2002. Nëse reflektojmë uljen e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1998-2002, vërtet rezultati i kësaj periudhe del pozitiv, por subjekti kishte deklaruar në pyetësor se automjeti është blerë me të ardhurat e ish-bashkëshortit. Ndërkohë, në periudhën 1998-2002 nuk provohet ligjshmëria e të ardhurave të tij, kështu që automjeti rezultoi me burim të ligjshëm ende të paprovuar.*

**29.1** Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se, edhe pse kjo pasuri është blerë nga personi i lidhur në datën 25.02.2002 dhe është shitur në datën 27.06.2003<sup>33</sup>, nuk është deklaruar në deklaratën fillestare të vitit 2003. Komisioni, verifikimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie e ka kryer mbështetur në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 3, në të cilin ka deklaruar se *burimi i blerjes së kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat e punës së ish-bashkëshortit ose të ardhurat e tij nga puna në emigracion, nuk jam në dijeni, por ka qenë automjeti i tij ekskluziv. Të ardhurat e fituara nga shitja janë përdorur për blerjen e automjeteve të tjera të tij, së bashku me të ardhura të tjera të ish-bashkëshortit.* Bazuar në këtë deklaram, Komisioni me të drejtë ka konstatuar se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë përjashtuar prej vetë atij, nga mundësia për të shërbyer si burim financiar krijimi për pasurinë objekt kontrolli. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie kanë shërbyer si burim krijimi për automjetet e tjera të blera në vitin 2003, Komisioni ka verifikuar mundësinë e z. E. Gj. për të krijuar pasurinë automjet tip “BMW” në vitin 2002, me të ardhurat e tij.

<sup>33</sup> Sipas kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 27.06.2003, e paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision.

**29.2** Trupi gjykues konstatoi se në analizën financiare për periudhën 1998-2002, çmimi i automjetit është përllëgaritur nga Komisioni në vlerën 152.200 lekë, pasi automjeti është blerë nga z. E. Gj. në shumën 1.250 euro, me anë të kontratës së shitblerjes së datës 25.02.2002, të lidhur mes tij dhe znj. R. T., në Milano, ndërsa taksa doganore është paguar në vlerën 149.014 lekë, sipas të dhënave të faturës doganore të lëshuar nga Dogana Fier, më datë 19.03.2002<sup>34</sup>.

**29.3** Në vijim të arsytimit të bërë në paragrafët 30.5 e në vijim në këtë vendim, se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte se bashkëshorti i saj kishte përfituar të ardhura të ligjshme nga ushtrimi i aktivitetit tregtar në periudhën 2001-2003, si dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të ardhura të z. E. Gj. nga burime të tjera, trupi gjykues konfirmoi konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit dhe z. Gj. kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e automjetit tip “BMW”, në vlerën totale të automjetit prej 301.214 lekësh. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në pretendimin e saj, në mënyrë të gabuar i referohet rezultatit pozitiv të analizës financiare të kryer nga Komisioni, për periudhën 1998-2002, pasi ajo nuk është analizë për verifikimin e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, e cila është krijuar në datën 25.02.2002, por i përket verifikimit të situatës financiare të subjektit të rivlerësimit dhe z. E. Gj. në periudhën e marrë në analizë. Pavarësisht, këtij konkluzioni, trupi gjykues çmon të nënvizojë se konkluzioni për mungesën e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie shërben për të arritur në konkluzionin se të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie, në ndryshim nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm financiar për blerjen e automjeteve të tjera të ish-bashkëshortit.

**30.** *Në lidhje me pretendimin e subjekti të rivlerësimit se megjithëse ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor dispononte për automjetin tip “Renault”, Komisioni në të kundërt vlerën e automjetit në tabelën financiare nuk e ka përcaktuar sipas kontratës së shitblerjes, por sipas deklaramit të subjektit në vitin 2003, trupi gjykues konstatoi se për këtë pasuri, në deklaratën fillestare të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se automjeti tip “Renault”, që rrjedh nga një kontratë dhurimi, ka vlerën 1.000.000 lekë. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se deklarimi në vitin 2003 nuk ka qenë i saktë, pasi ky automjet është blerë me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.06.2003, nga shtetasi P. S. në vlerën 200.000 lekë. Sipas shpjegimeve të ish-bashkëshortit, duke qenë se prej tij mbi këtë automjet janë kryer riparime, është vendosur impiant gazi, është kryer pagesa e doganës, automjeti vlente 1.000.000 lekë.*

**30.1** Sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.06.2003, e lidhur mes z. E. Gj. në cilësinë e blerësit dhe z. P. S., automjeti është blerë në shumën 200.000 lekë, me targë të huaj, ndërsa sipas të dhënave të kontratës së shitjes së këtij mjeti nga z. E. Gj., e lidhur në datën 08.06.2004, mjeti rezulton të ketë targë shqiptare<sup>35</sup>.

**30.2** Në analizë të kësaj situatë faktike në raport me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se me të drejtë Komisioni ka përllëgaritur vlerën e kësaj pasurie në shumën 1.000.000 lekë, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit edhe në shpjegimet e dhëna në Komision ka pranuar vlerën e deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 dhe nuk ka arritur të provojë se kjo vlerë përfshin edhe shpenzime të tjera të cilat i kanë shtuar vlerën mjetit, përtej pagesës së taksës doganore. Në procesin e rivlerësimit kalimtar, barrën e provës për të provuar të kundërtën

<sup>34</sup> Siç rezultoi nga të dhënat e përcjella në Komision nga DPSHTRr-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2020.

<sup>35</sup> Sipas dokumentacionit të përcjellë në Komision nga DPSHTRr-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.06.2020.



e gjetjeve të rezultuara nga hetimi i kryer nga Komisioni e ka subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, mosangazhimi i Komisionit për të hetuar në lidhje me shumën e detyrimeve doganore të paguara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nuk mund të përbëjë justifikim për mospërbushje prej këtij të fundit të barrës së provës në drejtim të faktimit të pretendimit të saj për vlerën e mjetit dhe, për rrjedhojë, as shkak për kundërshtimin si të padrejtë të konkluzionit të arritur nga Komisioni.

**30.3** Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, përpos automjetit të analizuar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe automjetin tip “Honda” me vlerë 600.000 lekë. Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur kontratën e blerjes së saj nga z. E. Gj., për pasojë Komisioni, me të drejtë, në analizën financiare ka përlllogaritur si vlerë të krijimit të kësaj pasurie shumën 600.000 lekë, bazuar në deklarin e subjektit të rivlerësimit në vitin 2003, deklarin i cili ka vlerën e provës, bazuar në parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**30.4** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se pasuritë automjet tip “Renault” dhe tip “Honda” janë krijuar me burime të ligjshme, pasi nga dokumentacioni i paraqitur prej saj në Komision provohet me prova të drejtpërdrejta dhe indirekte se bashkëshorti i saj ka ushtruar aktivitet tregtar, me të ardhurat e të cilit në shumën 1.000.000 lekë janë krijuar pasuritë e sipërcituara, por ajo ka qenë në pamundësi objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar fitimin konkret të realizuar prej tij.

**30.5** Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi si vijon: (a) në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura personale të z. E. Gj. në shumën 100.000 lekë, si *person fizik, subjekt i biznesit të vogël dhe 100.000 lekë pagesë e detyrimeve fiskale*; (b) bashkëshorti i subjektit, z. E. Gj., me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, është regjistruar si *person fizik* për tregtimin e artikujve të ndryshëm me pakicë dhe me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.01.2001, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është regjistruar si *person fizik* për tregtimin e ushqimeve të shpejta<sup>36</sup>; (c) subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka paraqitur në Komision vërtetimin e Degës së Tatim Taksave Berat, datë 26.01.2006, sipas të cilit z. E. Gj. ka kryer aktivitet në periudhën 31.01.2003. Mbyllur më 07.03.2005; si dhe shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.12.2020, të Bashkisë Berat, sipas së cilës drejtorja e taksave dhe tarifave nuk disponon të dhëna për aktivitetet tregtare para vitit 2007.

**30.6** Në vlerësim të trupit gjykues, të dhënat e përcjella nga autoritetet kompetente shtetërore hedhin dritë mbi regjistrimin e aktivitetit tregtar të ish-bashkëshortit të subjektit për periudhën objekt analize 2001-2003, por ato nuk përbajnë asnjë gjurmë që të provojë të ardhurat e përfituara, si dhe pagesën e detyrimeve tatimore prej tij. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se ndodhet në kushtet e pamundësisë së kontrollit dhe përcaktimit e, për pasojë, edhe të llogaritjes së të ardhurave reale të realizuara gjatë viteve 2001-2003, nga ushtrimi i aktivitetit tregtar nga z. Gj. e, më tej, për t’i konsideruar ato të ardhura të ligjshme në kuadër të këtij procesi, në kuptim të kërkesave të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti të drejtë konkluzionin e Komisionit se nuk ka rezultuar e provuar që z. E. Gj. të ketë krijuar të ardhura të ligjshme në vitin 2003, kur është deklaruar krijimi i pasurive objekt kontrolli nga subjekti i rivlerësimit.

---

<sup>36</sup> Vendimet e sipërcituar janë përcjellë në Komision nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2020.

**30.7** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se gjendet në pamundësi objektive, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të provuar fitimin konkret të realizuar nga bashkëshorti, pasi dokumentacioni nuk është ruajtur nga institucionet përkatëse, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ka provuar përpjekjen maksimale për të siguruar dokumentacionin e hollësishëm dhe ka paraqitur atë dokumentacion dhe prova indirekte, të cilat i kanë vënë në dispozicion organet shtetërore dhe ish-bashkëshorti. Trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk rezultoi i provuar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar në mënyrë shteruese mbledhjen e dokumentacionit, për vërtetimin e fitimit të pretenduar si të realizuar nga ish-bashkëshorti, pasi vërtetimi i lëshuar nga Dega e Tatim Taksave Berat paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, përveçse nuk përmban të dhëna lidhur me të ardhurat e realizuara nga ish-bashkëshorti rezultojnë të jetë lëshuar në datën 26.01.2006, duke mos qenë rezultat i një kërkesë të subjektit drejtuar autoritetit kompetent për efekt të procesit të rivlerësimit. Të dhënat e shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 28.12.2020, të Bashkisë Berat, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, u çmuan nga trupi gjykues jo relevante për zgjidhjen e çështjes, pasi edhe sikur të kishte të dhëna për regjistrimin e taksave dhe tarifave vendore për periudhën 2001-2003 në Bashkinë Berat për personin fizik “E. Gj.”, përsëri nuk do të mund të përlllogaritej sa ka qenë fitimi i realizuar prej tij në këtë periudhë dhe, për rrjedhojë, nuk do të mund të provohej shuma e pretenduar si e ardhur prej 1.000.000 lekësh në vitin 2003. Për më tepër, ky pretendim nuk përputhet as me deklarinimin e saj në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, në të cilën ka deklaruar vetëm 100.000 lekë të ardhura të ish-bashkëshortit nga aktiviteti tregtar.

**30.8** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se gjatë hetimit administrativ, nga Komisioni nuk i është kaluar barra e provës në lidhje me të ardhurat e deklaruara si fitim nga aktiviteti tregtar i ish-bashkëshortit, trupi gjykues konstatoi se pretendimi është i pabazuar në prova, pasi Komisioni, në pyetësorin nr. 3, me pyetjen nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit dokumentacion provues lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të ish-bashkëshortit dhe vërtetimin e të ardhurave e pagimin e detyrimeve përkatëse, ndërsa në rezultatet e hetimit administrativ, ndër të tjera, i ka kaluar subjektit barrën e provës, për gjetjen: *Subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion dhe nuk ka rezultuar që ish-bashkëshorti i saj, të ketë krijuar të ardhura të ligjshme deri në fund të vitit 2003, kur janë deklaruar këto pasuri*<sup>37</sup>.

- 31.** Në konkluzion, për pasuritë automjet tip “Renault” dhe automjet tip “Honda”, trupi gjykues arriti në përfundimin se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ishte në kushtet e mungesës së të ardhurave të ligjshme për krijimin e tyre. Mungesa konkrete e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e këtyre pasurive do të evidentohet në kuadër të analizës financiare 2003-2016, si pjesë e rezultatit financiar të vitit përkatës.
- 32.** *Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se për pasurinë automjet tip “Nissan Patrol”, arsyetimi dhe konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në prova, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*

**32.1** Lidhur me këtë pasuri, Komisioni, në vendim<sup>38</sup>, ka arsyetuar dhe konkluduar se: “[...] subjekti dhe ish-bashkëshorti kanë përfituar një çmim preferencial për blerjen e pasurisë automjet tip “Nissan”, në vlerën 250.000 lekë. Subjekti nuk ka deklaruar shtim kursimesh në vitin 2004, në periudhën kur ka shitur dy automjetet e tjera, “Honda” dhe “Renault”. Gjithsesi, subjekti nuk

<sup>37</sup> Faqe 18 e rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit.

<sup>38</sup> Paragrafët 7.5 - 7.10 të vendimit të Komisionit.

*arriti të vërtetojë as burimin e ligjshëm të blerjes së këtyre dy automjeteve. Për sa i përket kursimeve cash të deklaruar, subjekti nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Subjekti nuk ka provuar mundësitë për blerjen e kësaj pasurie nga burime të ligjshme dhe në deklaratat periodike vjetore (2004 – 2010) nuk ka deklaruar gjendjen cash dhe ndryshimet e saj. Subjekti nuk shpjegoi bindshëm çmimin preferencial të deklaruar për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2010 në vlerën 250.000 lekë dhe shitjen në vitin 2019 në vlerën 700.000 lekë. Subjekti nuk ka pasur mundësi financiare dhe nuk arriti të provojë krijimin e shumës 250.000 lekë për blerjen e kësaj pasurie. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe nuk justifikon me burime të ligjshme krijimin e pasurisë automjet tip “Nissan”, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të nenit 33/5 të ligjit nr. 84/2016”.*

**32.2** Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të sa më sipër, ka argumentuar në ankim se automjeti është i vitit të prodhimit 1998 dhe në kohën e blerjes ka qenë me targa shqiptare, për pasojë nuk ka pasur shkak për të mësuar në lidhje me detyrimet doganore të paguara nga shitësi. Sipas shpjegimeve që i ka dhënë ish-bashkëshorti, është aplikuar çmimi 250.000 lekë në blerje, për shkak se me shitësin e mjetit kanë qenë shokë të afërt. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë gjykim, as njohje personale me shitësin e mjetit, për pasojë nuk ka pasur trajtim preferencial në raport me të.

**32.3** Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se shitësi i automjetit tip “Nissan Patrol”, z. G. S. e ka blerë atë në Gjermani, në datën 19.09.2008. Ndërsa nuk arrihet të identifikohet çmimi i blerjes së automjetit në shtetin gjerman, nga fatura doganore e lëshuar nga administrata doganore Vlorë, rezultoi se detyrimi doganor për këtë mjet është paguar në shumën 488.904 lekë. Ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë të njëjtin mjet nga z. S., vetëm tri ditë më vonë, në datën 22.06.2010, në shumën 250.000 lekë, fakt ky i mjaftueshëm për Komisionin për të arritur në përfundimin se z. Gj. e ka blerë pasurinë objekt kontrolli në kushtet e trajtimit preferencial.

**32.4** Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit në raport me situatën faktike si më sipër pasqyruar, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, trupi gjykues vlerësoi se në raport me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm, blerja e automjetit tip “Nissan Patrol”, nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nuk prodhon gjendjen e situatës së trajtimit preferencial. Parashikimet e nenit 23, pika 1 e ligjit të kohës, nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar<sup>39</sup>, ndalimin e marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale e renditin si një nga rastet e kufizime të interesave privatë të zyrtarit për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta, duke e lidhur pazgjidhshmërisht me lindjen e konfliktit të interesit. Në rastin konkret, në mbështetje të legjislacionit të sipërcituar, rrethanat faktike në të cilat ndodhej z. Gj., në raport me pasurinë objekt kontrolli që të vishen me elementet e trajtimit preferencial, duhet të kishin prodhuar lindjen e një konflikti, qoftë dhe në dukje të interesit për subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka arritur të provojë nëpërmjet hetimit administrativ se marrëdhënia juridike e krijuar mes ish-bashkëshortit të subjektit dhe z. G. S., për shkak të lidhjes së kontratës së shitblerjes së pasurisë objekt kontrolli, të ketë qenë e lidhur me vendimmarrje të

---

<sup>39</sup> Deri në datën 22.06.2010, data e lidhjes së kontratës së shitjes së automjetit, ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ishte i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006, ligjin nr. 9529, datë 11.05.2005 dhe ligjin nr. 9690, datë 05.03.2007.

subjektit të rivlerësimit në ndonjë çështje gjyqësore në mënyrë të tillë që kjo vendimmarrje të ketë qenë e ndikuar nga interesi i tij privat, në kuptim të neneve 23, pika 1 dhe 24, pikat 1 dhe 3 të ligjit të kohës nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar<sup>40</sup>. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit se ish-bashkëshorti i subjektit i rivlerësimit ka përfituar trajtim preferencial është i pabazuar në ligj.

**32.5** Sa i përket burimit të krijimit të pasurisë objekt kontrolli, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit se nuk ka deklaruar shtim të kursimeve në *cash* është i gabuar, pasi në deklaratën e pasurisë së vitit 2004 ka deklaruar të ardhurat e fituara nga shitja e automjeteve “Honda” dhe “Renault” në faqen ku duhet të deklaroheshin shtesat dhe pakësimet e pasurive, duke ezauruar kështu detyrimin për deklarim. Mosdeklarimin e kursimeve në *cash*, subjekti i rivlerësimit e ka konsideruar si pasaktësi në deklaratat periodike të interesave, të cilat nuk mund të përbëjnë shkak shkarkimi.

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se në deklaratën periodike të interesave të vitit 2010 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi për pasurisë automjet tip “Nissan Patrol”, blerë nga ish-bashkëshorti, me kontratën nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.06.2010, në shumën 250.000 lekë, kanë shërbyer të ardhurat e deklaruara më parë në deklaratat paraardhëse të interesave.

Në përgjigjet e pyetjeve të drejtuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *burimi i blerjes së kësaj pasurie, siç kam shkruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2010, rrjedh nga të ardhura të deklaruara më parë. Disa vjet më parë ish-bashkëshorti ka shitur dy automjete dhe të ardhurat e nxjerra prej tyre kanë shërbyer për blerjen e automjetit Benz në vitin 2004 dhe diferenca për blerjen e mjetit Nissan.*

Në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në datën 16.06.2004, në shumën 3.500 euro dhe shitjen e automjetit tip “Renault” në datën 08.06.2004, në shumën 700.000 lekë, si dhe shitjen e automjetit tip “Honda” në datën 27.07.2004, në shumën 400.000 lekë. Këto veprime të pakësimit të pasurisë janë deklaruar në rubrikën e formularit të deklarimit të pasurisë, me titull “Të ardhurat”. Në asnjë nga rubrikat vijuese të formularit të deklarimit, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi kursime në *cash* për këtë vit.

**32.6** Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në raport me rrethanat e rezultuara nga hetimi i Komisionit e të pasqyruara më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se në deklaratën e pasurisë të vitit 2004, e cila është administruar në cilësinë e dokumentit me vlerë të plotë provuese në këtë proces, bazuar në parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime në *cash* në fund të vitit, si diferencë e të ardhurave të krijuara nga veprimet juridike të deklaruara: shitja e dy automjeteve dhe blerja e një tjetri. Perceptimi i subjektit të rivlerësimit mbi mënyrën e deklarimit të kursimeve, duke i barazuar ato me të ardhurat, vjen në kundërshtim jo vetëm me logjikën ekonomike, por edhe me parashikimet e ligjit nr.

---

<sup>40</sup> Në pikën 1 të nenit 23 të ligjit të kohës nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar është parashikuar: “1. Është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti interesi të çdo lloji”. Ndërsa, në pikat 1 dhe 3 të nenit 24 parashikohet se: “1. Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21, pikat 1, 2 e 6 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es. [...] 3. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin, të përcaktuara në këtë seksion, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikat e mësipërme të këtij neni”.

9049/2003 dhe me kërkesat e formularit të deklarimit të pasurisë së vitit 2004, të cilat bëjnë një dallim të qartë mes deklarimit të të ardhurave dhe deklarimit të likuiditeteve në formën e kursimet në *cash*, për të cilat formulari ka përcaktuar rubrika të ndryshme deklarimi. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se të ardhurat e mbetura nga shitja e automjeteve pas blerjes së automjetit tip “Benz” në vitin 2004 janë transferuar të paprekura deri në vitin 2010, është jo bindës edhe për faktin se në këtë hark kohor prej 6 vjetësh, subjekti jo vetëm që nuk ka deklaruar shtesa kursimesh në *cash* në deklaratat përkatëse, por ka deklaruar krijim pasurish me të njëjtin burim, nga shuma të deklaruara më parë. Trupi gjykues, në vijim të qëndrimit të konsoliduar të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, nënvizon se në rastin e vlerësimit të deklarimeve në lidhje me gjendjen e kursimeve në *cash*, jashtë sistemit bankar, prova e vetme e vërtetësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit mbetet ajo çka është deklaruar prej tij në deklaratën periodike të interesave. Në konkluzion, trupi gjykues çmoi se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë krijimin e shumës 250.000 lekë për blerjen e kësaj pasurie nga kursimet në *cash* nga vitet paraardhëse. Edhe në skenarin e paraqitur nga subjekti, për të vlerësuar pretendimet e tij në një qasje garantiste se shuma prej 250.000 lekësh për blerjen e automjetit rrjedh nga të ardhurat nga shitja e automjeteve, konstatohet se këto të ardhura nuk kanë burim të ligjshëm, pasi më sipër në këtë relacion rezultoi e provuar se pasuritë automjet tip “Honda” dhe tip “Renault”, në pronësi të z. E. Gj., nuk ishin krijuar me burime të ligjshme financiare.

33. Në të tilla kushte, trupi gjykues çmoi se për trajtimin sa më të plotë të këtij shkakut ankimi, që ka lidhje me verifikimin e mundësisë për të krijuar me burime të ligjshme krijimin e automjetit tip “Nissan Patrol”, objekt i një analize më të detajuar do të jetë analiza financiare për vitin 2010, në të cilën kjo pasuri do të konsiderohet e krijuar me burim të ardhurat e subjektit të rivlerësimit në vitin përkatës.

#### *Për analizën financiare 2003-2016*

34. Në drejtim të analizës financiare, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, me të cilat ajo ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit të bërë për vitet 2003, 2004, 2005, 2006, 2010, 2012, 2013, 2015 dhe 2016, vite të cilat kanë rezultuar me balanca negative në shumën totale prej 9.056.653 lekësh. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se një analizë e saktë, bazuar në pretendimet e saj, do të rezultonte në kushtet e mjaftueshmërisë financiare të saj për të përballuar/mbuluar shpenzimet dhe për të krijuar pasuritë. Trupi gjykues mori fillimisht në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat shtrihen për të gjithë vitet e, më tej, pretendimet të cilat fokusohen në zëra specifike financiarë të secilit vit.

*i) Përlllogaritja e shpenzimeve të mobilimit, qirasë, shpenzimet e shkollimit të personave të lidhur, blerjeve online me kartë debiti dhe shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit*

35. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit se *vendimi i Komisionit nuk respekton parimin e sigurisë juridike, parimin e diskrecionit, si dhe parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit në llogaritjen e shpenzimeve të jetesës*. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se nga ana e Komisionit në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës është krijuar ligj, në kushtet kur në kuadrin ligjor të procesit të rivlerësimit nuk ka asnjë parashikim ligjor për përlllogaritjen e tyre. Për sa kohë vendimmarrja e Komisionit është subjektive, prej tij është shkelur parimi i sigurisë juridike. Në mungesë të ligjit ku duhet të referohej, Komisioni mund të referohej vetëm te minimumi jetik apo niveli i varfërisë, si një e dhënë e vetme objektive për të kryer këto llogaritje, pasi mbi bazën e minimumit jetik janë nxjerrë akte nënligjore, për shembull për përcaktimin e

masës së ndihmës ekonomike. Marrja për bazë e të dhënave nga INSTAT për nivele mesatare të shpenzimeve nuk rezulton të jetë përdorur si bazë për politika ekonomike apo sociale. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga parashikimet kushtetuese dhe ato të ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton se Komisionit i është dhënë e drejta me ligj të ushtrojë diskrecionin në përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës sipas vlerësimit të tij.

Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, *se shpenzimet e mobilimit të apartamentit të banimit, qirasë, shpenzimet e shkollimit të fëmijëve, blerjeve online me kartë debiti dhe shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit janë pjesë përbërëse e shpenzimeve jetike, pasi secili prej tyre zë një përqindje të caktuar në shpenzimet e llogaritura në Anketën e Buxhetit të Familjes përllogaritur sipas INSTAT-it. Komisioni, duke i përllogaritur këto shpenzime si zëra të veçantë, ka rënduar në mënyrë të padrejtë analizën financiare për periudhën 2003-2016 të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të. Në rast se këto shpenzime do të përllogariten si zëra më vete, atëherë vlera e tyre do të duhet të zbritet nga zëri “Shpenzime jetese”, për secilin vit të analizës financiare.*

**35.1** Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ, por edhe në vendim, i ka bërë të ditur subjektit të rivlerësimit metodologjinë e përdorur në kryerjen e analizës financiare, si dhe standardet e njohura mbi të cilat bazohet kjo metodologji lidhur me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës<sup>41</sup>. Komisioni ka shpjeguar se shpenzimet e jetesës janë përllogaritur bazuar në ato mujore për konsum, sipas përbërjes familjare të pasqyruar në anketën e buxhetit të familjes nga INSTAT-i.

Referuar sa më sipër, trupi gjykues konstaton se sa i takon metodologjisë së përdorur, Komisioni ka zbatuar standardin tashmë të konsoliduar në kryerjen e analizës financiare për periudhën e vlerësimit 2003-2016 dhe se nëpërmjet zbatimit të vlerave të përcaktuara, sipas shkresës së ILDKPKI-së, me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2019, standard i përdorur për të gjithë subjektet e rivlerësimit.

Më tej në vendim, Komisioni ka referuar se *subjekti paraqiti pretendime për zbritjen e shpenzimeve të jetesës, sipas secilës kategori të përfshirë në analizën financiare. Ky pretendim nuk merret parasysh, pasi Komisioni ka një praktikë të konsoliduar tashmë të llogaritjes së këtyre shpenzimeve. Për më tepër, shpenzimet e jetesës të cilat përdoren në analizën financiare janë shpenzime minimale, ndërkohë që shpenzimet e subjektit janë të një niveli më të lartë se ato të përdorura në analizë, ndaj dhe nuk qëndron pretendimi i tij për një përllogaritje të pabazuar dhe subjektive të Komisionit.*

**35.2** Përpos gjetjes së drejtë të vlerësimit të mësipërm të Komisionit, trupi gjykues mbajti në vëmendje edhe qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit në jurisprudencën e tij se, në kushtet kur shpenzimet mujore të përdorura si referencë, përfshijnë të dhëna nga anketimet për konsumin mujor mesatar të kryer nga familjet me nivele të ndryshme të ardhurash, si emëruet i përbashkët që përfshin gjithë fashat e pagave dhe përfitimeve në Republikën e Shqipërisë, shpenzimet e jetesës që përdoren nga institucionet e rivlerësimit në funksion të analizës financiare për subjektet e rivlerësimit, përbëjnë një zgjedhje tejet garantiste<sup>42</sup>. Shpenzimet e jetesës, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, kanë për qëllim të standardizojnë dhe unifikojnë këto shpenzime për të gjithë shtetasit shqiptarë. Këto shpenzime janë mesatare dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, çka do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson

<sup>41</sup> Paragrafi 9.3 i vendimit të Komisionit dhe faqe 25 e rezultateve të hetimit administrativ.

<sup>42</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 29/2020 (JR).

një jetesë normale të një njësie familjare dhe jo shpenzime që realisht janë kryer nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij. Shpenzimet e jetesës, sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, përdoren nga Komisioni ose Kolegji në mungesë të të dhënave të dokumentuara të subjekteve të rivlerësimit. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka pasur të dhëna të evidentuara lidhur me shpenzimet e kryera për blerje *online* me kartë bankare debiti dhe, për këtë arsye, ka përdorur këto të dhëna për llogaritjen e shpenzimeve në analizën financiare.

Për pasojë, llogaritja e shpenzimeve për mobilimin, qiranë, shkollimin e fëmijëve dhe blerjeve *online* si zëra më vete në analizën financiare të Komisionit u vlerësua nga trupi gjykues si një përlllogaritje e drejtë dhe objektive, në përputhje me përmbajtjen e deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit dhe akteve të rezultuara nga hetimi administrativ.

**35.3** Për sa i përket pretendimit, lidhur me reduktimin e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit në përqindjen që ato zënë në shpenzimet e Anketës së Buxhetit të Familjes sipas INSTAT-it, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim nuk qëndron, pasi sipas metodologjisë së llogaritjes së buxhetit të familjes sipas strukturës së grupeve kryesore të shpenzimeve të konsumit<sup>43</sup>, shpenzimet për “hotele dhe restorante” përfaqësojnë shpenzime të kryera brenda vendit dhe jo jashtë tij.

36. *Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar mënyrën e përlllogaritjes nga Komisioni të shpenzimeve të jetesës për vitet 2012, 2013 dhe 2016, duke pretenduar se është ngarkuar në mënyrë të dyfishtë me shpenzime jetese edhe për ditët në të cilat vetë ose së bashku me fëmijët, ka udhëtuar jashtë vendit. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit<sup>44</sup> se shpenzimet jetike familjare përfshijnë çdo lloj shpenzimi për blerje produktesh apo shërbimesh, të cilat shoqërojnë nevojat individuale të anëtarëve të familjes. Struktura e tyre përveç shpenzimeve për ushqim, përmbledh edhe 12 grupe kryesore të shpenzimeve të konsumit, si: shpenzime për ujë, energji elektrike, veshje, mallra dhe shërbime, mirëmbajtje banese etj. Në këtë kuptim, shpenzimet ditore të jetesës të përlllogaritura nga institucionet e rivlerësimit, sipas standardit të INSTAT-it ndër vite e që bazohen në një fashë ekonomike nën nivelin e atyre të magjistratëve dhe familjet me nevoja dhe të ardhura bazike, nuk mund të argumentohet se duhet të reduktohen, më tej, për shkak të pagesës për të mbuluar shpenzimet gjatë udhëtimeve jashtë vendit.*
- Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i gjeti të pabazuara kërkimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të sigurisë juridike, diskrecionit dhe proporcionalitetit e objektivitetit, si dhe për zbritjen e shpenzimeve të jetesës së përlllogaritura nga Komisioni, në analizën financiare 2003-2016.

*ii) Shkaqet e ankimit që lidhen me analizën financiare për secilin vit të periudhës 2003-2016*

37. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bilanci negativ i rezultuar për vitin 2003 është tërësisht i gabuar dhe rrjedhojë e një analize jo objektive, duke lënë jashtë bilancit shumicën dërrmuese të të ardhurave. Sipas subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të këtij viti nuk janë përfshirë: (i) të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit tip “BMW” në shumën 200.000 lekë; (ii) të ardhurat e siguruara nga aktiviteti tregtar i ish-bashkëshortit në shumën 1.000.000 lekë; shuma 3.500.000 lekë dhënë në cash ish-bashkëshortit nga prindërit e tij.*

<sup>43</sup> Metodologjia e publikuar nga INSTAT në linkun: <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/>

<sup>44</sup> Vendimet i Kolegjit nr. 9/2023 (JR), datë 15.03.2023; nr. 15/2023(JR), datë 13.04.2023, etj.

37.1 Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë analizuar më sipër në këtë vendim, prandaj për të shmangur përsëritjen në vijim, konkluzionet e arritura mbi ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar të pretenduar dhe nga shitja e automjetit tip “BMW”, gjejnë zbatim në analizën financiare të vitit 2003.

Ashtu siç edhe është referuar në këtë vendim, konkluzioni për mungesën e burimeve të ligjshme financiare për krijimin e automjetit tip “BMW” në vitin 2002, i shërbeu trupit gjykues për të arritur në konkluzionin se të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme e, për pasojë, si burim i ligjshëm financiar për blerjen e automjeteve të tjera të ish-bashkëshortit, gjatë vitit 2003. Gjithashtu, trupi gjykues nënvizon qëndrimin se nuk rezultoi e provuar që z. E. Gj. të ketë krijuar të ardhura të ligjshme në vitin 2003, në shumën 1.000.000 lekë, për pasojë këto të ardhura nuk mund të përfshihen në zërin “Të ardhura” në analizën financiare të këtij viti.

37.2 Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për lënien jashtë bilancit të vitit 2003 të shumës 3.500.000 lekë dhënë në *cash* ish-bashkëshortit nga prindërit e tij, trupi gjykues konstatoi se në përfundim të kontrollit të pasurisë *apartment banimi në Vlorë*, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nga analiza financiare e kryer në verifikim të burimeve financiare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e shumës prej 3.500.000 lekësh dhënë nga prindërit e ish-bashkëshortit, rezultoi se këta të fundit kishin pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për financimin e kësaj shume, në vlerën e 1.578.169 lekë, e cila është konsideruar edhe si mungesë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit të rivlerësimit, për krijimin e pasurisë objekt kontrolli. Në kuadër të përfundimit të mësipërm të vetë Komisionit, trupi gjykues vëren se ky i fundit ka konsideruar dhënien në *cash* nga prindërit e ish-bashkëshortit si veprimin juridik, nga i cili ka buruar shuma prej 3.500.000 lekësh, në përputhje me deklarimin e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.

Pasi kontrolloi analizën financiare të vitit 2003, trupi gjykues konstatoi se nga Komisioni, në zërin “Ndryshim në likuiditet” është vendosur vlera 3.500.000 lekë. Mungesa e pasqyrimin në zërin “Të ardhura”, të shumave të dhëna në *cash* ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga prindërit e tij, orientoi trupin gjykues drejt konkluzionit se Komisioni ka konsideruar se shuma prej 3.500.000 lekësh përfaqëson kursime në *cash* të realizuara nga subjekti i rivlerësimit nga të ardhurat e saj, shumë e cila, së bashku me pasuritë e tjera të krijuara gjatë këtij viti, i është nënshtruar analizës financiare me qëllim verifikimin e mundësisë së krijimit të tyre me burime të ligjshme financiare nga subjekti i rivlerësimit.

Duke vlerësuar si inkohorent qëndrimin e Komisionit lidhur me sa më sipër, trupi gjykues çmoi se për zgjidhjen e drejtë të çështjes, në analizën financiare do të duhet të përfshihet shuma prej 1.921.831 lekësh si e ardhur, e cila, nga vlerësimi i Komisionit dhe konfirmuar edhe në Kolegj, rezultoi të jetë krijuar me burime të ligjshme financiare nga prindërit e ish-bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në raport me shumën totale prej 3.500.000 lekësh të pretenduar nga ky i fundit. Mungesa e burimeve të ligjshme të prindërve të ish-bashkëshortit në vlerën 1.578.169 lekë, për të përballuar krijimin e shumës prej 3.500.000 lekësh, do të duhet të konsiderohet si shumë e krijuar nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë faktin se në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, gjatë gjithë hetimit administrativ në Komision, si edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka qenë konsistent në deklarimin se ka pasur gjendje kursimesh në *cash* shumën prej 3.500.000 lekësh.



38. Në përfundim, duke korrigjuar analizën financiare të Komisionit, bazuar në arsyetimin e mësipërm, balanca negative për vitin 2003 nga vlera (-) 4.898.580 lekë që ishte në analizën e Komisionit reduktohet në vlerën (-) 2.976.749 lekë, në të cilën përfshihet mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e kursimeve në *cash*, për blerjen e autoveturës tip “Renault”, autoveturës tip “Honda”, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të vitit 2003. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
39. *Në drejtim të analizës financiare të vitit 2004, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjekti të rivlerësimit, me të cilat ajo kundërshton analizën e Komisionit të bërë për këtë vit, pasi, sipas saj, nuk janë përfshirë të ardhurat e ish-bashkëshortit nga aktiviteti tregtar në shumën 834.000 lekë, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Renault” në shumën 700.000 lekë dhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Honda” në shumën 400.000 lekë.*  
 Në kuadër të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me të ardhurat e përfituara nga ish-bashkëshorti nga shitja e automjeteve tip “Renault” dhe “Honda”, janë marrë në analizë më sipër në këtë vendim<sup>45</sup>. Në konkluzion të arsyetimit për këto pasuri, trupi gjykues ka arritur në përfundimin se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ishte në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e tyre. Mbështetur në këtë konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat e përfituara nga shitja e automjeteve tip “Renault” dhe “Honda” nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme dhe, për këtë arsye, nuk mund të bëhen pjesë e analizës financiare për vitin 2004. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se gjatë vitit 2004, ish-bashkëshorti i saj ka përfituar të ardhura nga aktiviteti tregtar në shumën 834.000 lekë, trupi gjykues nënvizon qëndrimin e mbajtur më sipër në paragrafin 26.5 të këtij vendimi, sipas të cilit, në konsideratë të mungesës së akteve provuese për përfitimin e kësaj të ardhure, si edhe në mungesë të konfirmimit të pagesës së detyrimeve tatimore për të, sipas detyrimit që vjen nga neni 52 i ligjit nr. 84/2016, kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet si e ligjshme, në kuptim të nenit 3, pika 19 dhe nenit 30 të të njëjtit ligj dhe, për pasojë, nuk mund të bëhet pjesë e analizës financiare të vitit objekt kontrolli.
40. Në përfundim, në kushtet kur pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën të pabazuara, trupi gjykues konfirmoi balancën negative të konstatuar nga vendimi i Komisionit për vitin 2004. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit nuk mund të justifikojë me burime të ligjshme për këtë vit, pasuritë e krijuara dhe të përballojë shpenzimet e kryera në vlerën prej (-)188.123 lekësh, në të cilën përfshihet edhe mungesa e burimeve për blerjen e automjetit tip “Mercedez-Benz”. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për vitin 2004.
41. Trupi gjykues mori në shqyrtim shkaku ankimit, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit konsideron jo të saktë analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2005, pasi ajo nuk ka deklaruar blerjen e ndonjë pasurie në këtë vit, ndërsa në analizë është përcaktuar në zërin “Pasuri” vlera 589.497 lekë, pa asnjë të dhënë se çfarë përfaqëson kjo vlerë.*  
 Në kuadër të këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i tabelës së analizës financiare pjesë e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se për vitin 2005, Komisioni në zërin “Pasuri” ka vendosur vlerën 589.497 lekë. Në vijim, në zërin “Ndryshim në likuiditet” ka vendosur të njëjtën vlerë. Në terma financiarë, ndryshimi në likuiditete përkufizohet si pasuri, për pasojë Komisioni ka pasqyruar qartë dhe saktë këto zëra në analizën financiare, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk kishte krijuar pasuri të tjera gjatë këtij viti. E njëjta mënyrë pasqyrimi e zërave në fjalë rezulton

<sup>45</sup> Paragrafët 32.5 e në vijim të këtij vendimi.

të jetë përdorur edhe nga subjekti i rivlerësimit në tabelën e analizës financiare të paraqitur bashkëlidhur ankimit. Ndryshimi qëndron në vlerën prej 451.265 lekësh të përlllogaritur nga subjekti i rivlerësimit.

Nga krahasimi dhe verifikimi i vlerave të sipërcituara, trupi gjykues vlerësoi se vlera prej 589.497 lekësh e përlllogaritur nga Komisioni si “Ndryshim në likuiditet/Pasuri” është vlera e saktë, pasi përbëhet nga gjendja e likuiditetit bankar të subjektit të rivlerësimit, në formën e depozitës bankare prej 451.265 lekësh çelur në datën 08.06.2005 në Bankën Amerikane të Investimeve Vlorë dhe gjendja e likuiditetit bankar në datën 31.12.2005, në llogarinë personale të ish-bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 138.232 lekë. Kjo e fundit nuk rezultoi të jetë përfshirë në vlerën e përlllogaritur në analizë nga subjekti i rivlerësimit.

42. Në përfundim, në kushtet kur pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën të pabazuara, trupi gjykues konfirmoi balancën negative të konstatuar nga vendimi i Komisionit për vitin 2005 prej 151.840 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk mund të justifikojë me burime të ligjshme, për këtë vit, pasuritë e krijuara dhe të përballojë shpenzimet e kryera, përfshirë këtu dhe krijimin e depozitës bankare të çelur në datën 08.06.2005, në Bankën Amerikane të Investimeve Vlorë. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për vitin 2005.

43. *Për analizën financiare të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bilanci negativ i nxjerrë nga Komisioni për këtë vit, është i gabuar dhe rrjedhojë e një analize jo objektive.*

Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendimet për zërat përkatës të analizës financiare, në shqyrtim të të cilëve, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

Në kuadër të këtij shkak ankimi, për të shmangur përsëritjen, trupi gjykues shqyrtoi dhe analizoi ato pretendime të subjektit të rivlerësimit, të cilat janë parashtruar për herë të parë e nuk janë bërë pjesë e arsytimit më sipër në këtë vendim.

43.1 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *në analizën financiare të këtij viti, pakësimin e gjendjes cash për shkak të blerjes së apartamentit, Komisioni e ka konsideruar përsëri si mungesë fondi, duke bërë që kjo shumë të njihet me bilanc negativ, duke rritur dy herë fiktivisht pamundësinë financiare me 3.500.000 lekë.*

Nga kontrolli i analizës financiare të vitit 2006 të pasqyruar në vendim, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në ndryshim nga sa ka arsyetuar dhe konkluduar lidhur me burimet e krijimit të pasurisë *apartament banimi në Vlorë*, në të ardhurat e disponueshme të subjektit të rivlerësimit, nuk ka përfshirë shumën prej 1.921.831 lekësh, që përfaqëson atë pjesë të shumës prej 3.500.000 lekësh dhënë ish-bashkëshortit të subjektit nga prindërit e tij, në *cash*, në vitin 2003, e cila vetë Komisionit i rezultoi të jetë krijuar me burime financiare të ligjshme të tyre. Trupi gjykues vlerësoi se shuma prej 1.921.831 lekësh, e verifikuar si e ligjshme edhe në Kolegj, duhet të përfshihet në analizën financiare të vitit 2006, pasi Komisioni ka konsideruar se pasuria apartament banimi është krijuar në këtë vit, referuar datës në të cilin është lidhur kontrata e shitblerjes nga subjekti i rivlerësimit.

43.2 Trupi gjykues shqyrtoi edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se *nga Komisioni është rritur fiktivisht edhe shpenzimi në shumën 470.000 lekë, duke e konsideruar si të tillë mbylljen e depozitës dhe lënien e kësaj shume motrës së saj në ruajtje. Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo shumë duhej konsideruar si e ardhur dhe duhej përfshirë në këtë zë të analizës financiare.*

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se në analizën e kryer nga Komisioni, shuma prej 470.000 lekësh është pasqyruar nën zërin “Shpenzime”, me emërtesën “Shpenzim i shumës së tërhequr nga depozita tek ish-Banka Amerikane 2006”. Në vlerësim të trupit gjykues, konsiderimi e më pas pasqyrimi si shpenzim i shumës prej 470.000 lekësh nga Komisioni, është një veprim i saktë i pasqyrimin kontabël, pasi vetë subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se këtë shumë nuk e dispononte realisht, pasi ia kishte lënë motrës në ruajtje. Por Komisioni, do të duhej të kishte pasqyruar në zërin “Të ardhura” interesin bankar të përfituar nga kjo depozitë.

44. Në përfundim, duke korigjuar analizën financiare të Komisionit bazuar në arsyetimin e mësipërm, balanca negative për vitin 2006, nga vlera (-) 2.403.499 lekë që ishte në analizën e Komisionit reduktohet në vlerën (-) 462.178 lekë, në të cilën përfshihet mungesa e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament banimi, si dhe për kryerjen e shpenzimeve të vitit 2006. Për pasojë subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

45. *Në drejtim të analizës financiare të vitit 2010, trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjekti të rivlerësimit, me të cilat ajo kundërshton analizën e Komisionit të bërë për këtë vit pasi, sipas saj bilanci negativ i rezultuar është i gabuar.* Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtrroi argumentet si vijon.

i. Nga ana e Komisionit është bërë një gabim material, pasi të dhënat e pasqyruara për vitin 2009 në fakt janë dhënat e vitit 2010 dhe anasjelltas.

ii. Në analizë e këtij viti është përllogaritur si pasuri shuma prej 787.543 lekësh, pa shpjeguar se çfarë përfaqëson kjo shumë, e cila përcaktohet si ndryshim në likuiditet dhe pasuri.

45.1 Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2009 dhe 2010, në raport me të dhënat financiare që kanë rezultuar nga hetimit administrativ, trupi gjykues konstatoi se nuk ka gabime materiale në pasqyrimin e të dhënave në zërat përkatës për secilin vit.

Në lidhje me shumën prej 787.543 lekësh të pasqyruar në zërin “Pasuri” të analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2010, trupi gjykues konstatoi se ajo është pasqyruar si shumë e zërit “Ndryshim në likuiditet” në vlerën 537.543 lekë me vlerën 250.000 lekë si shtesë në zërin “Pasuri”, për shkak të blerjes së automjetit tip “Nissan Patrol”, në këtë vit.

46. Në përfundim, në kushtet kur pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën të pabazuara, duke përfshirë këtu edhe pretendimet lidhur me zërin e shpenzimeve, të cilat janë trajtuar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues konfirmoi balancën negative të konstatuar nga vendimi i Komisionit për vitin 2010 prej 228.881 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk mund të justifikojë me burime të ligjshme për këtë vit, pasuritë e krijuara dhe të përballojë shpenzimet e kryera, përfshirë këtu dhe blerjen e automjetit tip “Nissan Patrol”. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për vitin 2013.

47. *Për analizën financiare të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bilanci negativ i nxjerrë nga Komisioni për këtë vit është i gabuar dhe rrjedhojë e një analize jo objektive.*

Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendimet për zërat përkatës të analizës financiare, në shqyrtim të të cilëve, trupi gjykues konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

47.1 Lidhur me pretendimin se në analizë nuk është pasqyruar gjendja *cash* në shumën 500.000 lekë e mbartur nga viti 2006, trupi gjykues vëren se nga verifikimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe kontrolli i bërë për pasurinë apartament banimi rezultoi se prindërit e ish-bashkëshortit, nga shuma e pretenduar prej 3.500.000 lekësh, kishin mundësi që t'i jepnin atij vetëm shumën prej 1.921.831 lekësh të krijuar me burime të ligjshme financiare. Kjo shumë është përdorur tërësisht nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë apartament banimi, në Vlorë, në shumën prej 3.000.000 lekësh. Për pasojë, ajo nuk mund të dispononte shumën prej 500.000 lekësh gjendje *cash* në fund të vitit 2006, si shumë të krijuar me burime të ligjshme financiare.

47.2 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nga Komisioni është përlogaritur në zërin “Pasuri” shuma (-) 121.711 lekë, pa shpjeguar se çfarë përfaqëson kjo shumë. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit e ka kuptuar se çfarë përfaqëson zëri objekt pretendimi, pasi në vijim të shkakut të ankimit ka argumentuar se ky zë përcaktohet si ndryshim në likuiditete dhe pasuri, por sa i përket likuiditetit bankar, Komisioni nuk ka pasqyruar shumën 590.000 lekë depozitë bankare në “Union Bank”, gjendje e mbartur nga viti 2011, si edhe shumën 172.812 lekë, gjendje në fund të vitit në llogarinë bankare në “Tirana Bank”. Në lidhje me këto pretendime të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se sipas të dhënave të pasqyruara në dokumentacionin bankar të përcjellë në Komision nga bankat e nivelit të dytë, gjendja e llogarive edhe depozitave bankare të subjektit të rivlerësimit dhe atyre të ish-bashkëshortit, në datën 31.12.2012, ishte në vlerën 831.704 lekë. Diferenca e kësaj vlere me gjendjen e llogarive dhe depozitave bankare në datën 31.12.2011, përlogaritet në vlerën (-) 121.711 lekë, aq sa është dhe vlera e përlogaritur nga Komisioni në zërin “Ndryshim në likuiditet”. Në kushtet kur nga subjekti i rivlerësimit nuk është krijuar pasuri tjetër gjatë këtij viti, vlera e përlogaritur në zërin “Pasuri” është njehsuar me atë të zërit “Ndryshim në likuiditet”. Për rrjedhojë, përlogaritjet e Komisionit, edhe për këtë zë të analizës financiar, u gjetën të drejta.

47.3 Nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se zëri shpenzime udhëtime jashtë vendit është përlogaritur në vlerën 278.151 lekë. Trupi gjykues, pas verifikimit të të dhënave të sistemit *TIMS*, përlogariti shpenzimet e udhëtimit për këtë vit, në vlerën 248.526 lekë, referuar metodologjisë së përdorur në jurisprudencën e Kolegjit<sup>46</sup>, si dhe në mbështetje të faktit se nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ në Komision, rezultoi se: (i) ish-bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qëndruar jashtë vendit gjithsej 8 ditë nga 9 ditë të përlogaritura nga Komisioni; (ii) në dy udhëtime ish-bashkëshorti nuk ka udhëtuar me mjetin e vet dhe, po kështu edhe subjekti i rivlerësimit në një udhëtim të saj drejt Greqisë, për pasojë Komisioni nuk duhet të kishte përlogaritur vlerën e siguracionit për automjetin, si dhe vlerën e shpenzimeve të karburantit për ish-bashkëshortin.

48. Në përfundim, duke korrigjuar vetëm zërin e udhëtimit jashtë vendit, për të cilin pretendimet e subjektit qëndrojnë, balanca negative për vitin 2012 nga vlera (-) 15.947, që ishte në analizën e Komisionit, kthehet në bilanc pozitiv në vlerën (+) 13.679 lekë, për pasojë subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

49. *Për analizën financiare të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bilanci negativ i nxjerrë nga Komisioni për këtë vit, është i gabuar dhe rrjedhojë e përlogaritjeve jo të sakta në zëra të veçantë të saj.*

Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendimet, të cilat u analizuan nga trupi gjykues, si më poshtë.

<sup>46</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 11/2019(JR), datë 22.05.2019.

**49.1** Lidhur me pretendimin se në analizë nuk është pasqyruar gjendja *cash* në shumën 500.000 lekë e mbartur nga viti 2006, trupi gjykues vëren se ky është një pretendim i përsëritur, i cili nuk është gjendur i bazuar në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa i takon përllogaritjeve të kryera nga Komisioni lidhur me likuiditetet për vitin 2012.

Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nga Komisioni është përllogaritur në zërin “Pasuri” shuma (-) 35.652 lekë, pa shpjeguar se çfarë përfaqëson kjo shumë. Më tej, subjekti ka pretenduar se në zërin “Ndryshime në likuiditet” nuk janë përfshirë gjendja likuiditetet në depozitën bankare në “Union Bank” dhe ajo në llogarinë bankare të pagës në “Tirana Bank”. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se sipas të dhënave të pasqyruara në dokumentacionin bankar të përcjellë në Komision nga bankat e nivelit të dytë, gjendja e depozitës bankare të subjektit të rivlerësimit në “Union Bank” ka ndryshuar nga 590.000 lekë në fund të vitit 2011, në 627.701 lekë në fund të vitit 2012 dhe 663.292 lekë në fund të vitit 2013 dhe në këto gjendje janë përfshirë edhe interesat bankare. Ndryshimi i gjendjes së vlerës të depozitës në vitin 2013 krahasuar me gjendjen e saj në fund të vitit 2012 është 35.591 lekë. Trupi gjykues vëren se në zërin “Ndryshimi në likuiditet” në analizën e Komisionit është përfshirë edhe vlera 101.802 lekë si diferencë e gjendjes 101.802 lekë së llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank” në fund të vitit 2013 me gjendjen e saj prej 172.812 lekësh në fund vitin 2012. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka krijuar pasuri të tjera gjatë këtij viti vlera e përllogaritur në zërin “Pasuri” është njëjshuar me atë të zërit “Ndryshim në likuiditet”. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se ky zë i analizës financiare mbetet në vlerën e përllogaritur nga Komisioni.

**49.2** Nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se zëri shpenzime udhëtime jashtë vendit është përllogaritur në vlerën 237.544 lekë. Trupi gjykues, pas verifikimit të të dhënave të sistemit *TIMS*, përllogariti shpenzimet e udhëtimit për këtë vit, në vlerën 207.399 lekë, referuar metodologjisë së përdorur në jurisprudencën e Kolegjit, si dhe në mbështetje të faktit se nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ në Komision, rezultoi se: (i) në ndryshim nga Komisioni, për një udhëtim të kryer drejt Turqisë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me fëmijët e mitur me paketë turistike, nuk u përllogaritën shpenzime qëndrimi për njërin nga fëmijët, pasi u gjet i bazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk kishte paguar kosto, pasi fëmija ishte nën moshën 12 vjeç; (ii) subjekti i rivlerësimit në një udhëtim të saj drejt Greqisë nuk ka udhëtuar me automjetin e saj, për pasojë nga Komisioni nuk duhet të ishte përllogaritur vlera e siguracionit për automjetin.

**50.** Në përfundim, duke korigjuar vetëm zërin e udhëtimeve jashtë vendit, për të cilin pretendimet e subjektit qëndrojnë, balanca negative për vitin 2013 nga vlera (-) 82.383 lekë që ishte në analizën e Komisionit reduktohet në vlerën (-) 52.242 lekë, për pasojë subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për vitin 2013.

**51.** *Në drejtim të analizës financiare të vitit 2015, trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjekti të rivlerësimit, me të cilat ajo kundërshton analizën e Komisionit të bërë për këtë vit, pasi, sipas saj, bilanci negativ i rezultuar është i gabuar.* Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit parashitroi pretendimet të cilat analizohen si vijon.

**51.1** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nga Komisioni është përllogaritur në zërin “Pasuri” shuma 232.178 lekë, e cila përfaqëson “Pasuri/Ndryshime në likuiditet”, ndërkohë që në tabelë nuk ka asnjë të dhënë për likuiditetet. Në analizë të këtij pretendimi, nga verifikimi i tabelës së analizës financiare të pasqyruar në vendim, për vitin 2015, trupi gjykues konstatoi se në ndryshim

nga sa pretendoi subjekti i rivlerësimit në këtë analizë është pasqyruar si zë më vete “Ndryshim në likuiditet” në vlerën 232.178 lekë.

**51.2** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, se në analizë nuk gjejnë pasqyrim, depozitat bankare të krijuara në emër të fëmijëve në shumën 100.000 lekë secila në “Union Bank”, depozita bankare në shumën 595.600 lekë së bashku me interesat, në “Union Bank”, si dhe diferenca e llogarisë së pagës në vlerën 116.1990 lekë, në “Tirana Bank”.

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se vlerat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit janë përfshirë në zërin “Ndryshim në likuiditet” në analizën financiare të Komisionit, në të cilën vlerat për secilën llogari apo depozitë bankare janë përlllogaritur si diferencë ndërmjet gjendjes së tyre në datën 31.12.2015 me gjendjen në datën 31.12.2014. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se ky zë i analizës financiare mbetet në vlerën e përlllogaritur nga Komisioni.

**51.3** Nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se zëri shpenzime udhëtime jashtë vendit është përlllogaritur në vlerën 470.212 lekë. Trupi gjykues, pas verifikimit të të dhënave të sistemit *TIMS*, përlllogariti shpenzimet e udhëtimit për këtë vit, në të njëjtën vlerë, referuar metodologjisë së përdorur në jurisprudencën e Kolegjit, si dhe në mbështetje të faktit se nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ në Komision, rezultoi se: (i) për një udhëtim njëditor të subjektit të rivlerësimit së bashku me fëmijët në Janinë, ajo ka pretendon se shpenzimi duhet të përlllogaritet nga Komisioni në shumën 100 euro, ndërkohë që trupi gjykues konstatoi se vlera e përlllogaritur nga Komisioni është e njëjtë, pra, 100 euro. I njëjti konstatim vlen edhe për një udhëtim në Antalia të subjektit të rivlerësimit së bashku me fëmijët, për të cilin vlera e pretenduar nga subjekti është përlllogaritur e njëjtë nga Komisioni, në shumën 2.178 euro; (ii) pretendimi i subjektit të rivlerësimit se një udhëtim treditör i saj së bashku me fëmijët dhe ish-bashkëshortin është financuar nga ky i fundit, duke qenë se kanë festuar ditëlindjen e fëmijës, u gjet i pabazuar, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës për të provuar se këto shpenzime janë përballuar nga ish-bashkëshorti, në kundërshtim me parashikimin e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>47</sup> dhe me jurisprudencën e Kolegjit.

**52.** Në përfundim, në kushtet kur pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën të pabazuara, duke përfshirë këtu edhe pretendimet lidhur me zërin e shpenzimeve, të cilat janë trajtuar më sipër në këtë vendim, trupi gjykues konfirmoi balancën negative të konstatuar nga vendimi i Komisionit për vitin 2015 prej 470.212 lekësh. Subjekti i rivlerësimit nuk mundi të justifikojë me burime të ligjshme pasuritë e krijuara dhe përballimin e shpenzimeve të kryera, përfshirë këtu dhe krijimin e depozitave në emër të secilit prej fëmijëve në “Union Bank”. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për vitin 2015.

**53.** *Për analizën financiare të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bilanci negativ i nxjerrë nga Komisioni për këtë vit është i gabuar dhe rrjedhojë e përlllogaritjeve jo të sakta në zëra të veçantë të saj, për pasojë rezultati duhet të ishte pozitiv.*

---

<sup>47</sup> Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

Në mbështetje të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtroi pretendimet të cilat analizohen si vijon.

**53.1** Në analizë të pretendimit se në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë pasqyruar shtesat në depozitat bankare në emër të secilit prej fëmijëve në “Union Bank”, përkatësisht në vlerat 50.000 lekë dhe 100.000 lekë, trupi gjykues vëren se ky pretendim është analizuar në paragrafin 51.2 më sipër në këtë vendim, nga ka rezultuar se këto vlera janë pasqyruar në zërin “Ndryshim në likuiditet” në analizën financiare të Komisionit. Të njëjtin pretendim, për mospasqyrim në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit parashtroi edhe për shumën prej 296.187 lekësh gjendje në fund të vitit në llogarinë bankare në “Tirana Bank”, pretendim i cili u rrëzua nga trupi gjykues, pas konstatimit se edhe kjo shumë është pasqyruar në zërin “Ndryshim në likuiditet”, në të cilin janë përfshirë vlerat e ndryshimeve të likuiditeteve në të gjitha llogaritë/depozitat bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

**53.2** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nga Komisioni, në mënyrë absurde shuma prej 215.757 lekësh e mbetur nga tërheqja e depozitës bankare në “Union Bank” është konsideruar si shpenzim duke rritur fiktivisht vlerën e shpenzimeve, trupi gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të vitit 2016 të pasqyruar në vendimin e Komisionit, konstatoi se në të është vendosur si shpenzim vlera 215.757 lekë me përshkrimin *shpenzime të deklaruara të tepruara nga mbyllja e depozitës në “Union Bank”*. Nga të dhënat e likuiditeteve bankare të subjektit të rivlerësimit të përcjella në Komision nga “Union Bank”, trupi gjykues vëren se në datën 26.09.2006 është tërhequr dhe mbyllur depozita në vlerën 715.757 lekë. Kjo tërheqje është pasqyruar në analizën financiare të Komisionit si pjesë e totalit prej (-) 374.900 lekësh, në zërin “Ndryshim në likuiditet”. Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e huas në shumën 500.000 lekë marrë nga motra e saj, me qëllim pagesën e shkollës verore për vajzën, duke përdorur shumën 715.757 lekë e tërhequr nga mbyllja e depozitës në “Union Bank”, në datën 26.09.2016. Vlera 215.757 lekë, e mbetur nga tërheqja e shumës në depozitë, pas shlyerjes së huas nuk është deklaruar e ruajtur si gjendje kursimi në *cash*, në deklaratën periodike të interesave të vitit 2016. Në mbështetje të kësaj situatë faktike, trupi gjykues vlerësoi se vlera prej 215.757 lekësh, duke mos u deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit, logjikisht konsiderohet si i përdorur nga subjekti i rivlerësimit, por nuk duhet të vendoset si shpenzim në analizën financiare të vitit, pasi është pjesë e rezultatit financiar të tij. Duke e vendosur si shpenzim këtë vlerë, Komisioni ka rritur artificialisht bilancin negativ të këtij viti. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë zë të analizës financiare, u konsiderua i bazuar nga trupi gjykues.

**53.3** Nga verifikimi i analizës së kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se zëri shpenzime udhëtime jashtë vendit është përlllogaritur në vlerën 482.540 lekë. Trupi gjykues, pas verifikimit të të dhënave të sistemit *TIMS*, përlllogariti shpenzimet e udhëtimit për këtë vit, në vlerën 477.129 lekë, referuar metodologjisë së përdorur në jurisprudencën e Kolegjit<sup>48</sup>, si dhe në mbështetje të faktit se nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ në Komision, rezultoi se: (i) pretendimi i subjektit të rivlerësimit se udhëtime të saj në drejtim të Greqisë, Maqedonisë dhe Spanjës, në të cilët ka udhëtuar së bashku me fëmijët dhe ish-bashkëshortin janë financuar nga ky i fundit, duke qenë se kanë festuar ditëlindjet e fëmijëve ose kanë shkuar të vizitojnë të afërmit, u gjet i pabazuar pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës për të provuar se këto shpenzime janë përballuar nga ish-

<sup>48</sup> Vendimet nr. 11/2019 dhe nr. 27/2020, të Kolegjit.

bashkëshorti, në kundërshtim me parashikimin e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>49</sup> dhe me jurisprudencën e Kolegjit. Të njëjtin qëndrim, trupi gjykues mbajti edhe lidhur me një udhëtim tjerët të subjektit të rivlerësimit drejt Austrisë, për të cilin ka pretenduar se shpenzimet e transportit dhe qëndrimit janë mbuluar nga një shoqe e saj; (ii) për udhëtimin drejt Austrisë gjatë shtatorit 2016, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se janë shpenzuar gjithsej 330 euro nuk u gjet i bazuar, pasi nga verifikimi i të dhënave mbi likuiditetet bankare të përcjella në Komision nga “Tirana Bank”, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën nëpërmjet llogarisë bankare në shumën 234.90 euro, si pagesë qëndrimi në hotel. Duke i shtuar kësaj pagesë koston e transportit në shumën 180 euro të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, shuma e shpenzuar në total rezultoi 415 euro, aq sa është përlllogaritur edhe nga Komisioni në vendim; (iii) për një udhëtim të kryer nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të Maqedonisë, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka përlllogaritur gabimisht vlerën e siguracionit prej 40 eurosh në ngarkim të shpenzimeve të subjektit; (iv) për udhëtimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit së bashku me djalin e saj në Greqi brenda ditës, në nëntor 2016, trupi gjykues konstatoi se në ndryshim nga sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit për mungesë kostoje udhëtimi dhe qëndrimi, Komisioni ka përlllogaritur vetëm shpenzime transporti në shumën 35 euro. Trupi gjykues e vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim, si dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës për mungesë kostosh në kryerjen e këtij udhëtimi.

54. Në përfundim, duke korigjuar zërin e udhëtimeve jashtë vendit, si dhe duke pakësuar zërin shpenzime në total në shumën 215.757 lekë, për të cilët pretendimet e subjektit të rivlerësimit qëndrojnë, balanca negative për vitin 2016 nga vlera (-) 611.927 lekë që ishte në analizën e Komisionit reduktohet në vlerën (-) 390.759 lekë, për pasojë subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për vitin 2016.
55. Në përmbledhje të arsytimit të mësipërm, në analizë të situatës faktike dhe ligjore, trupi gjykues konstatoi se balanca negative e përlllogaritur nga Komisioni, për shpenzimet dhe investimet e kryera për periudhën 2003-2016, duke pranuar disa nga pretendimet e subjektit të rivlerësimit për zëra të caktuar, reduktohet nga (-) 9.056.653 lekë në (-) 4.926.242 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
56. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *analiza financiare duhet të ishte krijuar nga ekspertë të fushës së ekonomi-kontabilitetit. Kjo provë është e njëanshme, pasi është krijuar nga ndihmësi ekonomik i punësuar pranë Komisionit dhe në varësi të tij, i cili, në këto kushte, ka papajtueshmëri në bazë të parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile. Komisioni, duke mos e njohur me emrin e personit që ka kryer analizën financiare, i ka shkelur subjektit të rivlerësimit të drejtën e kundërshtimit të tij, pasi nuk ka pasur mundësinë e verifikimit të njohurive të tij, si dhe të mospasjes së konfliktit të interesit.*
- Në analizë të këtij shkakui ankimi, nga verifikimi i kërkesave të subjektit të rivlerësimit, të parashtruara gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë

---

<sup>49</sup> Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “4. Komisioni dhe Kolegji i Apelit të bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.



parashtruar asnjë ankesë në lidhje me pamundësinë për të ushtruar të drejtat e pretenduara. Trupi gjykues sjell në vëmendje se pranë Komisionit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përmbush detyrat dhe ushtron përgjegjësitë, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor të rivlerësimit. Referuar parashikimeve të nenit 22 të ligjit nr. 84/2016, Njësia e Shërbimit Ligjor ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin e rivlerësimit kalimtar, pa qenë i parashikuar në ligj detyrimi për identifikimin e personit konkret që luan këtë rol në një çështje të caktuar. Analizat financiare të kryera nga kjo Njësi i nënshtrohen kundërshtimeve nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit dhe, në përfundim, lidhur me to, vendos trupi gjykues i Komisionit, i ngarkuar me short për kryerjen e procesit të rivlerësimit. Analiza financiare e kryer nga Komisioni është mbështetur në provat e administruara nga Komisioni gjatë zhvillimit të hetimit administrativ, si të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, dokumentacioni financiar pjesë e dosjes përkatëse të ILDKPKI-së, si dhe në të dhëna nga institucione shtetërore dhe subjekte të ndryshme private, etj.

Për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar në ligj.

57. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nga Komisioni nuk i është vënë në dispozicion “Analizë Financiare” por “Tabelë Financiare”, e cila përmban vetëm konkluzione. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur dot të kuptojë mënyrën e përlllogaritjeve të kryera nga këshilltari ekonomik i Komisionit, duke iu mohuar kështu e të drejta ta kundërshtojë këtë provë, në të cilën Komisioni ka mbështetur vendimmarrjen.*

Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni nuk i është vënë në dispozicion një “Analizë Financiare”, por një “Tabelë Financiare”, e cila përmban vetëm konkluzione, nga e cila nuk ka arritur dot të kuptojë mënyrën e përlllogaritjeve të kryera nga këshilltari ekonomik i Komisionit, duke i mohuar të drejtën ta kundërshtojë këtë provë, nga verifikimi i rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se në këtë dokument, analiza financiare 2003-2016 ndiqet nga rubrika “Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare”, në të cilën janë shpjeguar përlllogaritjet e bëra për zërat e saj. Në prapësimet e paraqitura mbi këto rezultate të hetimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka shprehur pretendime për pamundësinë e saj në kuptimin e përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni, madje ka paraqitur tre pasqyra financiare, të cilat i quan “tabela”, të hartuara nga një ekspert kontabël i zgjedhur prej saj, në të cilat janë korrigjuar nga negative në pozitive rezultatet e analizës financiare të Komisionit, për vite të caktuara, në mbështetje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se edhe në vendim Komisioni ka vepruar me të njëjtën mënyrë të pasqyrimin të analizës financiare si në rezultatet e hetimit administrativ, duke e shoqëruar atë me metodologjinë e ndjekur, për përlllogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve<sup>50</sup>. Sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk mbështetet në fakte.

58. *Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si konkluzion të pabazuar nga ana e Komisionit, sa i takon vlerësimit se është përpjekur të fshehë pasuritë në pronësi apo përdorim të saj, pasi Komisioni nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë pasuritë e fshehura, duke qenë se nuk ka gjetur asnjë pasuri të poseduar nga persona të tretë që realisht t’i përkiste subjektit të rivlerësimit apo fëmijëve të saj.*

Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes, si dhe mori në analizë rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstatoi se konkluzioni për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit parashtrohet nga Komisioni për herë të parë në vendimin objekt ankimi, duke qenë se me relacionin e “Rezultateve të hetimit kryesisht”,

---

<sup>50</sup> Paragrafi 9.3 i vendimit të Komisionit.

për asnjë prej pasurive të analizuara, nuk janë evidentuar gjetje apo fakte të cilat të çojnë në dyshime për fshehje pasurie të kryer nga subjekti i rivlerësimit.

Në vijim të sa më sipër, nga verifikimi i vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se në paragrafin e titulluar “Vlerësimi tërësor i çështjes” në përfundimet për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka renditur<sup>51</sup>: “*Subjekti gjendet në kushtet e shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, subjekti nuk ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe të interesave private, si edhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj, si dhe është përpjekur të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe bashkëpronësi. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës, i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit”.*

Komisioni ka përdorur si bazë ligjore të identifikimit të shkeljes së kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, konstatimet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat lidhen përkatësisht me pasaktësinë në deklaram dhe mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe jo konstatimin sipas shkronjës “c”, e cila lidhet me fshehjen e pasurisë. Përpos këtij fakti, trupi gjykues vëren se në analizën dhe vlerësimin për secilën pasuri, përfshirë edhe ato të ish-bashkëshortit për periudhën gjatë së cilës ka qenë i lidhur në martesë ligjore me subjektin e rivlerësimit, Komisioni nuk ka arsyetuar në asnjë rast për përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të fshehur pasurinë.

Konkluzioni i arritur nga Komisioni, në vendim, se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë pasuritë në pronësi dhe bashkëpronësi është i paqartë, i paarsyetuar dhe për sa kohë edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk u evidentuan rrethana që të mund të provonin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e fshehjes së pasurisë, ky konkluzion është edhe i pabazuar në fakte. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë dhe të bazuar shkakun e mësipërm të ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit u vlerësua i gabuar, pasi nuk mbështetet në fakte.

#### *D. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit mbi cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*

59. Nga kontrolli i vendimit nr. 340, datë 01.02.2021, trupi gjykues vëren se aplikimi i pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nga Komisioni, është mbështetur në konkluzionet lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të vlerësimit të aftësive profesionale, si vijon.

*a) Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore gjatë procesit administrativ dhe duke mos iu përgjigjur saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë. Subjektin e rivlerësimit duhet ta karakterizojë sjellja e denjë, serioze dhe e sinqertë, jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës, por edhe gjatë zbatimit të detyrimeve të saj gjatë procesit administrativ për rivlerësimin kalimtar<sup>52</sup>.*

*b) Kurse përgjigjet e subjektit, lidhur me çështjet e trajtuara nga Komisioni dhe ato të trajtuara nga denoncimet, kanë qenë jo shteruese dhe janë bërë me qëllim shmangien e përgjigjeve lidhur me problematikat e konstatuara. Fakti i moskundërshtimit të tyre dhe dhënia e argumenteve për të kundërshtuar gjetjet e Komisionit nga subjekti, krijoi bindjen e trupit gjykues se këto gjetje qëndrojnë dhe janë të sakta. Trupi gjykues çmon se të gjitha faktet për të cilat subjekti i rivlerësimit*

<sup>51</sup> Paragrafi 10, faqe 54, i vendimit të Komisionit.

<sup>52</sup> Faqe 55, paragrafi 10, në fund, i vendimit të Komisionit.

është njoftuar nga Komisioni janë konsideruar shkelje të ligjit dhe veprime të njëanshme, për të cilat subjektit i është kaluar edhe barra e provës në kuptim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, këto fakte janë bërë pjesë e arsytimit të konkluzioneve të Komisionit, të pozicionuara në pjesën e denoncimeve dhe gjetjeve nga çështjet gjyqësore, të lidhura me sjellje të caktuara të subjektit dhe vendimmarrjen e saj. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjitha mundësitë të mbrohet dhe t'i kundërshtojë duke paraqitur shpjegime të plota dhe prova bindëse<sup>53</sup>. Në vendim, në paragrafin e nëntitulluar “Konkluzioni përfundimtar”<sup>54</sup>, Komisioni është shprehur: “[...]nga vlerësimi në tërësi i kriterit të pasurisë dhe vlerësimi profesional lidhur me çështjet e gjykuara dhe problematikat e konstatuara nga Komisioni mbi bazën e të dhënave të mbledhura, denoncimet dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas nenit 4, paragrafi 2, i ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, si dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë duke u gjendur në kushtet e pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”.

60. Në kundërshtim të këtij qëndrimi të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim se konkluzioni i Komisionit është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit dhe provave, pasi deklaratimet e saj lidhur me krijimin e pasurive nuk kanë qenë kontradiktore, si dhe për shkak se nuk është vërtetuar ndonjë shkelje konkrete në ndonjë prej rasteve të verifikuara nga denoncimet e publikut, e tillë që të përbëjë *gabime thelbësore dhe serioze apo të ekzistojë një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqësive të gabuara*, sipas përcaktimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017. Sipas subjektit të rivlerësimit, konkluzioni i Komisionit është rrjedhojë e një vlerësimi sipërfaqësor e të paargumentuar të rrethanave të konsideruara si bazë për mbajtjen e këtij qëndrimi, të cilat nuk vërtetohen të jenë të mjaftueshme për të konkluduar për aplikimin e nenit 61, pika 5 si kriter për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar pretendimet, të cilat analizohen në vijim të këtij vendimi.
61. Në analizë të qëndrimit të Komisionit, në raport me shkakun e ankimit, sa i takon qasjeve kontradiktore të mbajtura nga subjekti gjatë hetimit administrativ lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi, në kuadër të kontrollit nga Komisioni të kriterit të vlerësimit të pasurisë, të përdorura nga ky i fundit si bazë për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk janë të një natyre e me një peshë të tillë, për të vënë në vështirësi organet e rivlerësimit për të bërë një vlerësim të drejtë mbi fakte të vërteta, si dhe për të shkaktuar perceptimin e publikut se drejtësia nuk funksionon.
62. Në vijim të analizës së këtij shkakut ankimi, trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të cilat i referohen në mënyrë të posaçme qëndrimeve të Komisionit në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, rreth çështjeve gjyqësore, të lidhura me sjellje të caktuara të subjektit të rivlerësimit dhe vendimmarrjes së saj e, për të cilat, Komisioni ka arritur në konkluzionin se kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
63. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *qëndrimi i Komisionit është me dy standarde, pasi Komisioni ka të drejtë të kryejë vlerësim profesional jashtë periudhës së rivlerësimit, por duhet ta mbajë këtë qëndrim për të gjitha ankesat, nuk mund të përzgjedhë*. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga 16 denoncime vetëm 2 janë përzgjedhur si jashtë periudhës së rivlerësimit. Nga

---

<sup>53</sup> Faqe 56, paragrafi i dytë, po aty.

<sup>54</sup> Faqe 56, po aty.

tërësia e vendimit të ankimuar, nuk rezulton që relatori apo vëzhguesi ndërkombëtar të kenë kërkuar që vlerësimi profesional të përfshijë periudhën që nga data 01.01.2006.

**63.1** Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, ka marrë në shqyrtim denoncimet e publikut, për të cilat ka referuar në vendim<sup>55</sup> se *për subjektin e rivlerësimit, znj. Klodiana Gjyzari, janë paraqitur 27 denoncime në Komision. Pas vlerësimit të denoncimeve dhe informacionit që disponon Komisioni, u kërkuan praktikat dhe vendimet e dhëna nga subjekti, për të cilat rezultuan indicie, lidhur me 19 çështje gjyqësore.*

Nga verifikimi i denoncimeve që gjenden në dosjen gjyqësore, rezulton se nga 26 denoncime të paraqitura, si edhe nga rastet e referuara në raportin e DSIK-së, Komisioni ka hetuar për ato denoncime të cilat kanë referuar fakte e rrethana, në përputhje me kërkesat e nenit 53, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni, në vendim, ka analizuar 6 çështje të cilat referojnë në vendime gjyqësore jashtë periudhës së rivlerësimit tetor 2013-tetor 2016, të përcaktuar në pikën 3 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, nga ka rezultuar se vetëm për dy prej tyre ka gjetur problematika. Nga sa më sipër, rezultoi se në kundërshtim me sa ka pretenduar subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk ka bërë përzgjedhje të çështjeve, por i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për ato çështje për të cilat ka konstatuar problematika në kuadër të shqyrtimit të denoncimeve nga publiku apo nga rastet e referuara nga raporti i DSIK-së.

Në vijim të analizës së pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se neni 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale, nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit të subjektit. Sipas jurisprudencës së Kolegjit<sup>56</sup>, në kuadër të procesit të rivlerësimit, legjislacioni i zbatueshëm nuk pengon denoncimet dhe në rast se ato nuk identifikojnë denoncuesin, si dhe nuk kufizon në kohë faktet apo rrethanat objekt denoncimi, të cilat mund të kenë ndodhur edhe tej periudhës së rivlerësimit, por që përbëjnë shkak për hetim të mëtejshëm kur adresojnë shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit.

**63.2** Në verifikimin e zbatimit të kuadrit ligjor të sipërcituar në rastin konkret, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka marrë në shqyrtim vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.09.2005 dhe vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dokumente të hartuara nga subjekti i rivlerësimit, në bazë të informacionit që ka disponuar për etikën dhe aftësitë profesionale të përcjellë nga raporti i DSIK-së dhe nga denoncimet e publikut, duke plotësuar kushtet e nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shtrirjen e periudhës së vlerësimit për aftësitë profesionale, për një periudhë më të gjatë kohore se sa tri vitet e fundit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, në bazë të informacionit të disponuar për etikën dhe aftësitë profesionale.

- 64.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *Komisioni ka interpretuar dhe zbatuar gabim parashikimet e Aneksit të Kushtetutës në lidhje me barrën e provës për sa i përket kriterit të aftësive profesionale, pasi në asnjë rresht të vendimit nuk gjenden konstatimet që duhet të ishin kryer sipas përcaktimeve kushtetuese, duke mos i ngarkuar barrë prove në kuptimin që neni E i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016 ka parashikuar.*

<sup>55</sup> Faqja 45 e vendimit të Komisionit.

<sup>56</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 7/2023 (JR), datë 23.02.2023.

64.1 Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, në vështrim të përgjithshëm, duke abstraguuar bazueshmërinë e konkluzioneve të Komisionit për secilën nga çështjet, nga verifikimi i vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstatoi se për secilën prej tyre janë përshkruar problematikat për të cilat subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës dhe është pasqyruar edhe qëndrimi i tij pas kalimit të barrës së provës. Bazuar në nenin 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe praktikën e ndjekur nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, momenti procedural, kur subjekti i rivlerësimit njihet me tërësinë e provave të mbledhura, rezultatet e pritshme, për t'i kundërshtuar më pas, në funksion të barrës për të provuar të kundërtën, është njoftimi i rezultateve të hetimit administrativ. Edhe në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të hetimit, Komisioni është shprehur për çdo gjetje, për të cilat rezultojnë t'i ketë kaluar subjektit të rivlerësimit barrën për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Nga aktet e administruara nga Komisioni, rezultojnë se me vendimin nr. 2, datë 17.12.2020, është mbyllur hetimi administrativ për subjektin e rivlerësimit, i cili në pikën 2 përcaktonte njoftimin e subjektit të rivlerësimit se i kishte kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, bazuar në paragrafët D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me kriterin e aftësive profesionale, përfshirë edhe denoncimet e publikut, Komisioni në rastet ku ka konstatuar gjetje ka vendosur shënimin: *“Në bazë të ligjit nr. 84/2016, Komisioni konstatoi problematika lidhur këtë çështje dhe Ju si subjekt rivlerësimi keni barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit”*. Me e-mail të datës 23.12.2020, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për këtë vendimmarrje të Komisionit. Më datë 11.01.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur pranë Komisionit shpjegimet mbi rezultatet e hetimit së bashku provat që ai i ka konsideruar të nevojshme, lidhur edhe me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Në këto shpjegime, subjekti i rivlerësimit nuk ka shprehur paqartësi në lidhje me barrën e provës, madje evidentohet se përgjigjet e tij fillojnë me shprehjen *bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me këtë çështje shpjegoj se [...]*. Edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, më datë 25.01.2021, pasi relatori i çështjes ka përshkruar gjetjet në rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë pretendim, në lidhje me paqartësi të tij lidhur me barrën e provës. Në vendim, Komisioni ka pasqyruar të njëjtat çështje dhe të njëjtat gjetje si në rezultatet e hetimit administrativ. Edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke mos dhënë argumente të ndryshme nga ato të paraqitura pranë Komisionit, në lidhje me problematikat e konstatuara. Këto rrethana dëshmojnë se subjekti i rivlerësimit ka qenë i njohur me gjetjet dhe rrethanat për të cilat i ka kaluar barra e provës. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

65. Në trajtimin e pretendimeve mbi konkluzionet e Komisionit, lidhur me denoncimet e publikut, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka përsëritur qëndrimin e saj të parashtruar në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, duke përfshirë në ankim edhe ato denoncime për të cilat Komisioni nuk ka konstatuar gjetje e, për pasojë, nuk i ka kaluar barrën e provës. Për këtë arsye, në vijim, analizohen vetëm çështjet për të cilat Komisioni, në vendim, ka konkluduar se gjetjet e rezultateve të hetimit administrativ qëndrojnë dhe janë të sakta.

66. Në këndvështrim të rrethanave dhe konkluzioneve të arritura nga Komisioni, trupi gjykues çmoi se konkluzionet e Komisionit mund të grupohen në dy tipologji, të cilat meritojnë trajtim të ndryshëm në varësi të specifikave që ato paraqesin.
67. *Tipologjia e parë*, lidhet me qëndrime të Komisionit të cilat nuk dakordësohen me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit për zgjidhjen në themel të çështjes, duke tentuar të kryejë një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes nga ai që ka kryer subjekti i rivlerësimit në vendimet përkatëse.
68. Për sa i përket vendimit nr. {\*\*}, datë 30.01.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, që i përket çështjes penale nr. {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *lidhur me këtë vendimmarrje nga Komisioni nuk i është kaluar barrë prove konkrete, prandaj nuk ka vlerësuar se ishte e nevojshme të jepte përgjigje në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka konstatuar ndonjë gjetje në rastin konkret dhe pavarësisht se shprehet se ky vendim ka lidhje me një çështje tjetër nuk përcaktohet lidhja konkrete në vijim të vendimit.*

**68.1** Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i vendimit të Komisionit dhe rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se Komisioni ka shpjeguar se vendimi nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë, që i përket çështjes penale nr. {\*\*\*}, në të cilën subjekti i rivlerësimit si kryesuese e trupës gjyquese ka vendosur *mospranimin e ankimit të të pandehurit Z. B. i deklaruar fajtor për veprën penale “vjedhje”, për shkak të heqjes dorë nga ankimi*, lidhet indirekt me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, që i përket çështjes penale nr. {\*\*\*}, në të cilin subjekti i rivlerësimit si kryesuese e trupës gjyquese ka vendosur *deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Z. B. për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, pasi nuk provohet të ketë kryer veprën penale.*

Komisioni ka konstatuar si problematika, për të cilat i ka lënë subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, si vijon: (i) *duket se subjekti i rivlerësimit ka marrë 2 vendime në të njëjtën datë për sa i përket të njëjtit të pandehur Z. B.; (ii) duket se trupa gjyquese e Gjykatës së Apelit, ku subjekti ka qenë relatore ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe deklarimin e pafajshëm të shtetasit Z. B., duke mos marrë në konsideratë akt ekspertimin daktiloskopik nr. {\*\*\*}, datë 24.04.2017, të Institutit të Policisë Shkencore, ku kanë rezultuar se gjurmët e konstatuara i përkasin të pandehurit Z. B. dhe as deklarimin e pronarit të mjetit të vjedhur shtetasit M. Z.*

Sa më sipër, rezultoi se Komisioni ia ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për problematikën e konstatuara në vendimin e mëvonshëm të marrë prej saj, me nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, në ngarkim të të pandehurit Z. B. dhe jo për vendimin nr. {\*\*\*}, datë 30.01.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

**68.2** Për sa i përket problematikave të referuara më sipër, në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, që i përket çështjes penale nr. {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka deklaruar se *[...] në lidhje me këtë çështje nuk kam shpjegime të tjera, përveç atyre të shkruara në arsyetimin e vendimit, i cili rezulton të jetë i parekursuar. Paraqes shkresën nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.*

Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në këtë rast barra e provës i është ngarkuar në shkelje të ligjit dhe në tejkalim të kompetencës lëndore të Komisionit, pasi gjetjet/problematicat kanë të bëjnë me vlerësimin e provave në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues të çështjes.

68.3 Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me gjetjet e Komisionit, trupi gjykues konstatoi se vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka deklaruar të pandehurin Z. B. të pafajshëm për veprën penale “Vjedhje”, parashikuar neni 134/3 i Kodit Penal dhe fajtor për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, është bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Apelit Vlorë, për shkak të ankimit të të pandehurit dhe prokurorit të çështjes. Në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.01.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtares kryesuese të trupit gjykues, ka arsyetuar, ndër të tjera, se: *“Në lidhje me përkrahimin e autorit të dyshuar nga kallëzuesi M. Z., gjykata konstaton se personi që ai ka parë ka qenë brenda të njëjtit dyqan me të dhe kallëzuesi nuk ka qenë afër mjetit të tij apo duke hipur në të apo duke u larguar me të. Edhe përkrahimi i dhënë prej tij nuk është identifikues, pasi nuk paraqet asnjë shenjë apo tipar të veçantë. Sipas kallëzuesit, personi i vetëm që ai ka parë në market ishte një mashkull i gjatë dhe me trup të mbushur. Këto karakteristika nuk përcaktojnë në mënyrë përjashtuese personin e dyshuar. Gjithashtu, kallëzuesi nuk e ka parë fytyrën e personit të vërejtur prej tij. Nisur nga përkrahimi që ka dhënë shtetasi M. Z., ai nuk është i tillë që kryhet as paraqitje për njohje, për pasojë nuk përmban ndonjë të dhënë individualizuese apo përcaktuese që e lidh këtë deklaram me të pandehurin Z. B.. I pandehuri rezulton të jetë hetuar dhe gjykuar me masën e sigurimit “arrest në burg” dhe prokuroria i ka pasur të gjitha mundësitë e kryerjes së paraqitjes për njohje, por nuk e ka kryer. [...] Në kushtet kur të dhënat që rezultojnë nga akti i ekspertimit daktiloskopik, sipas të cilit gjurma e dorës së djathtë e të pandehurit gjendet në një qese brenda së cilës është konstatuar lëndë narkotike cannabis sativa nuk lidhen me asnjë provë tjetër direkte ose indirekte që të provojë fajësinë e të pandehurit Z. B., deklarimi i tij fajtor vetëm mbi bazën e kësaj prove do të vinte ndesh me kërkesat e nenit 4 dhe 152/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe do ta çonte gjykatën në marrjen e një vendimi të pabazuar në ligj. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e tij nr. {\*\*\*}, datë 21.12.2005, me të cilin, ndër të tjera, është arsyetuar se fajësia e të pandehurit në një proces penal nuk mund të konkludohet duke u bazuar në një provë të vetme, e pa shoqëruar kjo me prova të tjera, pavarësisht faktit nëse kjo provë është provë shkencore, dëshmi apo çdo lloj prove tjetër. [...] Ky qëndrim i Kolegjit Penal është konsekuent dhe ndeshet edhe në vendimet nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2010, nr. {\*\*\*}, datë 18.09.2013 dhe nr. {\*\*\*}, datë 04.05.2016”.*

Gjithashtu, konstatohet se nga të dhënat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Komision<sup>57</sup> vendimi nr. {\*\*\*}, datë 13.11.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është arkivuar, pasi nuk është ushtruar rekurs nga prokurori.

68.4 Në analizë të rrethanave si më sipër, vlerësohet se qëndrimi i Komisionit lidhet me përcaktimin nëse vlerësimi i një prove ka qenë i duhuri apo i drejtë nga subjekti i rivlerësimit.

69. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.06.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë<sup>58</sup>, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ nuk ka pasur shpjegime të tjera për të shtuar veç atyre që ka dhënë në vendimin objekt kontrolli. Sipas pretendimit të subjektit, ai nuk mund të ngarkohet me barrë prove bazuar në vlerësimin e ndryshëm të provave nga ana e Komisionit, në raport me vendimin e dhënë nga subjekti. Për pasojë, subjekti ka pretenduar se edhe në këtë rast,

<sup>57</sup> Shënimi i kancelares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në fund të vendimit.

<sup>58</sup> I shqyrtuar nga Komisioni mbi bazën e denoncimit të znj. M. Sh., regjistruar në Komision, me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.08.2020.

*barra e provës i është ngarkuar në shkelje të ligjit dhe në tejkalim të kompetencës lëndore të Komisionit.*

**69.1** Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i vendimit të Komisionit vërehet se ky i fundit ka referuar se i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për problematikat e konstatuara, pasi gjykata në këtë vendim, në të cilin ka vendosur lënien e fëmijës R. A., për rritje dhe edukim të paditurit F. A., nuk ka marrë parasysh: *provat e paraqitura nga pala paditëse M. Sh.; i ati i fëmijëve duket se ishte pa arsim të detyrueshëm dhe i dënuar me disa vite burgim; për të atin e fëmijëve ishte kërkuar dhe marrë urdhër mbrojtje për dhunë në familje; ekspertja psikologe E.B. ka arritur në përfundimin se të 2 prindërit shfaqin aftësitë e duhura për prindërim të përshtatshëm.*

**69.2** Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim të njëjtin qëndrim si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ se prej saj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, provat janë vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe raporti me sjelljen e palëve ndaj fëmijëve të mitur e qëndrimi i fëmijëve të mitur dhe më pas është arritur në konkluzionin se ka qenë në interesin më të lartë të fëmijëve të mitur të qëndrojnë pranë të atit. Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se pretendimet e denoncueses kanë pasur të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit, për pasojë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet rekursit.

**69.3** Nga përmbajtja e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 18.06.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë, i administruar nga Komisioni, trupi gjykues konstatoi se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 05.03.2018, me palë paditëse M. Sh. dhe palë të paditur F. A., me objekt përcaktimi i ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur lënien e fëmijës R. A. për rritje dhe edukim pranë paditëses M. Sh. dhe të fëmijës L. A. pranë të paditurit F. A.. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.06.2019, me të cilin ka vendosur lënien e të dy fëmijëve për rritje dhe edukim të paditurit F. A.. Në vendim, gjykata ka arsyetuar në lidhje me provat mbi të cilat ka mbështetur vendimmarrjen. Në ndryshim nga sa ka konstatuar Komisioni, Gjykata e Apelit nuk e ka mbështetur vendimin e saj në aktin e ekspertimit të kryer gjatë gjykimit në shkallë të parë nga psikologjia E. B., por ka përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor duke urdhëruar kryerjen e një akti të ri ekspertimi psikologjik, nga psikologjia D. M., i cili u pranua nga të dy palët. Në përfundim, psikologjia ka arritur në konkluzionin e arsyetuar për lënien e të dy fëmijëve për rritje dhe edukim të paditurit F. A.. Në kushtet kur paditësja nuk ka qenë dakord me këtë akt ekspertimi, gjykata ka sqaruar në vendim, se edhe pse nuk është përpara rastit të përjashtimit të ekspertit, me qëllim garantimin e të drejtave të fëmijëve, ka urdhëruar kryerjen e një akti tjetër ekspertimi psikologjik, nga psikologjia B. L., e cila ka arritur në të njëjtin konkluzion të arsyetuar, për lënien e të dy fëmijëve për rritje dhe edukim të paditurit F. A.. Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar edhe gjendjen ekonomike të secilit prej prindërve, bazuar në të dhënat mbi punësimin e tyre, si dhe strehimin që i ofrojnë fëmijëve.

**69.4** Në analizë të rrethanave si më sipër, konstatohet se në thelb të vendimmarrjes së gjykatës, në të cilin subjekti i rivlerësimit ka mbajtur cilësinë e anëtares së trupës gjykuese, ka qëndruar bindja e brendshme e gjyqtarit në vlerësimin e provave për zgjidhjen e çështjes konkrete.



70. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.12.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë<sup>59</sup>, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *shpjegimet e saj në përgjigje të barrës së provës të ngarkuar nga Komisioni kanë qenë të hollësishme për sa i përket problematikave procedurale të konstatuara prej tij. Për sa i përket problematikave të konstatuara në lidhje me themelin e gjykimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk mund të ngarkohet me barrë prove bazuar në vlerësimin e ndryshëm të provave nga ana e Komisionit, në raport me vendimin e dhënë nga subjekti. Për pasojë, subjekti ka pretenduar se edhe në këtë rast, barra e provës i është ngarkuar në shkelje të ligjit dhe në tejkalim të kompetencës lëndore të Komisionit.*

**70.1** Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues konstatoi si vijon.

Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, duket që kjo çështje është zgjidhur shumë shpejt nga Gjykata e Apelit në krahasim me çështjen gjyqësore nr. {\*\*\*}, e përfunduar në vitin 2020. Duket se trupa gjykuese ka shqyrtuar një çështje që mund të jetë gjë e gjykuar; ka shqyrtuar një çështje ku e drejta e padisë është parashkruar. Pritet që Gjykata e Lartë të shqyrtojë 2 çështje ku objekti i padisë së ngritur në gjykatat e shkallës së parë të jetë i njëjtë ai i “Shpërblimit të dëmit pasuror e jopasuror”.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka parashtruar të njëjtat argumente si në ankim: “[...] ndryshe nga çështja e mëparshme, çështja është kaluar për gjykim nga relatorja, sipas nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar dhe është marrë parasysh që palët kishin paraqitur edhe ankime të veçanta, afati për shqyrtimin e të cilave është një muaj. Janë njoftuar palët për shkakun e kalimit për gjykim dhe nuk kanë parashtruar kundërshtime. Në lidhje me pretendimin se është gjykuar një çështje që mund të jetë gjë e gjykuar, siç është arsyetuar në vendim, nuk ka rezultuar pretendim i bazuar në ligj. Po ashtu edhe pretendimi i parashkrimit të padisë, është gjetur i pabazuar dhe referencat në prova dhe në ligj gjenden në arsyetimin e vendimit. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit dhe vlerësoj se pretendimet e saj përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet rekursit”.

**70.2** Gjykata e Apelit Vlorë ka përcjellë në Komision<sup>60</sup> vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.12.2018, me palë paditëse: Anëtarët e familjes A. dhe palë e paditur shoqëria {\*\*\*} ShA, me objekt: “[...] Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmin pasuror dhe jopasuror (në të gjitha figurat e tij) që i është shkaktuar paditësve si pasojë e vdekjes së të ndjerit J. A., nga aksidenti në punë [...]”. Nga verifikimi i këtij vendimi, rezultoi se subjekti, në këtë çështje, ka qenë në cilësinë e gjyqtarës kryesuese të trupës gjykuese. Lidhur me gjetjen e Komisionit se trupa gjykuese ka shqyrtuar një çështje që mund të jetë gjë e gjykuar, trupi gjykues vëren se gjykata ka arsyetuar se *Gjykata e Apelit e gjen të drejtë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë se vendimi i pushimit të gjykimit nuk është vendim përfundimtar që zgjidh çështjen në themel, por është vendim jopërfundimtar që përfundon gjykimin. Gjykata e Apelit ka konstatuar se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.05.2018, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 20.06.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës<sup>61</sup> dhe pushimin e gjykimit të çështjes”, për shkak të heqjes dorë të paditësve nga gjykimi. Në vijim, Gjykata e Apelit Vlorë ka arsyetuar se duke qenë se vendimi i*

<sup>59</sup> I shqyrtuar nga Komisioni mbi bazën e denoncimit të {\*\*\*}, regjistruar në Komision, me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.03.2019.

<sup>60</sup> Me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 02.10.2020.

<sup>61</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës kishte vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e {\*\*\*} të paguante dëmin pasuror dhe jopasuror si pasojë e vdekjes së të ndjerit J. A., nga aksidenti në punë.

mësipërm është vendim për pushimin e gjykimit të çështjes, bazuar në nenin 127 të Kodit të Procedurës Civile, ky vendim nuk ka zgjidhur në themel çështjen, por i ka dhënë fund procesit gjyqësor, për pasojë çmon se konflikti i palëve nuk është zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

**70.3** Lidhur me gjetjen e Komisionit se trupa gjykuese ka shqyrtuar një çështje ku e drejta e padisë është parashkruar, rezultoi se nga subjekti i rivlerësimit është arsyetuar: *“Në rastin në gjykim jemi para rastit të kërimit të shpërblimit të dëmit jashtëkontraktor. Sipas nenit 115/dh të Kodit Civil parashkruhen brenda tre vjetëve, paditë për shpërblimin e dëmit jokontraktor. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.02.2016, i ka vënë në dispozicion paditësve aktet e procedimit penal nr. {\*\*\*} të vitit 2010, duke përfshirë dhe vendimin e prokurorit për pushimin e tij. Deri në momentin e marrjes dijeni të rezultateve të hetimit, të cilat kanë përshkruar shkëljet teknike të kryera nga punëmarrësi {\*\*\*} ShA, pala paditëse nuk ka qenë në dijeni të subjektit përgjegjës për dëmin, pasi shkak i aksidentit mund të ishte dhe rasti faktor, etj., si dhe nuk kishte mundësi objektive të paraqitjes së padisë në mungesë të dijenisë së përcaktimit të rrethanave në të cilat kishte ndodhur ngjarja. Referuar përmbajtjes së neneve 115/dh, 117 dhe 120 të Kodit Civil, gjykata ka vlerësuar se për paditësit afati i parashkrimit të padisë ka filluar të ecë, minimalisht, më datë 18.02.2016, datë e shkresës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Paditësit kanë paraqitur padinë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, më datë 31.05.2018, sikurse ka rezultuar nga shënimi i bërë në të nga kancelari i gjykatës, brenda afatit trevjeçar të parashkrimit të parashikuar nga neni 115/dh i Kodit Civil”.*

**70.4** Lidhur me gjetjen e Komisionit se kjo çështje është zgjidhur shumë shpejt nga Gjykata e Apelit në krahasim me çështjen gjyqësore nr. {\*\*\*}, e përfunduar në vitin 2020, rezulton se në funksion të hetimit administrativ, Komisioni, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.09.2020, i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Vlorë, vetëm vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.12.2018, të kësaj gjykate dhe jo dosjen gjyqësore. Për këtë arsye, fakti që çështja është gjykuar shpejt, rezulton nga një përlllogaritje e distancës kohore mes datës 05.10.2018, datë e shpalljes së vendimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me datën 27.12.2018, datë e shpalljes së vendimit nga Gjykata e Apelit Vlorë. Megjithatë, vërehet se Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi për zgjidhjen e shpejtë të çështjes, por ka potencuar faktin e tejzgjatjes së gjykimit në çështjen gjyqësore nr. {\*\*\*} O. L. kundër “{\*\*\*}” ShPK dhe KRRt-së Bashkia Vlorë, e cila është analizuar më poshtë në këtë relacion.

**70.5** Në analizë të rrethanave si më sipër, trupi gjykues konstatoi se në thelb të vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit si pjesë e trupit gjykues, ka qëndruar bindja e brendshme e gjyqtarit në vlerësimin e provave.

- 71.** Në konkluzionet e Komisionit për secilën prej çështjeve të analizuara më sipër në këtë vendim, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka kryer vlerësimin në tejkallim të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit. Kompetenca kushtetuese dhe ligjore e organeve të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 43 e 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk përfshin një gjykim apo vlerësim mbi logjikën apo bazueshmërinë e vendimmarrjes së një magjistrati, e cila është detyrë dhe kompetencë e organeve më të larta gjyqësore. Në këtë drejtim, nënvizohet parashikimi i nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: *“Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”*, e referuar në parashikimin e

nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në konkluzion, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me këto çështje, gjenden të bazuara në ligj e në prova.

72. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *gjatë hetimit administrativ në Komision është përpjekur të jetë ezauruese, duke shpjeguar se vendimi i sipërcituar është prishur nga Gjykata e Apelit mbi bazën e provave të reja, të pakërkua dhe të paparaqitura në gjykimin në shkallë të parë.*

Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues konstatoi se Komisioni ka zhvilluar hetimin administrativ mbi këtë dokument të hartuar nga subjekti i rivlerësimit, mbi bazën e të dhënave të referuara nga raporti i DSIK-së, sipas të cilit: *“Në disa të dhëna të vitit 2008 ka pasur dyshime se gjyqtarja Klodiana Gjyzari mund të ketë përfituar një sasi parash për të favorizuar shtetasin për të cilin ka pasur një çështje penale në ngarkim të tij”.*

Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon: Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.06.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme, ka vendosur *deklarimin fajtor të të pandehurit A. K. për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike” dhe dënuar me 3 vjet burgim.* Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Vorë ka vendosur *prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 27.6.2008 dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit.* Subjekti i rivlerësimit ka dhënë një vendim, i cili është prishur më pas nga Gjykata e Apelit pas ankimit të të pandehurit.

72.1 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka parashtruar të njëjtat argumente si në ankim, se *në lidhje me këtë vendim, nuk konstatoj të ketë denoncim, por vlerësoj se problematikat e konstatuara nga Komisioni kanë të bëjnë me vlerësimin e provave. Gjykata e Apelit ka marrë prova të reja, të cilat nuk janë kërkuar nga palët gjatë gjykimin në shkallë të parë, ka kryer akt ekspertimi psikiatriko-ligjor mbi një shtetas, pa u paraqitur për ekzaminim ky shtetas, si dhe ka vlerësuar se dëshmitari mbi të cilin mbështetej akuza ndaj shtetasit A. K., i cili ka qenë kryetar i fshatit, ka qenë i paaftë mendërisht. Ndërkohë që dëshmitari nuk është dëgjuar personalisht nga Gjykata e Apelit. Pra, vendimi është ndryshuar, bazuar mbi prova të cilat janë kërkuar dhe marrë rishtazi në Gjykatën e Apelit dhe jo në gjykatën e shkallës së parë. Vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është bazuar në provat që palët kanë paraqitur dhe në kërkesat e tyre, të cilat kanë qenë të ndryshme me ato të paraqitura në Gjykatën e Apelit.*

72.2 Nga përmbajtja e vendimit objekt kontrolli rezultoi se Komisioni ka mbështetur konkluzionin e tij për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, vetëm mbi faktin se ky i fundit ka dhënë një vendim, i cili është prishur më pas nga Gjykata e Apelit pas ankimit të të pandehurit, pa arsyetuar se cilat janë mangësitë konkrete të vërejtura. Në mbështetje edhe të jurisprudencës së Kolegjit<sup>62</sup>, sipas së cilës qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta nuk mund të jenë kriteri matës vendimtar për vlerësimin e aftësive profesionale të magjistratit, vlerësohet se konstatimi i Komisionit, në lidhje me këtë çështje gjyqësore, nuk mund të përdoret për të vlerësuar njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, si një nga nënindikatorët për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar.

73. *Tipologjia e dytë* lidhet me konkluzione të Komisionit, të cilat referojnë te mangësitë profesionale të subjektit, lidhur me indikatorin e aftësive organizative, si dhe atë të arsyetimit të vendimit.

<sup>62</sup> *Vendimi i Kolegjit nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020.*

74. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.01.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>63</sup>, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *për sa i përket njoftimeve të palëve ka dhënë shpjegime ezuaruese të cilat nuk janë kundërshtuar nga Komisioni, ndërsa në lidhje me konstatimet për zgjidhjen përfundimtare të çështjes nuk është në kompetencën lëndore të Komisionit të ngarkojë me barrë prove subjektin e rivlerësimit për të kryer një vlerësim të ri të provave dhe fakteve të gjykuara.*

74.1 Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues konstatoi se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, lidhur me vendimin e sipërcituar, si vijon. *“Gjykata në vendim thekson se ka zhvilluar gjyqin në mungesë të të paditurve, por sipas këtij vendimi rezulton vetëm një i paditur; Duket se çështja është zhvilluar ndaj një personi i cili kishte ndërruar jetë dhe në vendim nuk gjendet asnjë referencë lidhur me gjendjen juridike apo gjendjen civile të palës së paditur; Duket se gjykata nuk ka administruar të dhënat lidhur me gjendjen civile të palës së paditur apo të trashëgimtarëve të tij; Duket se procesi gjyqësor është zhvilluar duke njoftuar palën e paditur me anë të shpalljes, ku sipas vërtetimit të datës 18.9.2012, i padituri rezultoi të jetë larguar nga vendbanimi i tij i fundit nga fshati Dhërmi në vitin 1943; Duket se gjykata i ka hequr të drejtat e pronësisë palës së paditur të përfutur me vendim të komisionit të ndarjes së tokës sipas ligjit nr. 7501 dhe ia ka kaluar të drejtat e pronësisë (pa sqaruar lidhjen e palës paditëse me objektin e gjykimit dhe as konfirmimin nëse pala paditëse ka përfutur apo mund të përfitonte nga ligji për tokën) palës paditëse, duke anashkaluar komisionin e ndarjes së tokës”.*

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ ka parashtruar të njëjtat argumente si në ankim, se pretenduar se: *“[...] konstatoj se vendimi ka marrë formë të prerë. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit, rezulton që janë marrë akte nga Zyra e Gjendjes Civile, akte të cilat janë interpretuar në vendimin e gjykatës. Janë zbatuar parashikimet e nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile për njoftimin e personave të cilët nuk gjenden në vendbanimin e tyre të fundit, që rezulton sipas akteve të gjendjes civile. Nuk rezulton që shtetasi, palë e paditur të kishte ndërruar jetë, pasi një fakt i tillë nuk ka qenë i pasqyruar në regjistrin e gjendjes civile. Gjithashtu, njoftimi ka qenë i afishuar në Bashkinë Himarë, në rast se ka pasur trashëgimtarë të interesuar nuk kanë pasur pengesë të paraqiteshin në gjykim dhe të ndërhyjnë. Gjykata ka kryer përpjekjet për njoftimin e palës së paditur dhe si nëpunësi postar, ashtu edhe Bashkia Himarë, ku është afishuar njoftimi, nuk kanë bërë me dije gjykatën për faktet e pretenduara nga ankuesja znj. I. B.. Ankuesja nuk rezulton të jetë trashëgimtare e palës së paditur, për pasojë nuk tërheq interesa nga gjykimi. [...] Në gjykim ka qenë palë edhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila nuk ka paraqitur ankim. Vlerësoj se përveç sa është arsyetuar në vendimin e gjykatës nuk kam për të shtuar”.*

74.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka përcjellë në Komision<sup>64</sup> vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.01.2013, me palë paditës S. B., i paditur P. B. dhe ZVRPP-ja Vlorë, me objekt “Detyrimin e të paditurit P. B. të njohë familjen bujqësore të paditësit pronare mbi pasuritë e paluajtshme të të përfutur në pronësi me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”. Detyrimin e të paditurit ZVRPP-ja Vlorë të kryejë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme vetëm në emër të anëtarëve të familjes bujqësore të paditësit”.

<sup>63</sup> I shqyrtuar nga Komisioni mbi bazën e denoncimit të znj. I. B., regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.12.2018.

<sup>64</sup> Me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 16.10.2020.

Në vendimin e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit si gjyqtare e vetme ka vendosur pranimin e padisë së paditësit S. B.. Sipas shënimit të vendosur nga kancelari i gjykatës, vendimi ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar në datën 22.02.2013.

**74.3** Sa i përket gjetjes së Komisionit se *gjykata në vendim thekson se ka zhvilluar gjyqin në mungesë të të paditurve, por sipas këtij vendimi rezulton vetëm një i paditur*, nga verifikimi i pjesës hyrëse të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 29.01.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, trupi gjykues vëren se në ndryshim nga sa ka konstatuar Komisioni, në vendim është pasqyruar se janë dy palë të paditura, konkretisht shtetasi P. B. dhe ZVRPP-ja Vlorë, pasi edhe objekti i padisë së ngritur nga paditësi i drejtohet dy të paditurve.

**74.4** Sa i përket gjetjes se *çështja është zhvilluar ndaj një personi i cili kishte ndërruar jetë dhe në vendim nuk gjendet asnjë referencë lidhur me gjendjen juridike apo gjendjen civile të palës së paditur, si dhe duket se gjykata nuk ka administruar të dhënat lidhur me gjendjen civile të palës së paditur apo të trashëgimtarëve të tij*, nga verifikimi i vendimit objekt kontrolli, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në analizë të provave, ka referuar se: (i) nga certifikata e gjendjes familjare e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Bashkia Himarë, më datë 03.09.2012, rezulton se gjendja familjare e datës 01.08.1991, për familjen bujqësore të paditësit ka qenë e përbërë nga nëna e tij A. B., vëllai i tij P. B., si dhe bashkëshortja e tre fëmijët e tij; (ii) nga certifikata personale e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Himarë, më datë 03.09.2012, rezulton se i padituri P. B., vëllai i paditësit S. B., figuron i lindur në Dhërmi, më datë 07.07.1929 dhe nuk figuron të ketë marrë numër personal, si dhe nga vërtetimi i lëshuar nga kryeplaku i fshatit Dhërmi rezulton e konfirmuar se shtetasi P. B. nuk banonte në fshatin Dhërmi që prej vitit 1943; (iii) ka rezultuar e provuar nga vendimi gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 09.05.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë se paditësi S. B. është trashëgimtari universal i nënës së tij A. B..

**74.5** Nga sa më sipër, në ndryshim nga sa ka konstatuar Komisioni, rezulton se nga gjykata janë administruar të dhëna lidhur me gjendjen civile të palës së paditur, të cilat kanë rezultuar nga aktet e lëshuara nga organet kompetente. Për sa i përket gjetjes së Komisionit se duket se procesi gjyqësor është zhvilluar duke njoftuar palën e paditur me anë të shpalljes, ku sipas vërtetimit të datës 18.09.2012, i padituri rezultoi të jetë larguar nga vendbanimi i tij i fundit nga fshati Dhërmi në vitin 1943, trupi gjykues konstatoi se në vendim subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar se në rrethanat e sipërcituara gjen zbatim parashikimi i nenit 133 të Kodit të Procedurës Civile<sup>65</sup> dhe ka referuar se gjykata, me qëllim njoftimin e të paditurit P. B., ka afishuar njoftimin për seancat gjyqësore në vendin e caktuar për këtë qëllim në gjykatë dhe në vendin e afishimit të vendbanimit të tij të fundit në fshatin Dhërmi. Pavarësisht arsyetimit të sipërcituar të subjektit të rivlerësimit në vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se nga ana e subjektit të rivlerësimit duhet të ishin bërë përpjekje më të thelluara për të verifikuar e garantuar se vendbanimi ose vendqëndrimin i fundit në Republikën e Shqipërisë i shtetasit P. B. ishte fshati Dhërmi, për të bërë të mundur ezaurimin e njoftimit të zhvillimit të seancës gjyqësore, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

---

<sup>65</sup> Neni 133 i Kodit të Procedurës Civile në kohën e zgjidhjes së çështjes parashikonte se: “Kur marrësit nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë ose nuk ka zgjedhur një banesë apo nuk ka caktuar një përfaqësues të tij, sipas nenit 131 të këtij Kodi, njoftimi i aktit bëhet nëpërmjet afishimit të kopjes në gjykatën e vendit, ku do të gjykohet mosmarrëveshja, si dhe në vendin e afishimit, ku ka pasur vendbanimin e fundit”.

74.6 Për sa i përket konkluzionit të Komisionit se duket se gjykata i ka hequr të drejtat e pronësisë palës së paditur të përfituar me vendim të komisionit të ndarjes së tokës sipas ligjit nr. 7501 dhe ia ka kaluar të drejtat e pronësisë (pa sqaruar lidhjen e palës paditëse me objektin e gjykimit dhe as konfirmimin nëse pala paditëse ka përfituar apo mund të përfitonte nga ligji për tokën) palës paditëse, duke anashkaluar komisionin e ndarjes së tokës, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit, në vendimin objekt kontrolli, ka arsyetuar dhe ka analizuar provat mbi lidhjen e paditësit me objektin e padisë, duke reflektuar aftësi në interpretimin e ligjit, sipas parashikimit të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues i Kolegjit nënvizon se konkluzioni i Komisionit lidhet me zgjidhjen e çështjes, me atë aspekt të aftësive profesionale të magjistratëve që nuk mund të gjykohej e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi, sipas nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, për pasojë gjendet jashtë sferës së objektit të kontrollit të institucioneve të rivlerësimit.

75. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.02.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë<sup>66</sup>, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se barra e provës i është ngarkuar nga Komisioni për interpretimin e provave, të cilin e ka kryer në vendimin përkatës i administruar nga Komisioni dhe, për këtë arsye, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, është shprehur se vlerësimi i provave është kryer prej saj në vendim.

75.1 Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me vendimin e sipërcituar, si vijon: *Duket se ky vendim gjyqësor është bazuar në interpretime, bazuar në dëshmitarë dhe prova rrethanore dhe jo në kontratën e lidhur nga palët me vullnet të plotë, ku përcaktohet likuidimi i plotë financiar ndërmjet palëve. Vetë gjykata në pjesën arsyetuese pranon që kontrata përbën provë të plotë dhe nuk lejohet prova me dëshmitarë për të provuar të kundërtën e asaj që rezulton nga një “akt zyrtar” dhe vendimi i dhënë duket se është në kundërshtim me këtë arsyetim. Gjykata në këtë vendim është shprehur për shlyerjen e detyrimit kontraktor nga pala blerëse por jo nga pala shitëse, e cila kishte detyrimin të finalizonte kontratën e shitjes dhe regjistrimin e pronës në emër të blerësit.*

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka parashtruar të njëjtat argumente si në ankim.

75.2 Gjykata e Apelit Vlorë ka përcjellë në Komision<sup>67</sup> vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.02.2019, me palë paditës i kundërpaditur M. B., i paditur kundërpaditës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, i paditur ZVRPP-ja Vlorë, me objekt: “Detyrimin e të paditurit kundërpaditës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK të përmbushë detyrimin kontraktor dhe pajisjen e paditësit me certifikatë pronësie”.

Me vendimin si më sipërcituar, Gjykata e Apelit Vlorë, kryesuese e trupës gjykuese të së cilës ishte subjekti i rivlerësimit, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 11.12.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë. Detyrimin e paditësit të kundërpaditur M. B. të paguajë në favor të të paditurit kundërpaditës shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK shumën 33.000 euro.*

Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka arsyetuar: *“Gjykata e Apelit bazuar në nenin 690 të Kodit Civil vlerëson se kontrata e lidhur rregullisht mes palëve ka fuqinë e ligjit. Bazuar në nenin 698 të Kodit Civil, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktore në kontratat me detyrime të dyanshme, secila prej palëve që pretendon se ka shlyer detyrimet e saj ka*

<sup>66</sup> I shqyrtuar nga Komisioni mbi bazën e denoncimit të z. M. B., regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 07.02.2019.

<sup>67</sup> Me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 02.10.2020.

të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës ose përmbushjen e detyrimit. [...] Në interpretimin e kontratës, gjykata e shkallës së parë duhet të kishte mbajtur parasysh, bazuar në nenet 681, 682 dhe 684 të Kodit Civil, sjelljen e palëve gjatë dhe pas lidhjes së kontratës, interpretimin me mirëbesim të kushteve kontraktore, si dhe duhet të mbante parasysh edhe praktikën tregtare të shoqërisë palë e paditur. [...] Bazuar në sa më lart, Gjykata e Apelit, bazuar në nenin 233, germa “b” të Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 681, 682, 684 dhe 689 të Kodit Civil, arrin në konkluzionin se provohet që paditësi i kundërpaditur M. B. ka paguar për blerjen e apartamentit [...] në total 13.000 euro. Duke pasur parasysh që çmimi i rënë dakord për blerjen e apartamentit ka qenë 46.000 euro, rezulton e vërtetuar që paditësi nuk ka shlyer tërësisht çmimin e rënë dakord, pasi i detyrohet të paditurit shumën 33.000 euro”.

Trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit arsyetimin e vendimit të sipërcituar nuk e ka bazuar vetëm në parashikimin e nenit 690 të Kodit Civil, por edhe në nenet vijuese të tij, duke argumentuar, në vijë logjike dhe interpretative të arsyeshme mbi provat dhe përdorimin e aplikimin e harmonizuar të parashikimeve të Kodit Civil. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se vendimi objekt vlerësimi nuk paraqet defekte në mënyrën se si ai është arsyetuar, duke plotësuar në këtë mënyrë kërkesat e nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa u përket elementeve që vlerësojnë njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor të subjektit të rivlerësimit.

75.3 Sa i përket gjetjes së Komisionit se gjykata në këtë vendim është shprehur për shlyerjen e detyrimit kontraktor nga pala blerëse, por jo nga pala shitëse, e cila kishte detyrimit të finalizonte kontratën e shitjes dhe regjistrimin e pronës në emër të blerësit, trupi gjykues konstatoi se ky vlerësim i adresohet zgjidhjes në themel të çështjes dhe korrektësisë së vendimmarrjes, që nuk mund të gjykohet e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi, sipas nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, për pasojë gjendet jashtë sferës së objektit të kontrollit të institucioneve të rivlerësimit.

76. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë<sup>68</sup>, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se barra e provës i është ngarkuar nga Komisioni për vlerësimin e provave, në tejkalim të kompetencës së tij lëndore.

Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë pretendim, konstatohet se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me vendimin e sipërcituar, si vijon. *Duket se trupa gjykuese ka dhënë një vendim në kundërshtim me faktet dhe rrethanat që përmend vetë në pjesën arsyetuese të vendimit. Objekti i hetimit të prokurorisë për të cilën është regjistruar dhe procedimi penal nr. {\*\*\*} ishte për veprën penale “Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”. Në pjesën arsyetuese të vendimit ndër indiciet dhe provat e tjera është provuar fakti i interesimit (pohuar nga vetë gjyqtarja e çështjes) disa herë të Kryetarit të gjykatës te gjyqtarja e çështjes (interesim lidhur me ecurinë e çështjes) dhe sidomos në përfundim të shqyrtimit të çështjes dhe dhënies së vendimit (konkludimit në bindjen e gjyqtarës).*

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka parashtruar elementet thelbësore të vendimmarrjes së trupit gjykues në vendimin në fjalë, duke argumentuar se pretendimet e denoncueses, znj. R. I., kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit, dhe se pretendimet e saj përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet rekursit.

---

<sup>68</sup> I shqyrtuar nga Komisioni mbi bazën e denoncimit të znj. R. I., regjistruar në Komision, me nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2018.

76.1 Gjykata e Apelit Vlorë ka përcjellë në Komision<sup>69</sup> vendimin nr. {\*\*\*}, datë 27.09.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me ankuesë znj. R. I., kundër Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe z. G. B., me objekt: “Ankim kundër vendimit, datë 25.07.2018, “Për pushimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier”.

Me vendimin si më sipërcituar, Gjykata e Apelit Vlorë, anëtare e trupës gjykuese të së cilës ishte dhe subjekti i rivlerësimit, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 25.07.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier si vijon: Rrëzimin e ankimit të ankueses R. I.*

Në këtë vendim, trupi gjykues, ndër të tjera, ka arsyetuar: “Në vendimin e pushimit të procedimit penal nga prokuroria është pranuar fakti në të njëjtat rrethana siç është përshkruar nga ankuesja R. I., por nga analiza e tij nuk rezultojnë që të gjenden elementet e figurës së veprës penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë i Kodit Penal. Është vërtetuar dhe pranohet nga shtetasja R. I. se është takuar me shtetasin G. B. me kërkesë të saj, për shkak të cilësisë së tij si kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër. Në këtë cilësi i ka shpjeguar konfliktin gjyqësor dhe nuk i ka kërkuar atij ndërhyrje të paligjshme të gjyqtarja e çështjes. Shtetasi G. B. i është shprehur se do komunikonte për rastin e saj me gjyqtaren e çështjes B. Ç.. Nga deklaratimet e shtetasës B. Ç. nuk rezultojnë që shtetasi G. B. t’i ketë kërkuar të vendosë në favor të ankueses R. I. duke shkelur ligjin. [...] Gjykata e Apelit çmon se nuk provohet se favoret seksuale në rastin konkret janë kërkuar me qëllim për të ushtruar ndikimin e paligjshëm. [...] Në rastin konkret, ajo që provohet është fakti i interesimit të personit nën hetim, me cilësinë e kryetarit të gjykatës ndaj gjyqtarit të çështjes, për shkak se gjatë seancave gjyqësore ndërmjet palëve ka pasur konflikte verbale dhe kjo situatë është përcjellë tek kryetari i gjykatës. Që në momentin e parë, i cili ka qenë dhe i vetmi, kryetari i gjykatës i ka kërkuar gjyqtarës së çështjes të zbatojë ligjin dhe kjo rezultojnë vetëm nga deklaratimet e tij dhe të gjyqtarës B. Ç., por edhe nga deklarimi i vetë ankueses, e cila në deklaratimet e saj të datës 28.10.2016 ka deklaruar se gjatë një takimi që pasur me kryetarin e gjykatës ka thënë ta ndihmonte brenda hapësirave ligjore. Gjykata e Apelit vlerëson se është e panevojshme ripyetja e ankueses në lidhje me faktet e pretenduara prej saj, pasi ndryshe nga sa ka pretenduar ankuesja ajo është pyetur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, gjithashtu, nga përmbajtja e kërkesës ankimore të paraqitur pranë gjykatës së shkallës së parë, nuk rezultojnë rrethana të ndryshme apo të reja. Pretendimi i saj se zotëron prova shkresore të shkruara nga personi nën hetim nuk përbën shkak për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal, pasi këto akte së pari duhet të ekzistojnë e më pas të vërtetohet lidhja e tyre me procedimin penal konkret. Ekzistenca e këtyre fakteve nuk është vërtetuar, pasi ankuesja nuk i ka paraqitur në organin procedues apo në gjykatë, si dhe nuk i ka cituar apo dorëzuar në gjykatën e apelit, me qëllim që, jo vetëm të vërtetohet ekzistenca e tyre, por edhe gjykata të vlerësojë lidhjen e tyre me çështjen konkrete. Nga prokuroria me të drejtë është arsyetuar se edhe në rast se fakti do të pranohet siç është deklaruar nga ankuesja, nuk vërtetohet që kërkimi i favoreve seksuale nga i dyshuari të jetë lidhur prej tij ndonjëherë me ndikimin apo mundësinë e tij për të ndikuar në çështjen civile të ankueses, e cila është humbur prej saj”.

76.2 Nga sa më sipërcituar, por edhe nga përmbajtja e vendimit në tërësi, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Vlorë nuk është marrë në kundërshtim me faktet dhe rrethanat e përmendura në pjesën arsyetuese të vendimit. Trupa gjykuese e kësaj gjykate ka qartësuar në vendim rrethanat dhe arsytet pse vendimi i prokurorisë për pushimin e procedimit penal ishte i drejtë. Në ndryshim nga sa ka pretenduar denoncuesja dhe nga sa ka konkluduar

<sup>69</sup> Me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 02.10.2020.



Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se personi nën hetim është interesuar vetëm një herë për çështjen te gjyqtarja përkatëse dhe, edhe në këtë rast, i ka kërkuar asaj zbatimin e ligjit. Në rastin e dytë ka qenë vetë gjyqtarja e cila e ka informuar mbi ecurinë e çështjes dhe kërkesa e personit nën hetim, përsëri ka qenë zbatimi i ligjit. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se vendimi objekt vlerësimi nuk paraqet defekte në mënyrën se si ai është arsyetuar, duke plotësuar në këtë mënyrë kërkesat e nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa u përket elementeve që vlerësojnë njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor të subjektit të rivlerësimit.

77. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë<sup>70</sup>, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *në vendimin e Komisionit nuk ka konstatim apo argumentim se shpjegimi i dhënë prej saj në përgjigje të barrës së provës nuk ka qenë shterues.*

77.1 Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me vendimin e sipërcituar, si vijon: *“Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 6.12.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, subjekti i rivlerësimit si kryesuese e trupës gjyquese ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 27.2.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe pranimin e padisë”. Duket se ky vendim gjyqësor nuk është zbardhur në kohë dhe nuk i është vënë në dispozicion palëve brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Kodi i Procedurës Civile”.*

77.2 Nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, në kuadër të hetimit mbi denoncimin e Bankës Kombëtare Tregtare, lidhur me vendimin objekt kontrolli, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se Komisioni, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 18.09.2020, i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Vlorë *informacion lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, me objekt “Ankim kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 27.02.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.* Informacioni për këtë çështje kërkohet lidhur me datën e marrjes së vendimit, afatit të vënies në dispozicion të palëve, ankimet e palëve lidhur me zbardhjen e vendimit dhe arsyetimi i gjykatës mbi këto kërkesa. Gjykata e Apelit Vlorë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.10.2020, ka informuar Komisionin se dosja e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2018, gjendet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo e fundit, me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 16.10.2020, ka përcjellë në Komision, vetëm vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me palë paditëse shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, palë të paditur shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe {\*\*\*} ShA, me objekt: *“Pavlefshmëri titulli ekzekutiv kontratë kredie bankare, kundërshtim veprimi përmbarimor, lajmërim ekzekutimi vullnetar, pezullim veprimesh përmbarimore”.*

77.3 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka parashtruar: *“[...] vendimi është zbardhur në kohë, por vendosja në dispozicion e vendimit për palët ka të bëjë me nënshkrimin e vendimit nga të tre gjyqtarët, administrimin e dosjes, dorëzimin e saj, në sekretari, veprime që kanë përkuar me periudhën e fundvitit dhe sekretaria gjyqësore është e ngarkuar me procedurën e mbartjes së dosjeve. Gjithashtu, ka përkuar edhe me ndërrimin e sekretareve gjyqësore. Afati i rekursit të palëve fillon nga vendosja në dispozicion e vendimit të arsyetuar, për pasojë nuk ka sjelle efekte për palët”.*

---

<sup>70</sup> I shqyrtuar nga Komisioni mbi bazën e denoncimit të {\*\*\*}, regjistruar në Komision, me nr. {\*\*\*} prot., datë 18.02.2019.

Bashkëlidhur shpjegimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kopjen e regjistrit të dorëzimit të dosjes së çështjes në sekretari, për të provuar se dosja është dorëzuar brenda afatit<sup>71</sup>. Nga verifikimi i fletës së regjistrit të dorëzimit të dosjes së çështjes në sekretari, e cila rezultoi të jetë fotokopje e njehsuar me origjinalin, me vulë të sekretarisë së Gjykatës së Apelit Vlorë, krahasuar me të dhënat e pasqyruara në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se çështja civile, me nr. regjistri themeltar {\*\*\*}, me palë shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe {\*\*\*} ShA, me objekt “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”, është regjistruar më datë 30.05.2018, seanca e parë është zhvilluar më datë 18.10.2018, nr. i vendimit {\*\*\*}, data e vendimit 06.12.2018, data e dorëzimit nga gjyqtari 21.12.2018. Në të njëjtën datë janë dorëzuar dhe vendime të tjera të cilët janë regjistruar para dhe pas vendimit objekt verifikimi.

77.4 Nga sa më sipër, rezultoi se vendimi objekt kontrolli është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Apelit Vlorë, brenda afateve të përcaktuara nga neni 308, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: “Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër”. Për pasojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar.

78. Në lidhje me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.03.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë<sup>72</sup>, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shpjegimet e tij në përgjigje të barrës së provës kanë qenë shteruese. Sipas subjektit në lidhje me gjetjet e Komisionit që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, ajo nuk mund të japë shpjegime e të rivlerësojë përsëri provat, pasi këtë e ka bërë në vendim. Për sa i përket pasaktësive në vendim të konstatuara nga Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ato, nëse ekzistojnë, janë përgjegjësi e gjyqtarit relator dhe në rastin konkret ajo nuk ka qenë gjyqtare relatore.

78.1 Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon. Duket se trupa gjyqësore ka shqyrtuar çështjen penale në mungesë të të gjitha palëve; duket se nuk ka marrë parasysh mbylljen e menjëhershme të hetimit nga prokurori; duket se nuk ka marrë parasysh të metat e mëdha të akt ekspertimit, sidomos ajo e shpejtësisë së mjetit që ka shkaktuar aksidentin; duket se nuk ka vlerësuar pamjet filmike të vendit të ngjarjes, të cilat janë administruar në dosje me cilësinë e provave materiale; duket se nuk ka vlerësuar pretendimet e palës ankimese për moskryerjen e një sërë veprimesh procedurale nga prokurori; duket se nuk ka vlerësuar të gjitha provat e administruara në dosjen penale, por ka dalë me vendim duke u mbështetur vetëm në aktin e ekspertimit, provë e cila duket se bie në kundërshtim dhe me provat e tjera të administruara në dosje. Kjo bie në kundërshtim me arsyetimin e bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 31.1.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku subjekti si relatore e çështjes ka deklaruar: “duke zbatuar drejt nenin 4/2 dhe 152 të Kodit Procedurës Penale dhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Gjykatës së Lartë, se fajësia apo pafajësia nuk mund të konkludohet duke u bazuar në një provë të vetme pavarësisht faktit nëse kjo është një provë shkencore”. Në pjesën arsyetuese të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.03.2019, ka

<sup>71</sup> Ashtu siç ka referuar subjekti i rivlerësimit në “Kërkesë për riçelje të hetimit administrativ dhe marrje provash të reja”, paragrafi 6, paraqitur në Komision më datë 11.01.2021.

<sup>72</sup> I shqyrtuar nga Komisioni mbi bazën e denoncimit të znj. L. B., regjistruar në Komision, me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.05.2019.

*një nonsens në këtë vendim, pasi nga njëra anë trupa gjyquese çmon dhe del e nevojshme kryerja e një sërë veprimesh të tjera hetimore dhe nga ana tjetër shpall vendimin për pushimin e çështjes penale.*

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka parashtruar të njëjtat argumente si në ankim, se: “[...] subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë relator, për pasojë nuk ka arsyetuar vendimin. Në lidhje me pasaktësi të mundshme të pjesës arsyetuese janë përgjegjësi e relatorit të çështjes. Në lidhje me konkluzionin e arritur, nga provat e shqyrtuara, akti i ekspertimit, i cili është bazuar në të gjitha të dhënat hetimore, në këqyrjen e vendit të ngjarjes, si dhe në deklaratimet e personave që kanë dijeni në lidhje me ngjarjen, nga Gjykata e Apelit është vlerësuar se kërkesa e prokurorit për pushimin e procedimit penal ka qenë e bazuar në prova dhe në ligj. Pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe të ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Apelit dhe vlerësoj se pretendimet e saj përbëjnë objekt shqyrtimi gjyqësor nëpërmjet rekursit”.

**78.2** Gjykata e Apelit Vlorë ka përcjellë në Komision<sup>73</sup>: (i) vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.03.2019, me kërkesë Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, person nën hetim M. M., trashëgimtarët e viktimës L. e L. B.; si dhe (ii) pjesë të dosjes penale.

Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.3.2019, si më sipërcituar, Gjykata e Apelit Vlorë, anëtare e trupës gjyquese të cilës ishte dhe subjekti i rivlerësimit, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor penal nr. {\*\*\*}, datë 05.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”, i cili ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke vendosur: “Pushimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2018, i regjistruar për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/3 i Kodit Penal”.

**78.3** Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se gjykata ka shqyrtuar çështjen penale në mungesë të të gjitha palëve, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në pjesën hyrëse të vendimit të sipërcituar është evidentuar se secila prej palëve ka qenë në mungesë. Referuar akteve të fashikullit gjyqësor, rezultoi të jenë administruar fletëthirrjet për znj. L. B. dhe z. L. B., si dhe avokatin e tyre z. E. D., në të cilat është shënuar se avokati mori dijeni dhe ka marrë përsipër të njoftojë të mbrojturit prej tij, si dhe fletëthirrjet për znj. M. M. dhe avokaten e saj znj. D. Z., në të cilat është shënuar se avokatja mori dijeni dhe ka marrë përsipër të njoftojë të mbrojturën prej saj. Në secilën prej fletëthirrjeve rezulton të jetë nënvizuar njoftimi se *mosparaqitja shkakton gjykimin në mungesë*. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se gjykata në shqyrtimin e çështjes penale ka vepruar në përputhje me parashikimin e nenit 329/b, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: “2. Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj”, i lidhur me nenin 426/a, pika 5 e të njëjtit Kod, sipas së cilës: “Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysish, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë”.

**78.4** Lidhur me konkluzionin e Komisionit se trupa gjyquese nuk ka vlerësuar të gjitha provat e administruara në dosjen penale, por ka dalë me vendim duke u mbështetur vetëm në aktin e ekspertimit, provë e cila duket se bie në kundërshtim dhe me provat e tjera të administruara në dosje, nga përmbajtja e vendimit objekt kontrolli, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se nga prokuroria janë kryer dy akte ekspertimi auto-teknik. Akt ekspertimi i parë është kryer më datë

<sup>73</sup> Me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 02.10.2020.

12.08.2018, në të cilin eksperti ka dalë në konkluzionin se shkakua determinant që ka sjellë si pasojë aksidentin ka qenë shkelja e rregullave e kryer nga fëmija. Nga prokuroria është çmuar të kryhet një akt i ri ekspertimi auto-teknik<sup>74</sup>, i cili është kryer më datë 18.11.2018, si pasojë e të cilit konkluzioni i arritur nga grupi i përbërë nga tre ekspertë ka qenë se shkakua determinant i ndodhjes së aksidentit ka qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e këmbësorit, konkretisht nenit 188/2/5 e Kodit Rrugor. Në analizë të rrethanave si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi vendimmarrja e gjykatës është bazuar në dy akte ekspertimi të administruara në cilësinë e provës. Në thelb të vendimmarrjes ka qëndruar bindja e brendshme e gjyqtarit në vlerësimin e provave për zgjidhjen e çështjes, pra, me atë aspekt të aftësive profesionale të magjistratëve që nuk mund të gjykohet e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi, sipas nenit 72, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, për pasojë gjendet jashtë sferës së objektit të kontrollit të institucioneve të rivlerësimit.

**78.5** Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se në pjesën arsyetuese të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 19.03.2019, ka një *nonsens*, pasi nga njëra anë trupa gjykuese çmon se del e nevojshme kryerja e një sërë veprimesh të tjera hetimore dhe nga ana tjetër shpall vendimin për pushimin e çështjes penale, nga verifikimi i vendimit objekt kontrolli, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky konstatim i Komisionit është i drejtë, pasi në përfundim të arsyetimit, trupa gjykuese është shprehur se: “Në analizë të kërkesës së prokurorisë nga studimi i të gjitha akteve që ndodhen në dosjen hetimore, Gjykata çmon se nga aq sa ka rezultuar nga hetimet paraprake të deritanishme del e nevojshme kryerja e një tërësie veprimesh të tjera hetimore, përpara se vepra penale të klasifikohet, sipas paragrafit të parë të nenit 290 të Kodit Penal. Ndaj si përfundim, Gjykata e Apelit Vlorë konkludon se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në ligj e në prova e duhet të lihet në fuqi, ndërsa kërkesa ankimore duhet të rrëzohet”. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se pasaktësi të mundshme të pjesës arsyetuese janë përgjegjësi e relatorit të çështjes, pavarësisht se ky pretendim vjen në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës në rastet kur subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit dhe jo kryesuesit të trupit gjykues, shihet si jo me relevancë të drejtpërdrejtë në vlerësimin e aftësive organizative të subjektit të rivlerësimit gjetjet në dokumentet ligjore, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se edhe pse zbardhja e arsyetimit të vendimit është detyrë e gjyqtarit relator, për sa kohë që vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, nuk mund të perceptohet se gjyqtarët e tjerë nuk janë të vëmendshëm në leximin e tij, aq më tepër që në rastin konkret, pjesa e cituar e vendimit e cila përmban pasaktësinë ose “*nonsensin*” ndodhet në përmbyllje të arsyetimit. Fakti që subjekti i rivlerësimit, si pjesë e trupës gjyqësore, ka anashkaluar të verifikojë përmbajtjen e vendimit të nënshkruar prej saj, demonstroi një të metë në drejtim të arsyetimit ligjor, sipas parashikimit të nenit 74, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, e cila megjithatë nuk çmohet se është e një rëndësie të tillë, që të justifikojë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

79. Në lidhje me çështjen gjyqësore civile nr. {\*\*\*}, me palë O. L. kundër “{\*\*\*}” ShPK dhe KRrT-së Bashkia Vlorë<sup>75</sup>, në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *shpjegimet e saj në përgjigje të barrës së provës kanë qenë të hollësishme, duke i dhënë përgjigje çështjeve të ngritura dhe në*

---

<sup>74</sup> Sipas referimit në vendim, akti i ri ekspertimit auto-teknik është çmuar të kryhet nga prokuroria, pasi trashëgimtarët e viktimës kanë dorëzuar pranë saj, një USB me pamjet filmike të kamerave të një biznesi që ndodhej afër vendit të ngjarjes dhe është pretenduar se aty shfaqet dinamika e aksidentit dhe se shpejtësia e automjetit me drejtuese M. M. është përtej normave të lejuara.

<sup>75</sup> I shqyrtuar nga Komisioni mbi bazën e denoncimit të z. K. Zh., regjistruar në Komision, me nr. {\*\*\*} prot., datë 08.04.2019.

*seancë dëgjimore Komisioni apo vëzhguesi ndërkombëtar nuk kanë pasur asnjë pyetje apo paqartësi.*

**79.1** Në kuadër të shqyrtimit të fakteve e rrethanave në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se në vendim, Komisioni ka evidentuar se i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, si vijon: “*Subjekti i rivlerësimit si relatore e çështjes ka pasur në shqyrtim çështjen gjyqësore civile nr. {\*\*\*}, me palë O. L. kundër “{\*\*\*}” ShPK dhe {\*\*\*}. Caktimi i kësaj çështje me short për subjektin e rivlerësimit është bërë më datë 25.10.2016. Subjekti ka filluar procesin gjyqësor dhe njoftimin e palëve më datë 12.10.2017. Gjykata në përfundim ka kërkuar paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare për këtë çështje më datë 05.11.2019 dhe shpallja e vendimit është bërë më datë 06.02.2020. Duket se subjekti ka qenë në shkelje dhe tejkallim të afateve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për shqyrtimin e kësaj çështje civile”.*

**79.2** Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka parashtruar të njëjtat argumente si në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, të cilat shtjellohen në vijim. *Çështja ka qenë e kthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë, pas rreth gjashtë vjetëve dhe trupi gjykues ka qenë i përbërë nga unë si relatorë dhe dy gjyqtarë të cilët kanë qenë anëtarë të dy kolegjeve të ndryshme, gjë që shkakton vonesa në planifikim, si dhe në caktimin e seancave gjyqësore, pasi gjyqtarët anëtarë duhet të përfundojnë gjykimet me kolegjet e tyre, më pas të vijojnë gjykimet me kolegjet e detyruara. [...] Palët nuk kanë dhënë ndihmesën e tyre për përfundimin e gjykimit në afatet procedurale të nevojshme, sipas detyrimit të tyre të parashikuar në nenin 15 të Kodit të Procedurës Civile. Fakti që të dyja palët kanë pasur tendencë dhe janë përpjekur të zvarrisin gjykimin vërtetohet me qëndrimin e tyre, të dyja palët, kanë kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, të dyja palët kanë kërkuar përjashtimin e tre ekspertëve të ndryshëm të caktuar, nuk kanë lejuar asnjë prej ekspertëve për të kryer detyrat e ngarkuara, etj. Pala e paditur vazhdimisht ka paraqitur raport mjekësor në gjykim për të zvarritur gjykimin, fakte këto të pasqyruara në dosje. Në lidhje me afatet e gjykimit, duke qenë të ndërgjegjshëm se kanë qenë vetë shkaktarë për zvarritjen e gjykimit, asnjë prej palëve nuk ka paraqitur padi për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit. Ka rezultuar që ankuesi është gjyqfitues.*

**79.3** Gjykata e Apelit Vlorë ka përcjellë në Komision<sup>76</sup> dosjen e çështjes gjyqësore civile nr. {\*\*\*}, me palë O. L. kundër “{\*\*\*}” ShPK, nga verifikimi i së cilës trupi gjykues i Kolegjit konstatoi si vijon:

- Sipas të dhënave që rezultojnë nga fletëprintimi nga sistemi, me titull “Informacion mbi çështjen”, si rezultat i shortit elektronik të hedhur më datë 25.10.2016, gjyqtar relator i çështjes është caktuar z. H. S.. Më datë 18.04.2017, gjyqtari relator ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesë e pranuar nga kryetarja e gjykatës me vendim, të datës 18.04.2017, e cila ka urdhëruar rihedhjen në short të çështjes. Në vijim, në dosjen gjyqësore, gjendet fletëprintim nga sistemi me titull “Regjistri i veprimeve” të çështjes, sipas të cilit më datë 19.04.2017, si gjyqtare relatore është caktuar Klodiana Gjyzari.

- Me vendimin e datës 28.09.2017, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kalimin e çështjes civile në seancë gjyqësore, duke caktuar seancën e parë më datë 12.10.2017. Seanca e fundit, në të cilën është shpallur vendimi i gjykatës për zgjidhjen e çështjes, është mbajtur më datë 06.02.2020.

- Lidhur me kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjes, nga verifikimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore rezultoi se nga totali prej 36 seanca gjyqësore, 24 prej tyre kanë qenë seanca

<sup>76</sup> Me shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 02.10.2020.

gjyqësore joproductive. Nga këto të fundit 5 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së anëtarëve të tjerë të trupit gjykues [gjyqtarëve S. D. - 1 seancë dhe P. A. - 4 seanca]; 17 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së justifikuar të palëve ose avokatëve të zgjedhur prej tyre ose për shkak të mungesës së justifikuar të ekspertit të caktuar nga gjykata ose për shkak se palët nuk kanë kryer pagesën për kryerjen e aktit të ekspertimit ose për shkak se palët kanë kërkuar përjashtimin e ekspertit. Në rastet kur është konstatuar dijenia e palëve dhe mungesa e tyre pa shkaqe të arsyeshme, subjekti i rivlerësimit ka proceduar me vijimin e gjykimit në mungesë. Në caktimin e datave të seancave është respektuar një distancë mesatare nga njëra-tjetra prej tre javësh.

- Në seancën gjyqësore të datës 30.10.2019, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, ka ftuar palët që në seancën e radhës në datën 05.11.2019 të paraqisnin konkluzionet përfundimtare. Në vazhdim, deri në shpalljen e vendimit, janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore, të cilat kanë qenë joproductive, 4 seanca për shkak të mungesës së justifikuar të palëve.

- Vetëm dy seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mungesës së subjektit të rivlerësimit - seanca e datës 06.02.2019 rezulton të jetë shtyrë për shkak se gjyqtarët e gjykatës kanë qenë në një ceremoni mortore; seanca e datës 22.01.2020 rezulton të jetë shtyrë për shkak se subjekti i rivlerësimit ka qenë e angazhuar në “Takimin e parë të KLGj-së, Gjyqtarëve të Medias dhe Nëpunësve të Marrëdhënieve me Median”, i mbajtur në Tiranë.

- Palët ndërgjyqëse kanë kërkuar disa herë përjashtimin e trupit gjykues, por kjo nuk ka ndikuar në asnjë rast në zhvillimin e gjykimit në datën e caktuar.

**79.4** Në analizë të situatës faktike si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shtyrjet e seancave gjyqësore, për shkak të angazhimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit, kanë qenë të justifikuara dhe numri i seancave të shtyra, për shkak të angazhimeve të tjera të tij, është shumë i vogël krahasuar me numrin total të seancave gjyqësore joproductive në çështjen objekt kontrolli. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga verifikimet e kryera, trupi gjykues çmoi se tërësia e arsyeve që kanë diktuar nevojën për shtyrjen e seancave gjyqësore dhe daljen e gjykimit jashtë afateve të parashikuara nga standardet kohore të vlerësimit<sup>77</sup>, nuk kanë ardhur si pasojë e shkaqeve të lindura nga aspekte subjektive të subjektit të rivlerësimit, por si rrjedhojë e garantimit të standardeve të komponentëve të procesit të rregullt ligjor. Në këto kushte, argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjenden të bazuara në fakte.

80. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se gjetjet e Komisionit, në kuadër të kontrollit e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale e që kanë shërbyer si bazë për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, nuk janë rezultat i një vlerësimi të drejtë. Trupi gjykues konstatoi se disa prej tyre përfaqësojnë vlerësime e qëndrime në kapërcim të objektit të organeve të rivlerësimit lidhur me kontrollin e këtij kriteri. Për sa i përket gjetjeve, të cilat u konsideruan si të bazuara, trupi gjykues çmoi se ato ishin të tilla që nuk mund të shërbejnë si një bazë e mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
81. Trupi gjykues vlerësoi se aplikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si kriter për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, nuk gjendet i mbështetur në prova e në ligj.
82. Megjithëse, disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.

<sup>77</sup> *Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 14.04.2010, i KLD-së.*

83. Në përfundim, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Klodiana Gjyzari gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 340, datë 01.02.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e saj nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 340, datë 01.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Klodiana Gjyzari.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 18.07.2023.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

[Vendim Nr. 31/2023 \(JR\) datë 18.07.2023 dhe vendimi nr. 31/1, datë 30.03.2026; subjekti i rivlerësimit Klodiana Gjyzari](#)